

MUHIBBUDIN ABBAS EL KADHIMIJ

Udhëtim në botën e
Shiave

Qendra e diturisë shi'ite, të fshehtat demaskuese

سياحة في عالم الشيعة

الحوزة العلمية أسرار وخفايا

Tiranë 2014

Titulli në origjinal: سياحة في عالم التشيع – الحوزة العلمية أسرار وخفايا

Titulli në shqip: Udhëtim në botën e shiave - Qendra e diturisë shi'ite, të fshehtat demaskuese.

Autori: Muhibbudin Abbas El Kadhimij

Redaktoi: Sashenka Jaupi

Përktheu: Shuajb Rexha

Kopertina dhe faqesja: Rajan Alliu

Boton: Qendra “Udha e Besimtarëve”©

www.udhaebesimtareve.com

Tiranë 2014

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Allahu ka thënë: “Ai që besoi (nga ai popull) tha: O populli im! Unë kam frikë për ju se do t’ju ndodhë ashtu siç ju ndodhi popujve të mëparshëm, siç ndodhi me popullin e Nuhut, të Adit, të Themudit dhe të atyre që vijuan. Allahu nuk i bën padrejtësi robërve të Tij” [Gafir 31]

dhe: “O populli im! Unë kam frikë për atë që do t’ju ndodhë në Ditën e Mjerimit (ditën kur thërrasin njëri - tjetrin për mjerimin që i ka kapluar). Ditën kur duke u zmbarsur do të përpiqeni të shpëtoni, por nuk ka kush t’u shpëtojë nga dënimi i Allahut. Atë që Allahu e lë në humbje askush nuk mund ta drejttojë” [Gafir 33]

dhe: “Ai që kishte besuar mes tyre, tha: O populli im, ejani pas meje (ndiqeni atë që po u them) sepse unë po ju tregoj rrugën e drejtë. O populli im, jeta e kësaj bote është një përjetim i shkurtër, ndërsa bota tjetër është ajo e përhershme” [Gafir 39]

dhe: “O populli im! Ç’është me ju kështu? ! Unë po ju thërras në shpëtim, ndërsa ju më thërrisni drejt zjarrit! Ju më ftoni të mohoj Allahun dhe t’i bëj ortak Atij, pa kurrfarë baze, ndërsa unë po ju thërras tek i Gjithëfuqishmi Krenar, Mëkatfalësi. Pa dyshim, zotave drejt të cilëve më ftoni ju, nuk mund t’u lutesh, as në këtë botë, as në tjetrën; kthimi ynë është tek Allahu. Ata që e teprojnë me të këqija do të jenë banorë të Zjarrit. Më vonë do t’i kujtoni këto që po ju them. Çështjen time ia dorëzoj Allahut, vërtetë Allahu i sheh robërit e Tij” [Gafir 41 - 44].

PSE E SHKROVA KËTË BROSHURË?

Kam jetuar vitet e jetës sime duke besuar dhe duke vazhduar të besoj se rruga e *ehlul bejtit* është në përputhje të plotë me Sheriatin e Allahut, ashtu siç është në përputhje me logjikën e shëndoshë, me perceptimin korrekt dhe sjelljet normale njerëzore. Në transmetimet e tyre nuk gjen diçka që bie ndesh me Kuranin dhe Sunetin, por nëse supozohet që të ekzistojë diçka e tillë, atëherë largohemi prej saj, e braktisim dhe kapemi pas veprave që janë në përputhje me Librin e Allahut. Këtë porosi e ka dhënë El Imam Es-Sadik, pasi u shtuan transmetimet e shpikura që i dedikoheshin atij, duke thënë se: ajo që është në përputhje me librin e Allahut pasojeni, ndërsa ajo që bie ndesh me të braktiseni! ¹

Në rrjedhën e kohës dhe me kalimin e ditëve, unë vëreja ngjarjet që ndodhnin, jetoja realitetin aktual, duke qenë i vëmendshëm ndaj lëvizjeve që ndodhnin. I vështroja njerëzit dhe i analizoja sjelljet e tyre, duke studiuar dhe duke vënë në provë ideologjinë e tyre sepse unë falënderoj Allahun që më ka dhënë një natyrë të atillë që nuk bindet lehtë për atë që sheh apo dëgjon, nëse bindja nuk shoqërohet me studim dhe analizë. Kjo ndodh ngaqë unë besoj se Allahu i ka dhënë çdo njeriu mendjen që të logjikojë dhe mendjen e tij ta vërë në punë, e jo ta mënjanojë dhe të logjikojë sipas mendjes të së tjerëve, veçanërisht për çështjet madhore siç janë bazat e fesë, të besimit dhe domosdoshmërive të pashmangshme të jetës njerëzore. Gjithmonë i përsërisja vetes thënien e prijësit të besimtarëve (Aliut): “I lutemi Allahut të na ruajë nga mpirja e mendjes (trurit).” ² Kur lexoj fjalën e Allahut në suren Ahzabë, tronditem i tëri: “Përkujto Ditën kur fytyrat e tyre

¹ Usulul Kafi 1/69

² Sherhu nehkhil belagah 11/246).

rrotullohen (përmbysen) në Zjarr dhe thonë: “Ah mjerë për ne! sikur t’i ishim bindur Allahut dhe të Dërguarit.” Thonë: “O Zoti ynë! Ne iu bindëm parisë udhëheqëse, të cilët na humbën nga rruga e drejtë.” [Ahزاب 67]. Subhanallah, këta janë ata njerëz që i mbyllën mendjet e tyre në lidhje me kuptimin e Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit, duke i dorëzuar frerët e logjikës në duart e udhëheqësve dhe klerit, duke pasur si përfundim të merituar që të gjithë zjarrin. Imitimi dhe pasimi i verbër i dijetarëve nuk është koncept i përgjithshëm që përfshin çdo çështje, por në mënyrë specifike ka të bëjë me mënyrat e kryerjes së riteve fetare, apo me ato çështje të ndërlikuara për t’u kuptuar nga çdokush, gjithmonë bëhet fjalë për atë kategori njerëzish që nuk është në gjendje të studiojë, të përpiqet dhe të kuptojë. Ky *taklid* (imitim) ka dhe një kusht tjetër: Ajo çështje (për të cilën ai po bën taklid) të mos bjerë ndesh haptazi me ndonjë ajet Kuranor, apo hadith. Për sa i përket bazave të fesë dhe çështjeve thelbësore në të, njeriu nuk justifikohet me injorancën e tij apo me gabimin e konceptimit të këtyre çështjeve³, duke iu mbështetur *taklidit* të dijetarëve sepse nëse kjo gjë do të qëndronte, ne dimë që çdo popull kishte dijetarët e tij, çifutët kishin

³ Sh.p: Qëndrimi i duhur në këtë çështje është se mund të ketë njerëz që janë të justifikuar edhe në këto çështje, për shkak të injorancës, apo gabimit. Mjafton të cekim dy argumente:

1. Hadithi i dikujt që nga gëzimi i madh tha: “Ti je rob i im dhe unë jam Zoti yt!” Gaboi për shkak të gëzimit të tejskajshëm që përjetoi.

2. Hadithi i atij që tha: “Më digjni trupin dhe më shpërndani hirin sepse nëse Allahu do më ringjallë do të më dënojë!”

Allahu atë do ta pyesë : “O rob i im, ç’të shtyu të veprosh kështu? Dhe ai do të përgjigjet: “Frika prej Teje!” Për këtë gjë Allahu e fali.

Për më tepër, rreth kësaj çështje do gesh sqarime në broshurën, e cila do të botohet së shpejti, *Justifikimi me injorancë*, ku do të gesh fetvatë e dijetarëve të të gjitha kohërave.

dijetarët e tyre, ashtu siç të krishterët kishin dijetarët e tyre, por megjithatë Allahu tha: “I morën ahbarët (klerin jehudi) dhe ruhbanët (klerin e krishterë) si Zota në vend të Allahut” [Teube: 31]

Gjithashtu kam arritur të kuptoj se Islami, kjo fe madhështore, në historinë e saj të gjatë është përballur me kurthe dhe intriga nga më të ndryshmet, si dhe me përpjekje infiltrimi, me qëllim deformimin e saj. Të tilla janë përpjekjet për t’ia ngarkuar atë që nuk është prej saj, apo për të ndryshuar diçka në të, ku një nga format e kësaj është shpikja e haditheve dhe trillimi i tyre, po ashtu edhe fabrikimi i thënieve të zbukuruara duke ua ngarkuar ato padrejtësisht imamëve.

Nëpërmjet të jetuarit mes njerëzve të thjeshtë dhe duke u zhytur thellë nëpër libra kam konstatuar një realitet të hidhur, i cili është fakti që imamëve të *ehlu bejtit* (roli i të cilëve ishte i njëjtë me rolin e dijetarëve kolosë përmirësues të mirënjohur në këtë umet) iu është bërë padrejtësi e dyfishtë. Në fillim iu është bërë padrejtësi nga armiqtë e tyre dhe më pas nga pasuesit e tyre. Për sa iu përket armiqve, të cilët ofendonin *ehlu bejtin* dhe e përçudnonin figurën dhe veprimtarinë e tyre (që është gjë tepër ofenduese), së paku ata nuk ishin të panjohur, nuk fshiheshin pas shtirjes sikur të ishin pasues të *ehlu bejtit*, në mënyrë që të mos njiheshin. Kurse pasuesit..., padrejtësia e tyre ishte akoma më e rëndë, atëherë kur u mashtruan pas thënieve të armiqve të fshehtë, duke i besuar ato thënie, duke i marrë për bazë dhe duke i zbatuar ato, madje jo vetëm kaq, por me plot entuziazëm i përhapën dhe shpërndanë. Mjerë, çfarë fatkeqësie! Në këtë çast e ndjej të nevojshme që ta lë lapsin dhe të qaj dy herë!! Por, çfarë dobie ka të qash?! Dhe deri kur? A nuk ka ardhur koha që të kemi pak shpresë dhe optimizëm (për përmirësim), në mënyrë që të angazhohemi seriozisht dhe me zell, duke vepruar konkretisht për të vazhduar përpara rrugën drejt

qëllimit, duke e njohur realitetin nëpërmjet dritave vezulluese të së vërtetës?

NDËRMJET TYRBEVE DHE BURIMEVE TË REFERENCËS (LIBRAVE BAZË)

Kam vizituar një numër të madh të vendeve ku janë të varrosur imamët dhe njerëzit e mirë, duke u takuar me shumë nga zotërinjtë, shujhët dhe dijetarët që e zbatonin diturinë e tyre. Gjithashtu, kam lexuar shumë nga librat që janë burim bazë reference, por gjithmonë me shpirtin kërkues, analizues dhe vlerësues.

Gjatë gjithë kësaj kohe, hasja në gjëra të pranueshme dhe të papranueshme, ndonjëherë hasja çudira dhe pyesja ku është realiteti këtu?! E në veçanti, nëse marrim parasysh faktin se disa nga këto çudira janë tepër të zorshme për t'u mbrojtur apo për t'u justifikuar. Ndonjëherë, këto situata janë të papërballueshme përpara pyetjeve dyshuese, apo sulmeve të kundërshtarëve sepse realisht, nuk ka me çfarë të mbrohet apo që të jetë e vlefshme për t'u mbrojtur me të. Që në momentet e para vihet re dobësia, fillon të belbëzojë i çoroditur, duke kërkuar ndonjë mënyrë për të dalë nga pozicioni i vështirë në të cilin gjendet, nga ai tunel i gjatë që nuk i sheh dot dritën në fund. Pra, në këto situata ose duhet të heshtë ose të debatojë, më e mira e të dy zgjedhjeve është përsëri e hidhur, pra cila është zgjidhja?!

CILA ËSHTË ZGJIDHJA?

A mund të mjaftohemi duke thënë që këto gjëra janë gënjeshtër, apo të pretendojmë se janë të futura në mënyrë dashakeqe?! Duke qenë se këto janë fakte të qarta dhe të

pakundërshtueshme, tezat e mësipërme nuk janë asgjë më shumë se sa një mënyrë për t'i shpëtuar gjendjes së sikletshme dhe për t'iu shmangur sadopak realitetit, megjithëse është i bindur për vërtetësinë e asaj që thuhet, më shumë se sa kundërshtari i tij. Nëse kjo temë do kishte të bënte me një çështje apo dy, apo qoftë edhe me njëqind apo dyqind. Edhe nëse do bëhej fjalë për të kritikuar ndonjë rresht të shkruar në ndonjë libër të harruar, apo qoftë dhe të botuar, problemi do të ishte i lehtë. Mirëpo, duke qenë se çështjet që bien ndesh me Kuranin dhe të vërtetën, e që përplasen me fenë dhe logjikën, e që njerëzit me natyrë të pastër dhe integritet moral neveriten prej tyre, janë me qindra, madje me mijëra. Këto çështje janë të vërtetuara në burimet e tyre të referencës, në librat e tyre bazë, në librat e shumtë që gjenden në duart e njerëzve, të botuara apo dorëshkrime, në kohët e hershme apo të sotme: libra që shiten nëpër librari, që përdoren për mësimdhënie nëpër shkolla, për ligjërata në publikun e gjerë, të lejuara ose të ndaluara, pa hasur kurrfarë rezistence apo kritike, nga i madhe i vogël. Kjo është një temë, tek e cila nuk bëjnë dobi përpjekjet e përgënjeshtimit dhe as nuk mund të kurohet duke e arnuar, përkundrazi, patjetër duhet zhvilluar një operacion (kirurgjikal) i mirëfilltë, madje i përmasave të mëdha. Për një moment le të lemë mënjanë veprimet e shumta që janë në kundërshtim të haptë me Sheriatin dhe moralin, veprime, të cilat i shohim me sytë tanë duke u kryer (haptazi) tek varret e *evliave* dhe *të zgjedhurve*! Veprime, për të cilat nëse ndonjë zë i mekur guxon të flasë, duhet t'i thuhet: “Mos u merakos, këto janë veprime të injorantëve nga populli i thjeshtë!” Por, Allahu e di shumë mirë se në këto veprime marrin pjesë dhe madje janë të zhytur në llumin e tyre, shumë nga ata që veshin çallmat, që zgjasin mjekrat (për t'u shtirur si hoxhallarë) dhe e veshin petkun fetar, apo së paku i shohin këto veprime pa kurrfarë reagimi kritik. Këtu lind pyetja e

rëndësishme: Cili është roli i dijetarëve (të shijave) në këtë mes?! Pse e gjithë kjo heshtje?! Këto veprime janë shndërruar në praktika normale që njerëzit i kanë bërë zakon t'i kryejnë, duke jetuar në këtë mënyrë jetën e tyre shoqërore të përditshme.

A MUND TË PRANOHET LOGJIKISHT QË KJO TË JETË RRUGA E EHLU BEJTIT?!

A mund të jetë në përputhje me Sheriatin, a mund të pranohet logjikisht, a mund të kapërdihet që të shohim këto veprime duke ndodhur dhe më pas të heshtim, duke lejuar që padrejtësisht t'i faturohen *ehlu bejtit*, madje ata që i kryejnë këto veprime i bëjnë në emër të *ehlu bejtit*. Padyshim, është e pamundur për ne që të heshtim ndaj kësaj gjendjeje, heshtje e cila nuk mund të justifikohet në asnjë lloj mënyre sepse degradimi ka arritur (madje ka tejkaluar) fundin e humnerës.

MEGJITHËSE SHUMËKUJT (NGA SHIJAT) NUK DO T'I PËLQEJË KJO GJË

Unë e di shumë mirë dhe jam më se i bindur se kjo britmë e imja do të shkaktojë bezdi dhe shqetësim (sepse përmban gjëra të dhimbshme), do të shkaktojë çjerrje dhe antipati, por më mjafton si justifikim dhe arsye për të ecur para, fakti që realiteti është i hidhur dhe se gjendja ka arritur në atë pikë ku nuk bën dobi butësia dhe të shprehurit indirekt, as kujdesi i tepruar dhe turpi (me të paturpshmit). Bëhet fjalë për tumor, madje, për një tumor të madh, i cili që të kurohet ka nevojë për ndërhyrjen e bisturisë. Kemi të bëjmë me një stok tepër të madh dhe me një barrë tepër të rëndë. Duhet patjetër një përllogaritje e saktë, një vlerësim i

shëndoshë, një pastrim i përgjithshëm, duke u rikthyer nga e para, në krye të rrugës, në mënyrë që të arrijmë të dallojmë shi'izmin e vërtetë nga ai i transformuar.

Kapitulli i parë

RRUGA E EHLUL BEJTIT MES TEORISË DHE PRAKTIKËS

TEMA E PARË: PROFETI DHE IMAMËT, HISTORIA E MREKULLUESHME.

MUHAMEDI (SALALLAHU ALEJHI UE SELEM!), I PARI I ASKETËVE.

Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) ishte njeriu më asket dhe ai që shmangej më shumë nga bukuritë e kësaj bote dhe kënaqësitë e saj. Ishte i angazhuar plotësisht me çështjet e fesë dhe të davetit më shumë se sa të preokupohej për nevojat vetjake dhe kërkesat familjare. Ai flinte në tokë ose shtronte mbi të rrogzin me degë hurmash që linte shenja në trupin e tij dhe njerëzit i thoshin: “O ResulAllah, pse të mos përdorësh një dyshek të butë?” Ai përgjigjej: “Çfarë më duhet dynjaja?! Unë në këtë dynja jam si një udhëtar që pushon nën hijen e një peme, e më pas u largohet prej saj.” Njëherë, pa disa njerëz që po ripararinin shtëpinë e tyre prej druri dhe kallamash dhe i pyeti: “Çfarë po bëni?” Ata iu përgjigjën: “Është vjetruar dhe po e riparojmë.” Tha: “Çështja (e kësaj dynjaje) është më e shkurtër se aq” (pra, ju do jeni në dynja për një kohë më të shkurtër se sa kjo shtëpi që prishet). Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) nganjëherë shtrëngonte një gur rreth barkut të tij, për shkak të urisë. Mund të kalonte një apo dy muaj, pa e ndezur zjarrin në shtëpinë e tij (ngaqë nuk kishin çfarë të gatuanin) dhe ushqimi i tij, në të shumtat e rasteve ishte uji dhe hurmat. Ai kishte pranë

fqinj ensarë, të cilët herë pas here i dërgonin (në formë dhurate) qumësht.

Ai u largua nga kjo dynja duke mos u ngopur me bukë gruri apo elbi, megjithëse në kohët e fundit të jetës së tij i kishte mundësitë për diçka të tillë, pasi Allahu i dha fitore të shumta ku u furnizuan me plaçka të mëdha lufte dhe pasuri që vinin nga të gjitha anët. Njëherë, gratë e tij iu ankuan për vështirësitë e jetës që po përjetonin, ngjarje kjo që ka ndodhur pas betejës së Hajberit, nga ku muslimanët dolën me pasuri të mëdha dhe vunë nën zotërim tokat e çifutëve, atëherë zbriti fjala e Allahut në suren Ahzab, duke i vënë gratë e Profetit përballë dy alternativave: të qëndrojnë me të në atë gjendje që ai jetonte ose të ndaheshin prej tij dhe të kërkonin nga begatitë e Allahut në tokë, nëse ato dëshironin më shumë. Allahu thotë: “O ti i Dërguar! Thuaju grave të tua: “Nëse dëshironi jetën e kësaj dyniaje dhe bukuritë e saj, atëherë ejani t’u jap nga plaçkat e dynjasë dhe t’ua ndaj në mënyrën më të mirë, ndërsa nëse dëshironi Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe botën tjetër, atëherë dijeni se Allahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato nga ju që do të jenë vepër-mira” [Ahzab 28-29]. Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!), nganjëherë falej i ulur për shkak se nuk qëndronte dot në këmbë nga uria e madhe. Një ditë Fatimja shkon tek Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) me një copë bukë. Ai kur e pa e pyeti: “Çfarë e ke atë oj Fatime?” Ajo iu përgjigj: “Gatova bukë dhe nuk mund të rrija pa të sjellë një copë prej saj. Ai i tha: “Ky është ushqimi i parë që do të hajë babai yt pas tre ditësh (pa ngrënë asgjë).” E gjithë kjo nuk ishte si rezultat i pamundësisë së tij, përkundrazi po të donte, e kishte dynjanë para duarve të tij, por i jepte përparësi zuhdit (asketizmit), i shmangej lakmisë dhe udhëhiqej nga parimi i të kënaqurit me pak. Ai ia ndaloi vetes dhe familjes së tij sadakatë dhe zekatin, madje i konsideroi sadakatë “mbeturinat e njerëzve”, duke dhënë kështu, me veten dhe familjen e tij shembullin më të lartë.

Allahu i ofroi atij që t'ia mbushte luginën e Mekës plot me flori, por përgjigjja e tij ishte “Jo, o Zoti im, nuk e dëshiroj një gjë të tillë, jam i kënaqur të ngopem një ditë dhe të kem uri ditën tjetër. Kur të ngopem do të të falënderoj dhe lavdëroj, ndërsa kur të kem uri do të përulëm para Teje dhe do të të lutem.” Ai u largua nga kjo dynja dhe kishte lënë peng këmishën e hekurt të luftës tek një çifut, kundrejt dy kilogramëve elb. Pra, a i takon ndokujt tjetër më shumë se sa *ehlu bejti* që ta marrin për shembull atë dhe ta pasojnë? !

NË HAPAT E GJYSHIT DHE PRIJËSIT TË TYRE

Ehlu bejti, në përgjithësi dhe imamët e tyre të mëdhenj, në veçanti, iu përmbajtën pasimit të Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) të tyre. Ecën në rrugën e tij, pasuan menhexhin e tij, duke zgjedhur jetën askete, ndershmërinë, virtytet e larta dhe pastërtinë shpirtërore, duke qenë të panevojshëm për atë që njerëzit posedojnë, duke qenë ata që e dinin, e kuptonin dhe e zbatonin më së miri fjalën e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!): “Dora e sipërme është më e mirë se dora e poshtme.” Librat e historisë islame, ato të haditheve, të biografive janë të mbushura me një trashëgimi të pasur transmetimesh që tregojnë për gjurmët e tyre të mira, për mbështetjen tek Zoti i tyre, lidhjen e tyre me Të, kthimin tek Ai në bollëk dhe në vështirësi, në fatkeqësi dhe në mirësi. Ata (*ehlu bejti*) e përmbushën detyrën e tyre kundrejt njerëzve, duke i orientuar, duke u mësuar të vërtetën, gjë për të cilën shpresonin vetëm shpërblimin e Allahut, madje refuzonin t'ia shtrinin dorën ndokujt, përkundrazi ishin ata që iu jepnin njerëzve dhe sakrifikonin për ta nga koha, mundi dhe pasuria e tyre. Përgjatë gjithë këtij kontributi, vepra e tyre duket sikur thotë: **“Ne po ju ushqejmë për hir të Allahut. Nuk kërkojmë prej jush shpërblim dhe as falënderim.”** [Mearixh: 9]

IMAM ALIU (RADIJALLAHU ANHU)

Një prej thënieve më të transmetuara të Aliut RadijAllahu anhu është: “O ju njerëz! Nga dy gjëra ua kam më shumë frikën: Nga pasimi i tekave dhe shpresa për një kohë të gjatë. Pasimi i tekave të pengon nga mësimi i së vërtetës, ndërsa të shpresuarit për një kohë të gjatë të bën ta harrosh Ahiretin. Vërtetë, kjo dynja po mbaron me shpejtësi dhe nuk ka ngelur prej saj veçse pak.

Në një thënie tjetër e gjejmë: “Në të vërtetë, dynjaja po largohet dhe po afrohet Ahireti, ku secila prej tyre ka banorët (të dhënë) pas saj. Bëhuni nga ithtarët e Ahiretit dhe mos jini nga ithtarët e dynjasë. Secili do përfundojë tek ajo gjë që dëshiron. Me të vërtetë sot është koha për të vepruar dhe nuk ka llogari, ndërsa nesër do të ketë llogari dhe aspak mundësi për të vepruar.”⁴

Aliu (RadijAllahu anhu!), duke përkujtuar Profetin (SalAllahu alejhi ue selem!) tha: “Ai e përçmonte dynjanë dhe e zhvlerësonte atë. Ai e dinte se Allahu ia kishte shmangur dynjanë me dëshirën e Tij, ndërsa i kishte dhënë nga bollëku i dynjasë disave në formë përçmimi. Ai iu shmang dynjasë me zemrën e tij dhe e bëri të vdekur tek ai përkujtimin e saj. Ai dëshironte që syri i tij të mos i shihte bukuritë e saj, në mënyrë që të mos merrte nga stolitë e saj, apo të shpresonte që të jetonte më gjatë në të.”⁵

FATKEQËSIA JONË MË E MADHE

Fatkeqësia që na ka goditur, duke na bërë si të dehur e që nuk kuptojmë, nuk ndërgjegjësohemi dhe nuk logjikojmë se ku po

⁴ Sherhu nehxhil belagah 2/318.

⁵ Sherhu nehxhil belagah 7/217.

shkojmë, është se ne i lexojmë fare mirë këto thënie, madje i transmetojmë dhe i komunikojmë, por vetëm sa për t'u mburrur dhe krenuar, pa e kuptuar se kjo nuk do të na bëjë kurrfarë dobie tek Allahu nëse ne nuk i vëmë ato në zbatim apo më së paku t'i kërkojmë vetes sonë që të vëmë në jetë qoftë dhe një pjesë të vogël të këtyre këshillave madhështore: **"O ju që keni besuar! Pse po e thoni atë që nuk e veproni. Tek Allahu është shumë e rëndë që ta thoni atë që nuk e veproni."** [Saf 2 - 3]. Na ka goditur një sëmundje kronike: humbja e ndjeshmërisë dhe mos perceptimit të asaj që lexojmë apo që dëgjojmë nga historitë e njerëzve të devotshëm, nga urtësitë e këshilluesve të moçëm. Këto thënie për ne janë një rutinë për t'u dëgjuar dhe për t'u transmetuar, i përcjellim ato ashtu siç bën një shofer i dehur, i cili kalon semaforin e kuq duke mos qenë i ndërgjegjshëm se çfarë do të thotë kjo dhe duke mos kuptuar gjë tjetër, përveçse ngjyrës së dritës, apo bukurisë së krijimit artistik, apo diçka tjetër fare e parëndësishme, ndaj dhe kemi këtë hendek të madh midis fjalëve dhe veprave.

FJALË TË MBËSHTETURA NGA VEPRAT

Jeta e prijësit të besimtarëve (Aliut) ishte një përkthyesë besnike e fjalëve në vepra. Jetoi si të varfrit edhe atëherë kur ishte udhëheqës suprem i shtetit Islam. E frenoi veten dhe familjen e tij nga mirësitë e kësaj bote, në mënyrë që të ishin shembull për t'u ndjekur. Dëgjoje me kujdes se si ai na tregon për gjendjen e vëllait të tij, Ukejlit, i cili ndodhej në varfëri aq ekstreme, saqë nuk kishte as një grusht miell dhe vinte tek prijësi i besimtarëve (Aliu) për t'i kërkuar që t'i jepte ndihmë nga arka e shtetit, me të cilën të përballonte urinë familjare që e kishte pllakosur, saqë fëmijët e tij kishin humbur ngjyrën e fytyrës nga uria dhe me flokë të shpupuritur, por megjithatë Aliu e kthente mbrapsht dhe na tregon

për këtë duke thënë: “E kam parë Ukejlin aq të varfër sa që u detyrua të më kërkonte një sa` (njësi matëse) elb nga arka e shtetit. I kam parë fëmijët e tij të raskapitur, u kishte ikur ngjyra e fytyrës nga varfëria dhe u kishin dalë eshtrat. Ai më erdhi disa herë me këmbënguljen e nevojtarit, duke e përsëritur kërkesën e tij. Unë e dëgjova me aq vëmendje sa që ai mendoi se unë do e shkel fenë time për hir të farefisnisë dhe do heq dorë nga rruga ime. Atëherë unë skuqa në zjarr një hekur dhe ia afrova pranë trupit të tij në mënyrë që të kuptojë se për çfarë bëhet fjalë, ai ulëriti me të madhe nga dhimbja dhe për pak sa nuk u dogj. Atëherë i thashë: “Mjerë për ty o Ukejl, po rënkon nga një hekur i skuqur i një njeriu, i cili ta afron sa për të kuptuar dhe ndërkohë dëshiron të më shtysh drejt zjarrit që e ka ndezur i Plotfuqishmi për shkak të zemërimit të Tij?! A po rënkon nga lëndimi ndërsa unë të mos rënkoj nga dënimi që më pret (nëse të përgjigjem ty)?! Akoma më e çuditshme është përpjekja e shejtanit për të më mashtruar, unë të them se ti po kërkon sadaka apo zekat? Që të dyja janë të ndaluara për *ehlu bejtin*. Ai (shejtani) thotë: “Jo! As njëra, as tjetra, por le të jetë dhuratë.” I them: “Mjerë për ty! A ke ardhur të më mashtrosh nga feja e Allahut?!”⁶

Ajo që unë vërej është se turpi dhe demaskimi tringëllin në shumë ‘xhybe’ dhe tek shumë ‘mjekra’ (pseudo-hoxhallarë), kur bën krahasimin ndërmjet atyre që përmendëm dhe gjendjes së këtyre xhybeve të cilat po jetojnë në pasuri të pallogaritshme, në luks, tejngopje dhe rehati pamasë në kurriz të pasurisë së njerëzve. Jo vetëm kaq, por ka akoma fakte të tjera më të hidhura dhe më tronditëse!

⁶ Sherhu nehkhil belagah 11/245.

Ndërsa Aliu (RadijAllahu anhu!) thoshte: “Pasuria është burimi i tekave dhe epsheve.” ⁷ Kur është parë në ëndërr Aliu RadijAllahu anhu i veshur me rroba të vjetra, u pyet për kuptimin nga disa dhe ai u përgjigj: “Me këto rroba zemra është më e devotshme, shpirti është më i përlurur dhe është shembulli i besimtarit.” ⁸ Aliu RadijAllahu anhu shpenzonte në të mirë të popullit të gjithë buxhetin e shtetit, duke ua dhënë atyre që e meritonin e më pas e fshinte vetë me fshesë (dhomën e rezervës së shtetit) dhe falte në të dy rekate, sepse aq i takonte atij prej saj. ⁹ Ndërsa, më vonë erdhën njerëz të atillë që pasuria i fshiu ata me fshesë.

TEUHIDI I PASTËR

Aliu RadijAllahu anhu thoshte: Çdo gjë i përket Atij, çdo gjë ekziston falë Tij, Ai është Pasuruesi i çdo të varfëri, Krenuesi e çdo të nënçmuari, Dhënësi i forcës për çdo të dobët, Strehuesi dhe Dhënësi i zgjidhjes të çdokujt që është në hall. ¹⁰ E përsëris atë që thashë më sipër se fatkeqësia jonë kryesore është se ne i lexojmë thëniet e imamëve thjesht për t’u mburrur dhe lavdëruar e jo për t’i marrë si shembull dhe për t’i zbatuar.

Sa e sa njerëz (nga shijitët) ka që kur janë në hall dhe vështirësi, i kërkojnë ndihmë dhe derman ndonjë krijese, u luten

⁷ Sherhu nehkhil belagah 18/193.

⁸ Sherhu nehkhil belagah 18/48.

⁹ Sh.p: Së pari: Allahu ealem (e di më së miri) se sa e vërtetë është kjo histori, por nga vetë formulimi lë të kuptohet që është diçka e shpikur sepse nuk ka se si prijësi i besimtarëve ta boshatisë të gjithë arkën e shtetit, duke mos lënë fare rezerva.

Së dyti: Falja e dy rekateve aty është diçka e pabazë, gjë të cilën nuk mund ta paramendojmë ta ketë bërë Aliu RadijAllahu anhu.

¹⁰ Sherhu nehkhil belagah 7/194.

krijesave, kërkojnë mbështetje tek krijesat, u ofrojnë kurbane dhe zotime krijesave, thërrasin në ndihmë me emrin e krijesës, të gjitha këto në vend që t'ia drejtojnë Allahut, ia kushtojnë krijesës! Duke mos qenë të ndërgjegjshëm se ata janë në një rrugë që nuk ka të bëjë aspak me rrugën e imam Aliut.

A nuk është ai (Aliu) që thoshte se gjëja më e mirë, me anë të së cilës njerëzit i afrohen Allahut është besimi tek Allahu dhe Profeti i Tij dhe lufta në rrugën e Allahut që konsiderohet si kulmi i fesë. Dëshmia e teuhidit është natyrshmëria e pastër, falja e namazit është feja, dhënia e Zekatit është obligim i patjetërsueshëm, sadakaja e dhënë fshehtas i shlyen gabimet. Ndiqni udhëzimin e Profetit tuaj sepse është udhëzimi më i mirë, ndiqni rrugën e tij sepse është rruga më e drejtë, mësojeni Kuranin sepse është biseda më e mirë dhe meditoni mbi kuptimet e tij sepse është lulëzimi i zemrave.¹¹

GJYKO SE KU NDODHEMI NE NË RAPORT ME KËTO THËNIE

Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) ka thënë: “Atë që e lë mbrapa vepra e tij nuk e çon atë përpara prejardhja e tij.”¹² Aliu r.a ka thënë: “Mik dhe i dashur i Muhamedit është ai që i bindet Allahut, edhe nëse është i largët me prejardhje, ndërsa armik i Muhamedit është ai që nuk i bindet Allahut, edhe nëse është i afërt me farefisni.”¹³

¹¹ Sherhu nehxhil belagah 7/121.

¹² Sherhu nehxhil belagah 19/331. Hadithi është i saktë e transmeton Muslimi, Tirmidhiu, etj.

¹³ Sherhu nehxhil belagah 18/252.

Pyetja që shtrohet është se sa zbatim gjejnë këto parime madhështore në realitetin (shi'it)?!

ATA JEPNIN DHE NUK PRANONIN TË MERRNIN

Fëmijët dhe nipërit e Aliut (RadijAllahu anhu!) ndoqën hapat e tij, të cilat ishin të vijëzuara sipas hapave të Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!). P.sh: Imam Hasani (RadijAllahu anhu!), njëherë hyri në treg për të blerë diçka. Kur e pyeti dyqanxhiun se sa kushtonte, ai fillimisht i tregoi çmimin, por më pas kur mori vesh se kishte të bënte me Hasanin, të birin e Aliut, nipin e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!), ia uli çmimin në formë respekti dhe nderimi, por Hasani (RadijAllahu anhu!) nuk e pranoi këtë sjellje dhe nuk e bleu fare atë plaçkë, me arsyetimin se nuk pranonte që të përfitonte favore, për shkak të pozitës e duke qenë i afërm i Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!). Shembull tjetër: Imam Sexhadi, kur udhëtonte maskohej që të mos njihej, në mënyrë të mos i jepeshin mallra pa pagesë dhe thoshte se nuk dëshironte që të përfitonte për shkak të lidhjes time me Profetin (SalAllahu alejhi ue selem!), ndërkohë jepte diçka të tillë.

Unë kam arritur në përfundimin se t'i përmbahesh dedikimit tek familja e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) në ditët e sotme është shndërruar në zanat, madje është zanati më i përhapur dhe më popullor për të përfituar furnizim, luks dhe të mira materiale pa u lodhur¹⁴. Kjo praktikë është tepruar deri në atë masë, sa që vendosen shenja për të treguar se është nga *ehlu bejti*, madje vetë personi i tillë është i gatshëm të ta kujtojë këtë fakt nëse ti pa dashje harron dhe të kërkon t'i japësh “të drejtat” nëse ti tregohesh neglizhues. Sa larg është ky qëndrim me thënien e imam el Bakirit

¹⁴ Sh.p: Autori i referohet realitetit iranien dhe iraken

nëse i krahasojmë: “Nëse e shikoni dijetarin që i do pasanikët dijeni se ai është njeri i dhënë pas dynjasë.”

Ajo që po ndodh sot është se “dijetarët” janë njerëzit që i duan pasanikët, më shumë se çdokush tjetër dhe janë ata që përpiqen t’u afrohen pasanikëve me lajka, përveç një pakice prej tyre.

Imami Es-Sadik jepte aq shumë sadaka, sa që nuk linte asgjë për fëmijët e tij. Ai ishte si gjyshi i tij Zejnul Abidini, i cili jepte sadaka fshehurazi. Kur binte nata dhe nxihej errësira, atëherë merrte një trastë me bukë, mish dhe monedha, e më pas shkonte tek nevojtarët e Medinës dhe u jepte, duke mos e njohur njeri. Po ashtu, edhe i biri, El Kadhimi ka qenë shembull për qesen e tij të bamirësisë.

ATA USHQEHESHIN NGA PUNA E DUARVE TË TYRE

Prijësi i besimtarëve, Aliu (RadijAllahu anhu!), gjatë kohës kur ishte halife, e fitonte riskun me mundin e punës së tij në një kopsht në periferi të Kufes, ashtu sikurse edhe imamët e tjerë; sikurse tregohej edhe për imamin Es-Sadik që kishte një bahçe ku punonte. Një ditë prej ditësh, e takoi një burrë në rrugë kur po kthehej nga bahçea e tij, i mbytur në djersë. Personi e qortoi pse punonte, por u shpreh në mënyrë të paedukatë, atëherë imami i tha: Kam dalë të kërkoj riskun në mënyrë që mos t’ia kem nevojën njerëzve si puna jote¹⁵. Gjithashtu, El Kulejni ka transmetuar nga Ebu Hamza, që ka thënë: “E kam parë Ebu Husenin që punonte në tokën e tij, i mbytur në djersë. Iu përgjigja: “U bëfsha kurban për ty, ku janë burrat që punojnë? Tha: “O Ali, kanë punuar me duart e tyre

¹⁵ Furu el Kafij 5/74.

njerëz që janë më të mirë se unë dhe babai im.” E pyeta: “E kush e ka bërë këtë?” Ai tha: “Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!), Aliu (RadijAllahu anhu!), paraardhësit (gjyshërit) e mi, të gjithë kanë punuar me duart e tyre.¹⁶

Dikush erdhi tek Ebu Abdullahi dhe tha: “Lute Allahun për mua që të më japë bollëk në pasuri.” Ai ia ktheu: “Nuk lutem për ty, por kërkoje, ashtu siç të ka urdhëruar Allahu (të veprosh).¹⁷

TEMA E DYTË: SISTEMI I JETËS SIPAS ISLAMIT

Islami është rregullator gjithëpërfshirës dhe i mesëm. Islami solli një rregullore madhështore për jetën e njeriut, rregullore e cila karakterizohet nga tërësia gjithëpërfshirëse dhe të qenurit i mesëm. Përmban norma që rregullojnë raportin e njeriut me Zotin e tij, raportin me vetveten e tij dhe raportin me shoqërinë ku ai jeton, respektivisht, duke zbatuar obligimet ndaj Allahut dhe ritet e adhurimit, duke përmbushur të drejtat e shoqërisë, duke bërë bamirësi ndaj njerëzve dhe duke pasur sjellje shembullore ndaj institucioneve të shoqërisë. Po ashtu, edhe duke i dhënë hakun vetes për nevoja dhe dëshira. Në të gjitha këto, karakterizohet nga mesataria, duke shmangur mbizotërimin e njërit aspekt mbi tjetrin, duke qenë një njeri që jeton në një zinxhir të mirë-organizuar ku arrin të kënaqë Zotin e tij dhe t'i japë vetes e shoqërisë jetesën e përshtatshme, qëndrueshmërinë e parametrave dhe duke fituar jetesën e mirë të botës tjetër. Këtë parim e thekson Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) ku thotë: “Ndaj Zotit tënd ke obligime, ndaj familjes tënde ke obligime dhe ndaj vetes tënde ke obligime!” Këto obligime i gjejmë të shtjelluara në fenë tonë kështu: “Jemi të

¹⁶ Furu el Kafij 5/75.

¹⁷ Furu el Kafij 5/75.

urdhëruar ta adhurojmë vetëm Allahun dhe të hedhim poshtë adhurimin e çdokujt tjetër veç Tij, të mos lidhemi pas asgjëje tjetër përveç Tij, të mos i lutemi apo kërkojmë ndihmë apo shpëtim askujt tjetër përveç Tij, të mos betohemi për dikë veç Tij, të mos i frikësohemi askujt veç Tij, vetëm tek Ai t'i kemi shpresat, vetëm Atij t'i mbështetemi, Atij t'i bindemi, nga Ai të gjykohejmë, të ecim sipas Sheriatit të Tij, vetëm Atij t'i kushtojmë çdo adhurim, e të cilat nuk lejohet që t'i kushtohen askujt tjetër veç Tij.

Allahu ka bërë detyrim pesë namazet, duke i caktuar kohët e tyre, ashtu siç ka obliguar agjërimin e Ramazanit, dhënien e zekatit, Haxhin në Qabe, ndërtimin e xhamive dhe gjallërimin e tyre. Ka ligjëruar dhikrin, leximin e Kuranit, meditimin dhe zbatimin e tij. Ka vlerësuar Xhihadin dhe davetin si kulminacionin e Islamit. Allahu ka sqaruar se të gjitha këto adhurime duhet të burojnë nga zemra, nga sinjeriteti, vërtetësia në besim, nga frikë-respekti me përulje (khushu'), nga frika, nga dashuria, nga shpresa, nga bindja e thellë, nga mbështetja, nga meditimi i shëndoshë.

Po ashtu, ka ligjëruar sadakanë dhe bamirësinë për njerëzit, duke filluar nga të afërmit, jetimët, të ngratët, të varfrit, ata që mbeten në rrugë dhe u ndërpritet udhëtimi nga pamundësia ekonomike për të vazhduar. Na ka porositur për fqinjin dhe, në përgjithësi, që të kemi raport të mirë me të gjithë njerëzit.

Sistemi i Islamit e ka rregulluar çështjen e familjes, duke ligjëruar martesën dhe duke ndaluar zinanë. Ka sqaruar të drejtat e bashkëshortit dhe bashkëshortes, në situatë mirëkuptimi dhe mospajtimi. Islami ka nxitur prindërit për mirë-edukimin e fëmijëve, duke i dhënë rëndësi të veçantë kësaj pike. Në të njëjtën kohë ka urdhëruar fëmijët për mirësjellje dhe respekt ndaj prindërve, duke e shoqëruar këtë të drejtë me kushtin themelor të fesë që është Teuhidi. Islami ka urdhëruar për çiltërsi, vërtetësi në thënie, përmbushje të premtimeve, ruajtje të shikimit, ndershmëri,

etj. Po ashtu, ka organizuar rregullat e tregut, duke lejuar shitblerjen dhe ndaluar kamatën, mashtrimin, monopolizimin; ka urdhëruar për tolerancë dhe falje, në mënyrë që të bashkëpunohet për të mira dhe devotshmëri. Islami e mëson njeriun si të lahet, të pastrohet, të vishet, të zbukurohet, të ushqehet, të flejë (sa është e nevojshme), etj. Pra, ka trajtuar çdo aspekt, çdo fragment të jetës njerëzore, duke e organizuar më së miri, duke përfshirë fushën e bujqësisë, edukimit, arsimimit, shëndetësisë, ushtrisë, etj. Nëse secili nga ne do t'i përmbushte këto detyrime, ashtu siç ka urdhëruar Allahu, atëherë do të përmirësohej gjendja e individit dhe shoqërisë, por nëse kemi prishje të ekuilibrave të lartpërmendur si p.sh: mbizotërimi i ndjenjës së plotësimit të tekave vetjake, epshore, materialiste, kundrejt obligimeve që ka caktuar Allahu (apo ndaj njerëzve të tjerë të shoqërisë ku ai jeton), atëherë do të ndodhë ç'rregullimi dhe trazira. Zëvendësohet sistemi i dobishëm me ç'rregullimin dhe degradimin. Allahu në fjalën e Tij ka thënë të vërtetën: “Janë shfaqur trazirat në tokë dhe në det, për shkak të sjelljeve të njerëzve” [Rrum 41]. Islami, duke e paraqitur këtë sistem madhështor, i bën thirrje muslimanit që të përkushtohet për t'i kryer detyrimet ndaj Allahut dhe ndaj shoqërisë në mënyrën më të mirë, madje e nxit besimtarin që të përpiqet në maksimum në këtë drejtim. Në të njëjtën kohë, Islami e fton që t'a lehtësojë veten nga plaçkat e kësaj dynjaje dhe kënaqësitë e saj, duke mos qenë i angazhuar shumë me të, d. m. th të jetë asket. Pra, kemi dy aspekte, nxitjen për të shtuar nga veprat e Ahiretit dhe nxitjen për t'u shmangur nga dynjaja. Në lidhje me të parën, vërejmë se Islami e ka trajtuar të drejtën e Allahut dhe atë të shoqërisë në dy nivele:

1. Obligimet, në të cilat nuk ka vend për tolerancë dhe neglizhencë.

2. Veprat vullnetare të pëlqyeshme, të cilat preferohet që njeriu t'i shtojë sa më shumë prej tyre, duke iu premtuar shpërblim i madh.

Pra, Allahu na urdhëron të falemi, të agjërojmë dhe të shtojmë veprat vullnetare mbi nivelin e obliguar, siç janë sunetet e ditës, namazi i natës, agjërimi i të hënës dhe të enjtes. Ka obliguar mirësjelljen me prindërit, dhënien e zekatit, etj., të cilat bëjnë pjesë tek të drejtat shoqërore, ku gjithashtu bëjnë pjesë sadakatë vullnetare, ushqyerja e të varfërve, veçanërisht duke u dhënë nga mishi i kurbanit, gjë të cilën Allahu e përmend të bashkangjitur me namazin ku thotë: **“Falu vetëm për Zotin tënd dhe bëj kurban vetëm për Të (në emër të Tij)!”** [Keuther 1 - 2].

Nga ana tjetër vërejmë se Allahu na nxit që të mos teprojmë në aspektin e ngrënies dhe pirjes, në banesa dhe në raporte intime, duke mos i vlerësuar si të obligueshme, apo të pëlqyeshme dhe nuk i ka atribuuar shpërblim apo lavdërim, përkundrazi maksimumi që mund të thuhet është se këto që përmendëm është se janë të lejuara, ku nuk ka përparësi veprimi i tyre ose dorëheqja nga to. Kjo për vetë arsyen e thjeshtë se Sheriati nuk ka ardhur që të nxisë njerëzit të garojnë në pasuri apo në ndërtimin e pallateve, apo që të përjetojnë kënaqësi fizike. Sheriati nuk vendosi shpërblim apo vlerë për këto veprime në vetveten e tyre për sa kohë që dobia e tyre është individuale, ndërsa shpërblimi dhe lëvdata është përcaktuar për ato raste kur dobia e asaj gjëje i kalon kufijtë e individuale si p.sh: dhënia e sadakasë që është komplet e kundërt me marrjen e pasurisë, me grumbullimin e saj dhe shijimin e saj.

Islami ka urdhëruar për ndershmëri morale, për ulje të shikimit dhe ruajtje të nderit. E ka vlerësuar martesën si një institucion me qëllim fisnik dhe të lartë që është shumë më lart se sa thjesht kënaqësia fizike, e cila është përjetim i shkurtër. A nuk e

shikoni në këtë këndvështrim atë që Allahu thotë në disa ajete kuranore: **“O ju të cilët keni besuar! Përmendeni Allahun me përmendje të shpesh të shumtë. Madhërojeni Atë mëngjes dhe mbrëmje” [Ahzab 41 - 42]** dhe thotë: **“Vërtet, pasuria dhe fëmijët tuaj janë sprovë për ju” [Tegabun 15]** dhe thotë: **“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote, por veprat e mira janë ato më të qëndrueshmet, më të shpërblyerat tek Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë.” [Kehf 46]**

Allahu na porositi që të shtojmë përmendjen e Tij dhe na tërhoqi vërejtjen nga dy elementë: nga pasuria dhe fëmijët, me qëllim që të mos bëhen shkak për të na larguar nga feja, duke qenë se këto elementë janë pjesë e kësaj dynjaje të shkurtër.

Në mënyrë të përmbledhur dalim në përfundimin se: Është e pëlqyeshme që të shtojmë sa më tepër veprat në aspektin e adhurimit të Zotit dhe bamirësisë tek krijesat, ndërsa në aspektin e kënaqësive fizike dhe pasurisë, kemi porosi që të mos lakmojmë dhe ta frenojmë veten. Në aspektin e parë, gjykimi vërtitet ndërmjet detyrës dhe dëshirës, ndërsa në aspektin e dytë vërtitet ndërmjet lejimit dhe mospëlqimit. Pra, kemi përpjesëtim të zhdrejtë, në aspektin e parë vija e grafikut vjen gjithmonë duke u ngjitur ndërsa në aspektin e dytë vjen duke zbritur saqë mund të futet dhe në zonën e gjynahut dhe haramit. Ky është sistemi i Islamit që Allahu e dëshiron për robërit e Tij. Çdo gjë tjetër jashtë kësaj është përpjekje njerëzore e vendosur prej tyre.

SISTEMI MBI TË CILIN BAZOHET “PSEUDO-FETARIZMI” SHI’IT

Pas një mbikëqyrjeje të gjatë, analize dhe debati, u binda për një realitet të hidhur dhe fatkeq, i cili është fakti se fetarizmi që ne (shijat) praktikojmë sot është në kundërthënie dhe kundërvajtje të

plotë me sistemin e mrekullueshëm hyjnor. Me pak fjalë, mund të themi se kemi të bëjmë me një fe tjetër, e cila është e bazuar dhe e përqendruar tek rëndësia që ka plotësimi i dëshirave personale dhe epsheve trupore nëpërmjet pasurisë, raporteve gjinore dhe tekave të tjera të rëndomta.

Ky fetarizëm i transformuar ka arritur në një nivel të frikshëm në aspektin e çrregullimit dhe deformimit. Tekat dhe kënaqësitë personale kanë mbizotëruar në mënyrë të paimagjinueshme, kundrejt obligimeve të caktuara nga Allahu dhe shoqërisë. Çdo njeri me logjikë të shëndoshë që e mediton këtë situatë, e ka të pamundur të mos e kuptojë qartë dhe prerë se kjo që ka përpara syve nuk është shi'izmi që duhet të ishte dhe kurrresi nuk mund të pranohet logjikisht që kjo të jetë feja e shpallur. Nëse këtij përfundimi i vihet emërtimi shi'izëm, në mënyrë të padrejtë, atëherë që edhe realiteti të jetë i qartë dhe i kuptueshëm, duhet patjetër që të shtojmë prapashtesën *i rremë* (shi'izëm i rremë) në mënyrë që të mos cënohet shijizmi i vërtetë. Nëse duam, mund ta formulojmë kështu “pseudo - shi'izmin”: **Fe e cila në aspektin e adhurimit dhe bamirësisë vepron në kuadër tepër të ngushtë, nuk nxit për të, ndërsa në aspektin e pasurisë dhe raporteve gjinore është i shfrenuar dhe tejet tolerant.**

Kurrresi nuk mund të jetë ky lloj drejtimi, rruga e *ehlu bejtit* dhe është gabim i rëndë ta emërtojmë këtë paçavure *shi'izëm*. Udhëheqësit e kësaj rruge të deformuar dhe përfituesit prej saj i kanë lidhur në mënyrë të habitshme shumë nga ritet e adhurimit (që duhet të ishin të tilla dhe që, shpeshherë janë bidate të shpikura) me ngrënien, pirjen, pasurinë dhe raportet gjinore. I kanë hapur të gjitha portat drejt haramit. Kjo ndodh, pasi mjedisi është i përshtatshëm dhe favorizues, me pengesa të dobëta ose të paqena, me mjete dhe mënyra lehtësisht të arritshme. Në mënyrë të veçantë, faktor përcaktues është dhe fakti se ata arritën t'i mashtrojnë

pasuesit e tyre me thënien “... gjynahet sado të mëdha të jenë, mund të falen, qoftë edhe me shkaqe e vepra të rëndomta, apo justifikime boshe.”¹⁸ Në këtë mënyrë, seksi është bërë realitet i përhapur dhe nuk mund të kuptohet riti fetar i pa shoqëruar me para, seks, dëfrim dhe shfrenim. Gjithashtu, adhurimi i është nënshtruar procesit të fshirjes (eliminimit), apo reduktimit aty ku kanë mundur, qofshin ato edhe obligimet fetare më të rëndësishme, duke i “lehtësuar”, apo duke i transformuar sipas interesit material ose epshor, sa të jetë e mundur. Pra, në pasuri dhe dëfrim epshor gjejmë shfrenimin, tolerancën dhe faljen, ndërsa në adhurime dhe bamirësi gjejmë fshirjen (eliminimin), ngushtimin dhe shkurtimin. Fiksoje mirë këtë parim të tyre, mbaje parasysh dhe më ndiq mua në kapitullin vijues që të të jap shembujt që e detajojnë këtë që të thashë në mënyrë të përmbledhur.

¹⁸ Sh.p: Kanë arritur deri aty, sa kanë përngjasuar me të krishterët në ritualin e indulgjencës.

Kapitulli i dytë

SISTEMI I SHPIKUR DHE REALITETI I SHTHURUR

**TEMA E PARË: TEUHIDI (I TYRE), NGA BESIMI
TEK INTOKSIKIMI (VARËSIA)**

**REFLEKTIME TË SHPEJTA, TË MARRA NGA
MARGARITARËT E AJETEVE KURANORE**

Allahu thotë: “... a mund të jetë i barabartë me atë që Allahu i ka dhënë sukses për të pranuar Islamin dhe ai është në dritë udhëzimi nga Zoti i tij?! Mjerë për ata që i kanë zemrat të ngurta ndaj përmendjes së Allahut. Këta janë në humbje të qartë. Allahu ka zbritur fjalën më të mirë, Librin që pjesët e tij ngjasojnë me njëra-tjetrën dhe përsëriten, prej të cilit drithërohen lëkurat e atyre që i frikësohen Zotit të tyre, e më pas zemrat dhe lëkurat e tyre qetësohen dhe zbuten me përmendjen e Allahut. Ky është udhëzimi i Allahut me të cilin udhëzon kë të dojë, ndërsa atë që Allahu e lë të humbur nuk ka për të udhëzues”. [Zumer 22 - 23].

Medito mbi këtë panoramë dhe më pas bëj krahasimin me panoramën tjetër në ajetet e mëposhtme, në mënyrë që të shohësh se cilës prej këtyre dy panoramave u afrhen më shumë shijat:

“Ndërsa kur përmendet Allahu, i Vetëm (pa shirk) neveriten zemrat e atyre që nuk besojnë Ahiretin. E nëse përmenden të tjerët (idhujt) përveç Tij, ata gëzohen” [Zumer 45].

Kush janë ata për të cilët u tha: **“Të tjerët përveç Tij”**? Ata janë **“Lati dhe Uzaja dhe i treti prej tyre Menati”** [Nexhm 19 - 20], për të cilët në ajetin tjetër thotë: **“Ata që nuk besojnë Ahiretin, i emërtojnë engjëjt me emërtime femërore.”** [Nexhm 27]

Idhujtarët besonin se engjëjt janë bijat e Allahut, ndaj i konsideronin si ndërmjetësues mes tyre dhe Allahut. U luteshin atyre, gëzoheshin kur i përmendnin dhe ndjenin rehati më shumë se sa kur përmendnin Allahun. Përderisa ky është shirku, atëherë çfarë dallimi ka ndërmjet kësaj dhe asaj që ndodh (tek shijat dhe sufite), ku gjejnë më shumë kënaqësi dhe rehati në përmendjen dhe lutjen e “njerëzve të mirë” se sa në përmendjen e Allahut?! A nuk jemi ne (shijat) që qajmë dhe jemi të përulur tek varret, tyrbet, teqetë, më shumë se sa përulemi dhe qajmë para Allahut në shtëpitë e Tij (xhamitë), apo kur lexojmë Librin e Tij, apo dëgjojmë të na lexohet fjala e Tij?!

Allahu thotë: **“Besimtarë të vërtetë janë ata që kur u përmendet Allahu zemrat e tyre dridhen dhe kur u lexohen atyre ajetet e Tij, atyre u shtohet besimi dhe Zotit të tyre i mbështeten. Ata janë që e falin namazin dhe japin nga ajo që i kemi furnizuar. Këta janë besimtarët e vërtetë.”** [Enfal 2 - 4]

“Ata nuk e madhëruan Allahun ashtu siç i takon, megjithëse e gjithë toka do të jetë e kapur në dorën e Tij Ditën e Gjykimit, ndërsa qiejt do të jenë të mbështjellë në të djathtën e Tij. I lartësuar dhe i Pastër është nga çfarë i bëjnë shok.” [Zumer 67]

“Mjerë për idhujtarët, të cilët nuk e japin zekatin.” [Fusilet 6-7]
“Ata i morën ruhbanët (murgjit) dhe ahbarët (rabinët) zota në vend të Allahut.” [Teubeh 31]

Pa asnjë mëdyshje, këtu bëhet fjalë për idhujtari në bindje dhe jo në krijim, duke qenë se çifuti, apo i krishteri (i asaj kohe) nuk besonte se dijetari i tyre krijonte, por i bindej në mënyrë absolute të

njëjtë me bindjen që duhet të kishte ndaj Allahut. Ata i ofronin atyre të gjithë pasurinë, duke u zhveshur nga pasuria dhe logjika, për shkak të ahbarëve dhe ruhbanëve, siç thotë i Lartësuari: **“Vërtetë, shumë nga ahbarët dhe ruhbanët hanin padrejtësisht pasuritë e njerëzve dhe pengonin nga rruga e Allahut.”** [Teubeh 34] Ndërkohë që ne lexojmë në ajetin tjetër kur Allahu tregon se kë duhet të ndjekim: **“Pasoni atë (udhëzues) që nuk ju kërkon shpërblim (pasuri, për atë që ju komunikon).”** [Jasin 21]

Allahu thotë: **“Ditën (e Gjykimit) kur fytyrat e tyre do përmbysen në zjarr, ata do të thonë: Ah sikur ta kishim pasuar urdhrin e Allahut dhe të Dërguarin. Do të thonë: O Zoti ynë ne ndoqëm prijësit dhe udhëheqësit tanë, të cilët na humbën nga rruga e drejtë.”** [Ahzab 66-67]

Allahu thotë: **“Thuaju besimtarëve të ulin shikimet e tyre dhe të ruajnë nderin e tyre. Kjo është më e pastër për ta.”** [Nur 30]

“Zoti yt ka urdhëruar që të mos adhuronit dikë tjetër veç Tij, si dhe të silleni mirë me prindërit.” [Isra 23] **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”** [Fatiha 5]

Allahu na urdhëron që t'i kërkojmë ndihmë dhe mbështetje vetëm Atij, njësoj siç i takon adhurimi vetëm Atij. Mbi këtë parim bazohet thënia që transmetohet nga Aliu r.a se ka thënë: “Kush kërkon ndihmë dhe mbështetje tek dikush tjetër veç Allahut, do të jetë i poshtëruar.”

Allahu thotë: **“Më lutni Mua dhe Unë u përgjigjem”** [Gafir 60]

“Mos lutni dikë tjetër së bashku me Allahun.” [Xhin 18]

“Ai është me ju kudo që të jeni (u sheh, u dëgjon dhe di çfarë bëni).” [Hadid 4]

“Ne jemi më afër tij (njeriut) (me dijen Tonë) se sa damari i qafës.” [Kaf 16]

Këto ajete i japin përgjigje negative çdokujt që e lidh zemrën e tij me dikë tjetër në adhurim veç Allahut, apo i lutet dhe i kërkon derman në fatkeqësi e vështirësi ose mendon se mund t'i japë zgjidhje më të shpejtë se sa Allahu; mendon se Allahun e kemi larg dhe kemi nevojë për një ndërmjetës që të na afrojë tek Ai. Allahu thotë: **“Nëse robërit e Mi të pyesin për Mua, thuaju: Jam afër, i përgjigjem lutjes së lutësit kur ai më lutet” [Bekareh 186]** Kjo është panorama e bukur e teuhidit dhe imanit, ndërsa në anën e kundërt kemi figurën e shëmtuar të kufrit dhe shirkut.

Teuhidi është lidhja me Allahun, kushtuar vetëm Atij, i cili më pas jep fryte të volitshme dhe e formon personalitetin e muslimanit në mënyrë krejt të veçantë, duke qenë i dalluar me virtyte të larta si ndershmëria, turpi, asketizmi, bamirësia, etj. Plotësisht e kundërta ndodh me shirkun, që do të thotë shkëputje nga Allahu dhe lidhja me dikë, apo diçka tjetër, kushdo qoftë ky “tjetri”.

Shirku, kjo pemë e padobishme me fryte të hidhura që karakterizohet nga veprimet e ulëta, nga ndyrësitë dhe poshtërsitë, marrje pa dhënie nuk është asgjë më shumë se hallakatje dhe vërtitje në orbitën e epsheve dhe tekave vetijake, larg nga Allahu dhe nga interesi shoqëror. Tashmë, pas këtij turneu të shpejtë reflektimesh në parimet e platformës kuranore, le të analizojmë këtë pseudo - fetarizëm (shi'it) që ne (shijat) e praktikojmë çdo ditë në mënyrë krejt normale, pa kurrfarë kritike apo qortimi, duke besuar se kjo është feja e *ehlu bejtit*. Të shohim çfarë do të gjejmë...

NË SHËRBIM TË PASURISË DHE SEKSIT

Aq e dobët është lidhja (e shijave) me Allahun (në mënyrë ekstreme), sa që Ai përmendet fare pak, madje, edhe atëherë kur përmendet, kjo bëhet patjetër nëpërmjet ndërmjetësuesve.

SHPESHHERË DO GJESH QË ALLAHU BARAZOHET ME PROFETIN (SALALLAHU ALEJHI UE SELEM!) DHE IMAMËT

Nëse secili prej nesh (shijave) analizon zemrën e tij, do të kuptonte se lidhja dhe mbështetja e tij tek ndërmjetësuesit është më e madhe se sa lidhja dhe mbështetja tek Allahu, kuptohet gjithmonë nëse nuk është lënë fare mënjane Allahu nga ajo çështje. Atij që i drejtohet lutja e që i kërkohet ndihma, zgjidhja, ai i cili është dhuruesi, shëruesi, ai që i largon fatkeqësinë, që largon mërzitë dhe pikëllimet, që i plotëson kërkesat e nevojtarëve, që zgjidh problemet dhe dëgjon lutjet, nuk është Allahu direkt, por duhet të ketë ndërmjetës dhe ndërhyrje, madje ndodh që këta t'u drejtohen këtyre ndërmjetësuesve në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa pasur nevojë t'i kthehen Allahut! Nuk ka argument më bindës se sa vetë momenti, në të cilin robi (prej shijave) gjendet në siklet dhe nevojë, ku gjëja e parë që del nga goja e tij është emri i filan “imami” apo “njeriut të mirë”, por jo Allahu. Në këtë nivel të ulët nuk kishin rënë as idhujtarët e dikurshëm, të cilët më e pakta që bënin ishte: **“Kur hipnin në anije (dhe kishte trazira deti) i luteshin Allahut singërisht (pa i bërë ortakë).” [Ankebutë 65]** dhe: **“E nëse juve u zë ndonjë e keqe në det, i harroni idhujt dhe i luteni vetëm Allahut. E më pas, kur shpëtoni dhe arrini në tokë, shmangeni (nga e vërteta). Vërtet njeriu është mohues i madh.” [Isra 67]** Çështja ka arritur deri aty, sa populli i thjeshtë e mbron “besimin” e tij, duke thënë: “Allahu ka durim të madh që zgjat shumë, vonon në përgjigje, durimi i Tij për diçka është 40 vjet...!!” e që do të thotë: Kur do të marrim përgjigje, ndërkohë që ne jemi në vështirësi dhe gjendja jonë nuk e përballon dot pritjen dhe vonesën, e duke harruar se Allahu është më afër dhe i përgjigjet lutjeve; është më

afër (me përgjigje) se sa damari i qafës së tij: **“Kur ai dëshiron diçka, mjafton t’i thotë “Bëhu!” dhe gjithçka bëhet.” [Jasin 82]**

Kurse “evlijatë” (term që përdoret për të vdekurin që ndodhet në tyrbe) i përgjigjen lutjes në çdo kohë, pa kurrfarë pritje apo vonese (sipas tyre). Një nga rastet e përhapura dhe situatat tipike (tek shijat) është moment i përcjelljes dhe ndarjes, ku thonë: “Allahu, Muhamedi dhe Aliu qofshin me ty!”, megjithëse Kurani që nga fillimi deri në fund, nuk tregon për shoqërimin dhe përkujdesjen e dikujt në çdo kohë dhe çdo gjendje përveç Allahut, pra as Muhamedi, as Aliu, apo ndokush tjetër: “Nuk ka bisedë të fshehtë që zhvillohet mes tre personave, e Allahu të mos jetë i katërti mes tyre (me diturinë, dëgjimin, shikimin, mbikëqyrjen), apo të jenë pesë vetë dhe Ai të mos jetë i gjashti mes tyre, e asnjë vend ku Ai të mos ndodhet kudo dhe kushdo qoftë.” [Muxhadileh 7] Pra, për kë e ka fjalën Allahu ku thotë: “Ai është me ta...” A mos vallë është dikush tjetër veç Allahut?! Ajeti kuranor thotë: **“Shumica e tyre nuk i besojnë Allahut ndryshe veçse duke qenë idhujtarë.”** Vallë, a nuk i përputhet plotësisht kësaj gjendjeje?

KUSH NA RUAN DHE NA MBRON NE?

Kjo pyetje mund të duket e çuditshme, por medito rreth këtyre situatave që unë i kam përjetuar dhe që i përjetoni dhe ju (shiat) me mua çdo ditë:

Një ditë, shkuam në përcjelljen e një xhenazeje në Nexhef dhe ndërsa po hyja brenda varrit të imam Aliut, njëri nga shitësit e ujit që ndodhej aty më ofroi një shishe ujë dhe më tha: “Të ruajttë imami!” I thashë (duke iu drejtuar të gjithëve me zë të lartë): “A nuk jeni muslimanë? A nuk e lexoni fjalën e Allahut në Kuran se **“Allahu është Mbrojtësi dhe Ruajtësi më i mirë dhe Ai është më Mëshiruesi i të gjithë mëshiruesve” [Jusuf 64].** Njëherë mora në

makinën time dikë, i cili kur po hipte thirri: “O Ali!” Pasi zuri vend, nisa t’i shpjegoja se kërkimi i ndihmës dhe dermanit është çështje që i përket vetëm Allahut. Ndërsa *ehlu bejtin* ne e duam, e respektojmë, e marrim për shembull, por kurrsesi nuk duhet t’u lutemi atyre, apo të kërkojmë prej tyre derman. Ai i miratoi të gjitha çfarë thashë, aty për aty, por kur zbriti dhe më shprehu falënderimet e tij kështu: “Të ruajttë Profeti!” Duke qeshur i thashë vetes “nuk arrite asgjë”.

EMRAT E SHUMË PREJ SHIJAVE TREGOJNË ROBËRIM PËR DIKË TJETËR VEÇ ALLAHUT

Edhe emrat tanë tregojnë për lidhjen e dobët mes nesh dhe Allahut, si dhe tregojnë për përkushtimin e mbrapshtë në lidhjen me ndërmjetësuesit. Emrat të tillë si Abdul Husejn, Abduz Zehra, Abdu Ali, Abdur Rida, Abdul Kadhim, Abdus Sadeh (robi i të gjithë klerikëve), Abdul Eimeh (robi i të gjithë imamëve), Abdul Kul (robi i të gjithë njerëzve), Abdul Ihueh (robi i vëllezërve), janë shumë herë më të përhapur se emrat Abdullah dhe Abdu Rrahman, Abdu Rrezak, etj., aq sa pothuajse janë zhdukur këto emra që në të vërtetë janë prej emrave më të dashur tek Allahu. Emrat Abdu Rrahman dhe Abdu Rrezak mund të ndodhë që të shkurtohen dhe të shndërrohen në Rrahman dhe Rrezak, por kurrsesi nuk mund të ndodhë që të shkurtohet Abdul Husejn apo Abdu Rrida, duke e pasur shumë më të lehtë shqiptimin e Abdul Husejn, apo Abdu Ali, se sa shqiptimin e emrit Abdu Rrahman, apo Abdu Rrezak. Aq e rëndë është çështja sa që në renditjen gjenealogjike e gjen këtë emër të shkurtuar, duke lënë vetëm emrin e Zotit. Emri tjetër pas tij, patjetër vjen i robëruar ndaj krijesës, si p.sh: Kerim Abdu Rrida, në vend që të ishte Abul Kerim Abdu Rrida ose Xhelil Abdul Husejn në shkurtim të emrit AbdulXhelil Abdul Husejn. Nga dallimet e habitshme është fakti se

të gjithë emrat e imamëve që përdoren për t'u emërtuar njerëzit paraprihen nga nyja shquese ل (elif-lam) përveç emrit Ali, p.sh. thuhet Abdul Husejn, por nuk thuhet Abdul Ali. Kjo ndodh duke qenë se emri Abdul Alij (në trajtën e shquar) do të thotë 'rob i Allahut' sepse el Alij (më i Larti) është një prej emrave të Allahut, ndaj dhe ata shprehen trajtën e pashquar Abdu Alij, për të nënvizuar kuptimin e emrit 'rob i imam Aliut'!

Një mikut tim i lindi një djalë pas një kohe të gjatë pritjeje, ndaj dhe e emërtoi Abdul Uehab (d.m.th. rob i Dhuruesit) në shenjë falënderimi dhe bereqeti me emrin el Ueh-hab (Dhuruesi), i cili ia dhuroi këtë fëmijë siç ka thënë Ibrahim (SalAllahu alejhi ue selem!): **"Falënderimi i takon Allahut i cili më dhuroi mua Ismailin në pleqëri."** [Ibrahim 39] Kur i vjen për urim një fqinjë, ajo u befasua nga ky emër "i huaj dhe i çuditshëm" dhe e shprehu habinë e saj duke thënë: "A nuk gjetët dot emër tjetër?! Hajdar apo Husejn apo!!

OFERTA DHE ZOTIME

Sa të shumtë që janë këta "imamët" (tyrbet e tyre)! Pse të mos jetë kështu, përderisa mjafton të projektosh një ndërtesë katrore mbi tokë, duke i bërë një kube në mes dhe ta mbulosh me mbulesë të zbukuruar, duke mos harruar kushtin e rëndësishëm që kjo (tyrbe) të ndërtohet pranë pikave të trafikut, stacionit të udhëtarëve dhe rrugëve ku ka lëvizje.

Këta "imamë" (të varrosur), kanë nevojë –i cili është dhe qëllimi kryesor i ndërtimit të tyre- për shërbëtorë që të shërbejnë aty (në ato tyrbe) duke u kujdesur për ta dhe ndërtesat e tyre: "Ata janë ushtarë të bindur ndaj tyre" [Jasin 75]. Përfytyro dhe logjiko! "Imamët" (e vdekur) kanë nevojë për dikë që t'i ruajë, t'u shërbejë dhe jo e kundërta (siç në të vërtetë predikohet nga ata) duke qenë

këto vende plotësisht në shërbim të shërbëtorëve, të cilët përfitojnë pasuri marramendëse, qofshin para, kurbane, zotime të ndryshme, ushqime. Kjo sepse çdo ndërmjetësim “që bëhet” është i bazuar dhe i kushtëzuar me pagimin e parave apo duke ofruar kurbane, zotime sepse nuk mund të pranohet ndërmjetësimi veçse në këtë mënyrë, ashtu siç është e pamundur të arrish tek Allahu përveçse me ndërmjetësim.

Betimi konsiderohet më i rëndësishëm dhe i garantuar, nëse bëhet në prani të “imamit” (tyrbes së tij). Dikush mund të betohet rrejtshëm 100 herë për Allahun dhe nuk pranon të betohet rrejtshëm, qoftë edhe një herë të vetme në emër të “imamit”, aq më tepër nëse ndodhet në tyrben apo varrin e tij. Në këtë shkallë të ulët nuk kishin arritur as idhujtarët e xhahilijetit sepse ata kur donin ta përforconin diçka betoheshin në emër të Allahut, siç tregohet në ajetin Kuranor: **“Ata betohen në emër të Allahut me betime të forta se nëse u vjen një qortues atëherë do të jenë më të udhëzuarit.”** [Fatir 42]

FESTAT E VËRTETA SIPAS SHERIATIT DHE FESTIMET E SHPIKURA, NDËRMJET DHËNIES RËNDËSI DHE SHPËRFILLJES

Vizitat tek varret dhe tyrbet nuk njohin pushim dhe ndërprerje sepse janë shpikur arsye dhe periudha kalendarike të njëpasnjëshme gjatë gjithë vitit, pavarësisht se dyndja është më e theksuar nga një sezon tek tjetri, nga një festë specifike tek tjetra, p.sh: nga muaji Muharrem, deri në fund të muajit Sefer është sezon më vete. Ashuraja (e ku e di ti çfarë është Ashuraja) ditët e Bajrameve, dita e Arafatit, ditëlindja e filanit, ditëlindja e fistekut, dita e përkujtimores së filanit, dita në të cilën u vra fisteku, ky është sezoni Rexhebijeh, ai tjetri është sezoni Shabanije, ky është cikli vjetor (sipas kalendarit Persian) ose që njihet ndryshe si Nevruzi,

nata e të cilit kalohet zgjuar, duke ndezur zjarre, etj. Ndërsa vitin hixhrij Islam e presim me vajtime dhe të veshur me të zeza!! Aq të shumta janë festat e (shijave) sa nuk mund të numërohen, pa llogaritur këtu mbrëmjen e çdo Xhumaje që është festa javore, e cila ndryshe quhet kolektivi sepse mblidhen së bashku gratë dhe burrat të një lagjeje, e që shumica e tyre (në mos të gjithë), nuk njohin gjë tjetër nga feja përveç këtyre rasteve dhe këtyre takimeve që megjithëse janë të shumta dhe të shumëllojshme, me gjithë “rëndësinë” e pretenduar dhe “vlerën” e tyre, në të vërtetë asnjëra nuk gjendet e përmendur (qoftë edhe në një rast të vetëm) në ndonjë ajet kuranor.

Njëherë i thashë një djaloshi me prejardhje nga fisi Meuseuij: “O *sejjid* (zotëri) a e fal namazin e Xhumasë?” Më tha: “Po.” Unë e dija shumë mirë që ai nuk e falte, ndaj e pyeta përsëri: “Ku e fal?” Më tha: “Në Nexhef dhe në Kerbela.” I thashë: “Mashallah, po tek cila xhami?” Tha: “Jo në xhami. Çdo të enjte shkojmë tek “imamët” ku kryejmë faljen dhe vizitën.” Thashë me vete ‘Subhanallah! Mirë, kemi pranuar që ikindia të falet në kohë të drekës, por që xhumaja të kryhet të enjten, nuk e kisha dëgjuar më parë!”

Ajo që bie në sy është se ne e festojmë ditëlindjen e çdo “imami” përveç prijësit të të gjithë imamëve Muhamedit SalAllahu alejhi ue selem ¹⁹ Ne injorojmë të gjitha sebetet madhështore Islame si Israja dhe Miraxhi, hixhreti, betejat e lavdishme të historisë Islame, si p.sh: Bedri ²⁰, ndërsa ditën e Nevruzit që në

¹⁹ As kjo nuk lejohet, por ndoshta autori e përdori thjesht si metodë kundërpërgjigjeje për të treguar shkëputjen e tyre nga Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!). Të mos harrojmë se ata që shpikën mevludin janë shijat fatimitë gjatë shekullit të katërt në Egjipt. Sh.p.

²⁰ As këto nuk lejohet që të konsiderohen festa, përderisa Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!), sahabët, tabijinët nuk i kanë konsideruar të tilla, por njëkohësisht, e lusim Allahu që autori të jetë i justifikuar për këtë gabim në arsyetimin e tij, duke marrë parasysh mjedisin ku ai ka jetuar si dhe faktin që kjo, në njëfarë mënyre, tregon për dëshirën e tij të sinqertë për të madhëruar Islamin dhe simbolet e tij. Sh. p.

realitet është festë pagane e mexhusëve, ne (shijat) e festojmë, madje ndezim edhe zjarret atë natë.

JA ÇFARË NDODH TEK “TYRBET”

Këto vizita shoqërohen me takim ndërmjet dy gjinive, të rinj dhe të reja, madje konsiderohet shans i artë dhe rast i volitshëm për të realizuar takime, apo për të “përmbushur premtime” ose duke arritur “qëllimin”, sidomos në ditët dhe netët e sezonit kur ecet në këmbë, duke fjetur natën, anës rrugës së gjatë!

Prishja dhe degradimi ka arritur në atë nivel që nuk pranon injorim, apo mospranim nga kokëfortësia. Një nivel të llahtarshëm ku nuk bën dobi të bësh shenjë në mënyrë etike me turp, apo të godasësh në mënyrë indirekte, përkundrazi, duhet patjetër ngritje zëri në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke u përballur trimërisht me realitetin ashtu siç është, pa bërë lajka. Hollësitë e lidhjeve të ndaluara që ndodhin aty janë të njohura për çdo njeri të logjikshëm apo jo, por e habitshmja është se të gjithë heshtin, qofshin edhe “dijetarë”: “I dhanë përparësi dashurisë mes tyre në këtë dynja.” Kurse për sa i përket momenteve kur ka dyndje gjatë pelegrinazhit në tavafin rreth varrit apo gjatë fjetjes natën në tyrbe, ka plot për të thënë dhe ka aq shumë sa disa njerëz vijnë në këto rituale vetëm me këtë qëllim të mbrapshtë. Për të mos folur rreth asaj që ndodh në sezonin e vizitës tek Ahmed bin Hashimi, sezon specifik i mbushur me aheng, dëfrim, kërcim, pije alkoolike, etj. Një fakt që të bën për të qeshur është se në hyrjen e çdo tyrbeje shkruhet ***Ndalohej hyrja e grave të zbuluara !!!***

Dicka tjetër për t'u theksuar është fakti se si “shërbëtorët” e këtyre tyrbeve përvetësojnë pasuritë e njerëzve injorantë, duke ua grabitur ato me metoda nga më të ndryshmet dhe me hile nga më të paskrupulltat. P.sh: Pritësi i vizitorëve dhe vizitoreve iu kërkon

atyre të betohen në emër të “imamit” dhe i pyet nëse kanë betime për të përmbushur. Disa (nga ky lloj i shërbëtorëve) i vërsulen grave, duke i kontrolluar në rroba, në gjoks, duke tentuar të zbulojnë gjëra që as ti (si bashkëshort) ndoshta nuk i di. Një tjetër që rri i ulur këndon për shpirt të të vdekurit, ndërkohë që letrat (me emrat dhe paratë) i fluturojnë nga çdo anë, apo ia japin në dorë të bëra shuk apo (pse jo) përfundojnë edhe direkt e në xhepin e tij. Ndërkohë, në distanca të ndryshme, gjenden edhe të tjerë që po bëjnë të njëjtën gjë. Një tjetër, aty pranë mban për dore një dash për ta shitur tek pelegrinët që ta bëjnë kurban. Ata i japin lekët, duke ia besuar atij therjen e kurbanit, ndërkohë që ai të njëjtin dash e shet dhjetëra herë në ditë pa e lëshuar fare nga dora, ndërkohë që dashi i shkretë është po ai, i njëjti, pa lëvizur nga vendi, i burgosur pa afat në burgun e “shërbëtorit kujdestar” i cili çdo injoranti torollak që i jep paratë atij dhe që e merr në dorëzim dashin e kurbanit verbalisht (vetëm me fjalë goje), apo e merr vetëm një moment në dorën e tij dhe ia kthen përsëri “shërbëtorit”, i thotë: U përmbush kurhani yt dhe arriti aty ku duhet. Thashë me vete “Po, arriti, por... tek xhepi i “shërbëtorit!!!”

Një tjetër mban në dorë një enë me të cilën peshkon dinarët, një tjetër të pengon nga dritarja e dhomës së varrit në mënyrë që lekët, të cilat do i hedhësh, të mos bien në dhomë, por... në dorën e tij “në mënyrë që të jetë më e sigurt arritja e këtyre parave tek imami”. Në të vërtetë, paraja që arrin tek varri dhe zë vend mbi të, ka arritur tek imami më shumë se sa paraja që përfundon në dorën e “kujdestarit”, ndryshe nga pretendimi i “kujdestarit” që nuk pranohet nga një logjikë e shëndoshë.

Nganjëherë mund të shohësh ndonjë burrë ose grua kokëfortë që nuk frenohet për të parë tek dritarja sepse nuk bindet derisa të shohë që paratë e tij të jenë tek varri, me gjithë kundërshtimet që has nga “kujdestari” dhe lutjet e tij të përsëritura

duke thënë për t'i mbushur mendjen: “U përmbush zotimi yt, arriti zotimi yt!”

Një tjetër mban në dorë fletushka dhe broshura duke thënë: “Ky libër zgjidh të gjitha problemet, kjo është lutje e veçantë kundër zilisë, lutje e veçantë kundër frikës dhe ankthit, kjo është lutje për riskun, për momentin e takimit me parinë e vendit, pra, me pak fjalë çdo gjë sipas kërkesës!

Një tjetër prej tyre qëndron dhe shet disa copa të vogla pëlhere që ai i quan “perde”, por që në të vërtetë janë forma zhvatjeje. Diku pranë tij qëndron një tjetër që shet copa çimentoje të lyera me ngjyrë të kaltër dhe që ka 7 vrima, të cilën e quajnë ‘shtatë sytë’!

Çudira të llojllojshme! Qëllimi i tyre me këtë copë çimentoje të shpuar është largimi i të këqijave dhe i syrit të keq. Nëse do shkosh në çdo tyrbe apo vend që vizitohet, do të shohësh çudira të kësaj natyre, që veprohen nga kjo kategori (të pacipët), të cilët mjafton të vënë në kokat e tyre kësula të kuqe, çallma jeshile, të bardha ose të zeza, me preokupimin e tyre të vetëm që të gllabërojnë këto “zotime” dhe këto pasuri që shpeshherë e quajnë “mundi i punës”, “haku i lodhjes”, “komision”, etj. Kjo kategori në tërësi, apo pjesa dërrmuese e tyre, janë me mjekra të rruara, me qëllim që ta kenë të lehtë ndryshimin e gunës sa herë që e kërkon nevoja, apo sa herë që situata bëhet kritike.

I vdekuri, nuk mund të varroset pa u shpenzuar shuma të mëdha parash për të, duke filluar që nga larja, qefinosja, talkini, tavafi, namazi i xhenazes, ndërtimi i varrit, leximi për të, ngushëllimi i organizuar në xhami, ardhja e “klerikëve” për t'i kënduar për së dyti. Të gjitha këto, nuk mund të realizohen veçse duke paguar një shumë, apo disa të tilla për çdo rit të përmendur më sipër. Mirëpo ky zakon të fut në një cikël pambarim sepse vijnë të dyzetat, përvjetori, e kushedi se çfarë tjetër... Ndër faktet që të tërheqin vëmendjen është se shumica e këtyre tyrbeve janë

ndërtuar buzë rrugës, madje disa prej tyre ndodhen vetëm disa metra larg rrugës, megjithëse këto rrugë dikur nuk ekzistonin, gjë e cila tregon se këto tyrbe janë varre të sajara, të ndërtuara, me qëllimin e vetëm për t'u pasuruar dhe për të bërë tregëti. Nuk mund të shpjegohet ndryshe shpërndarja dhe pozicionimi i tyre.

A e ke parë, apo ke dëgjuar për tyrben e Xhaferit?! Ndërsa Xhaferi nuk ka qenë kurrë në Irak. Ai jetoi në Hixhaz, nga aty u shpërngul në Etiopi, më pas u kthye në Hixhaz. Pas Hajberit shkoi në Sham ku dhe u ra si shehid në luftën e el Mu'teh.²¹ Po për tyrben e imanit el Bakirit, i cili ka vdekur në Medine dhe është varrosur atje, a ke dëgjuar?! Po për tyrben e profetit Shuajb (Salallahu alejhi ue selem!) që unë nuk e kuptoj se si erdhi nga Medjeni i Shamit për të vdekur në Diuanijeh në Irak?! Akoma më e çuditshme se kaq është profeti Medjen. Vallë, Medjeni është profet, apo siç dihet është fisi, në të cilin ishte dërguar profeti Shuajb?! Por mos u habitni me kaq sepse çuditë vazhdojnë... A e dini se ekziston dhe varri i engjëllit Malik, rojtarit që kujdeset për zjarrin?! Ah, po se për pak harruam, vini re: Këto tyrbe dhe vende pelegrinazhi kanë edhe degët e tyre të shumta nëpër rrethe!!!

Pra, më thuaj, a nuk e ndjen të nevojshme të bërtasësh dhe të kundërshtosh këtë realitet?!

Në të vërtetë, këtë lloj reagimi e shpresoj prej teje dhe prej shumë nga ata janë si ne dhe që ne ua duam të mirën. A nuk të thashë edhe më herët se kemi të bëjmë me një tumor gjigand që ka nevojë për një operacion të madh kirurgjikal?! Këtë operacion unë dua ta kryej para syve të tu, por pa anestezi (ndryshe nga drogimi dhe trulllosja që të kanë bërë deri më sot) sepse kam nevojë që të jesh zgjuar dhe me mendje të kthjellët, ndërsa ata duan që ti gjithmonë të jesh i droguar, të mos kuptosh asgjë, ndaj nuk do të

²¹ Fshat në Jordani, 140 në jug të kryeqytetit Amman.

habitesha nëse ky i sëmure do shqetësohej kur të shihte bisturinë! Mirëpo, unë jam i bindur që britma dhe ulërma nuk është etikë e njerëzve të pjekur, ashtu siç jam i bindur se kirurgu, megjithëse po të pret një prej organeve tashmë të padobishëm, meriton prej teje vetëm dashuri dhe respekt! E them singërish! Vizita e tyrbeve tek ne (shijat) është shndërruar në diçka të ngjashme me Haxhin e idhujtarëve në kohën e xhahiljetit dhe tavafin e tyre të zhveshur rreth Qabes.

Po, ndoshta vërtet nuk do shohësh ndonjë burrë apo grua lakuriq, por lakuriqësia në ato vende është akoma më e rëndë. Nëse në tregimet e xhahiljetit thuhet se Isafa dhe Naileja kanë bërë zina në Qabe, ndaj dhe u dënuan duke u shndërruar në gurë, mos të harrojmë se Isafa dhe Naileja vazhdojnë të ekzistojnë në tyrbet e evlijave dhe vazhdojnë të transformohen, por një lloj transformimi që sytë nuk e shohin, ama e ndjejnë zemrat dhe shpirtrat e pastër.

ÇFARË THONË BURIMET E REFERENCËS DHE LIBRAT BAZË?

Në librat që shërbejnë si burime reference për shijat, kam gjetur transmetime të shumta, aq sa nuk numërohen, të cilat tregojnë për vlerën e vizitës tek tyrbet, duke arritur deri aty sa që e konsiderojnë edhe më të vlefshme se sa Haxhi në Qabe dhe vizita e xhamisë së Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!). Le të lexojmë një transmetim (që si ai ka plot të tillë) në librin *E Kafij* të El Kulejnit. Transmetohet se Ebu Abdullahu ka thënë: “Besimtari kur vjen tek varri i Husejnit në Ditën e Arafatit lahet me ujë të lumit Eufrat dhe më pas i drejtohet atij, për çdo hap që bën Allahu i shkruan shpërblimin e një Haxhi të plotë dhe shpërblimin një beteje.”²² Po

²² Furu'ul Kafij 4/580.

ashtu, vlerësohet më shumë Kerbelaja sesa Qabeja, gjë kjo e mirënjohur tek të gjithë, për shkak të një hadithi të trilluar dhe të shëmtuar, të cilin ia kanë shpifur Ebu Abdullahut sikur e ka thënë ai: “Allahu i ka thënë Qabes: “Sikur të mos ishte për dheun e Kerbelasë, ti nuk do të kishe vlerë! Sikur të mos ishte për tokën e Kerbelasë nuk do të të kisha krijuar! Pra, qëndro aty dhe zër vend që të jesh një bisht i përlur, i nënshtruar, i poshtëruar kundrejt tokës së Kerbelasë sepse përndryshe të mora dhe të hodha në zjarrin e Xhehenemit.”²³

Ky besim i kotë është gjë e pranuar me miratim tek pjesa dërrmuese e fukahave (të shijave) dhe e shprehin atë haptazi, pa kurrfarë ndrojtjeje, apo qortimi nga ndokush prej tyre.

Njëherë, dikush nga ata u pyet: “Pse imam Aliu është më i mirë se Qabja?” Ai u përgjigj: “Në emër të Allahut, më poshtë do të rendis shembujt shpjegues rreth kësaj çështjeje. Ekziston një transmetim që tregon për vlerësimin e Kerbelasë kundrejt Qabes, gjithashtu ne dimë se Aliu është më i mirë se Husejni, siç tregohet edhe në transmetime që do të thonë se varri i Aliut ka më shumë vlerë, se varri i Husejnit, e si rrjedhim automatikisht edhe më i mirë se Qabeja.”²⁴ Këtë çështje do ta shtjellojmë më tej kur të flasim rreth Haxhit. E gjithë kjo bie ndesh në mënyrë të hapur me trashëgiminë e *ehlu bejtit*, të cilët nuk ishin mexhusë, apo zindikë (të dalë nga feja), por muslimanë të udhëzuar.

Eja të meditojmë së bashku mbi çështjen e mëposhtme: Namazi në Xhaminë e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) vlerësohet me 10 mijë namaze.^{25/26} Në çështjen nr. 562 thuhet:

²³ Biharul enuar 101/107.

²⁴ Çështja nr. 9 në *Fletoren e çështjeve fetare* të Muhamed Sadik Sadr 2/5.

²⁵ Minhaxhu es-salihin 1/147.

²⁶ Sh. p. Në të vërtetë namazi në Xhaminë e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) nuk është 10 mijë namaze, por njëmijë, siç transmetohet në hadithin e saktë se

“Preferohet namazi tek tyrbet e “imamëve”, madje thuhet se ato vende janë më të vlefshme se sa xhamitë. ²⁷ Transmetohet se namazi tek varri i Aliut vlerësohet me 200 mijë namaze. ²⁸ Pra, 20-fish më me vlerë se namazi tek Xhamia e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!).

NJË KUNDËRTHËNIE E HABITSHME DHE NJË ABSURDITET I PASHOQ

Allahu e ka cilësuar librin e Tij kështu: **“Allahu ka zbritur fjalën më të mirë, Librin, pjesët e të cilit vërtetojnë njëra - tjetrën” [Zumer 23]**. Nëse ky Libër nuk do të ishte i vërtetë, në të do të gjeje kundërthënie të shumta dhe pjesët e tij nuk do vërtetonin dot njëra - tjetrën.

Allahu thotë: **“Nëse ky Libër do të ishte i shpallur nga dikush tjetër përveç Allahut, atëherë do të gjenit në të kundërthënie të shumta” [Nisa 82]**. Aty ku ka kundërthënie qëndron e pavërteta. Mirëpo, kur lexova burimet që i mveshen *ehlu bejtit* u çudita! Sa herë që gjej ndonjë çështje, menjëherë pranë saj gjej kundërthënien, aq shumë, sa që këto burime janë shndërruar në një mejdan të gjerë, në të cilin ka vend për çdokënd, që nga më i singerti deri tek zindiku, për të marrë çfarë të dojë dhe të lërë çfarë të dojë. Për këtë arsye, imami es Sadik, në kohën kur u shtuan shpifjet dhe trillimet rreth tij, vendosi një kriter përcaktues për të dalluar atë çfarë është e vërtetë, nga ajo çfarë është e kotë, duke thënë: “Ajo që përputhet me Librin e Allahut veprojeni, ndërsa çfarë

Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) ka thënë: “Namazi në xhaminë time është më i mirë se 1 000 namaze në xhamitë e tjera, përveç Qabes.” (Transmeton Buhariu)

²⁷ Minhaxhu es-salihin 1/147.

²⁸ Minhaxhu es-salihin 1/147.

bie ndesh me të, lëreni.”²⁹ Realiteti e kundërshton me forcë këtë parim të artë, sepse zgjedhja që sot bën kleri shi’it në shumë nga këto çështje absurde, sidomos në ato që kanë të bëjnë me bazat e fesë dhe temat e rëndësishme, është alternativa që bie ndesh me Librin e Allahut! Të lexojmë këtë transmetim nga imami el Bakir: “Allahu nuk ka krijuar tokë më të dashur për Të se sa Qabeja, as ndonjë vend më të nderuar se ajo. Qabes i kushtoi katër muaj të shenjtë në Librin e Tij që kur krijoi qiejt dhe tokën.”³⁰ Ky është një shembull tipik i kundërthënieve që tregon se praktika është në kundërshtim me Librin e Allahut dhe për fat të keq, shembuj të tillë ka plot, por që janë harruar mes librave dhe kanë nevojë për dikë që t’i nxjerrë në dritë.

PËR ÇFARË KEMI NEVOJË?

Kemi nevojë të madhe për një numër të konsiderueshëm dijetarësh trima, sypatrembur, të përkrahur nga masa popullore që kanë etje për të vërtetën, në mënyrë që të marrin përsipër spastrimin e këtyre burimeve të referencës, duke i çliruar ato nga transmetimet absurde, të pavlera dhe nga hadithet e trilluara. Kjo gjë mund të arrihet, nuk është e pamundur, nëse ne i përmbahemi Librit të Allahut, duke pasur atë referencën e vetme në çdo çështje,³¹ ashtu siç na porositi imami Es Sadik, i cili që në atë kohë e preku këtë realitet që ne përjetojmë sot; atëherë kur akoma kjo sëmundje nuk kishte pushtuar librat. Nuk është e vështirë të vlerësohen dhe të gjykohen këto transmetime sepse mjafton të shohësh tekstet e tyre dhe siç thotë rregulli: Çdo tekst i tyre që bie ndesh me logjikën

²⁹ Usulul Kafi 1/69.

³⁰ Furu ul Kafi 4/240.

³¹ Sh. p: Kuptohet së bashku me Sunetin profetik.

apo atë çfarë është transmetuar apo përplasat me parimet bazë, atëherë dije se është i gabuar, i pavlerë.

THIRRJE DREJTUAR BREZAVE TË RINJ

Unë po u thërras me të madhe, duke kërkuar që të jeni ambiciozë drejt së vërtetës ashtu që të ktheheni tek Kurani dhe të bëni krahasimin me ato që keni para duarve tuaja: nga librat dhe burimet e referimit. Rezultati i këtij krahasimi të jetë: Çfarë përputhet me Kuranin pohojeni, merreni dhe zbatojeni, ndërsa çfarë bie ndesh me të lëreni, braktiseni. Feja së cilës ju i përmbaheni deri më sot është e përmbysur -në pjesën më të madhe të saj-pikërisht për këtë arsye (mos referimi tek Kurani). Ata, të cilëve ua keni dorëzuar dhe besuar drejtimin tuaj fetar dhe orientimin tuaj shpirtëror, janë mashtrues (një pjesë e mirë e tyre) që po ju marrin në qafë. Ekziston dhe një pjesë tjetër që e dinë të vërtetën, por kanë frikë për veten e tyre, ndaj heshtin! Ekziston edhe një kategori e tretë që janë shumë të pakët, por gjithmonë me tendencë në rritje, të cilët e flasin realitetin, e thonë të vërtetën ashtu siç është, mirëpo thëniet e tyre shkojnë dëm sepse hasin në veshë të shurdhër, humbasin midis një zhurme të madhe propagandistike të mbushur me deformim të realitetit, me fushata bojkotimi dhe paralajmërimi me thirrje devijuese. Në jo pak raste, kjo kategoria e tretë, këta njerëz të pakët e kanë paguar me jetën e tyre çmimin e thënies të së vërtetës.

METODA E SHPËRFYTYRIMIT DHE RRËZIMIT TË PERSONALITETIT

Kjo është nga metodat më të rrezikshme në tentativën e shmangies së njerëzve nga e vërteta dhe deformimin e saj, metodë, e cila (fatkeqësisht) është praktikë standarde, e qëllimshme, e vazhdueshme, tej mase e përhapur, aq sa është shndërruar në thikën e helmuar, e cila përdoret me mjeshtëri nga zotëruesi i saj

për të eliminuar çdo zë kundërshtues, në mënyrë që ky zë të mos arrijë tek masat fatkeqe popullore; tek njerëzit e thjeshtë që jetojnë në mes të një reje të dendur, e cila përbëhet nga pluhuri i dyshimeve dhe tymi i deformimit. Kjo është një lojë e vjetër, po aq e vjetër sa vetë e kota dhe praktikantët e saj, por në të njëjtën kohë është e re sepse përsëritet pa ndërprerje. Në shumë raste, kjo lojë tinëzare (intriguese), e arrin qëllimin e saj për t'i shmangur njerëzit nga njohja e së vërtetës, megjithëse kjo lojë është e pavlerë në peshoren e së vërtetës dhe e parë në këndvështrimin korrekt akademik. Kjo lojë, në të vërtetë, personifikon konceptin e mëposhtëm: Përderisa e vërteta më parashtrohet nga filani, unë nuk e pranoj! Përderisa filani (dikush tjetër) është ai që e thotë këtë gjë (të caktuar), patjetër fjala e tij përmban të vërtetën!

Nëpërmjet kësaj metode, intrigantët arriten t'i shndërrojnë miliona njerëz në kopë të bindur, ashtu sikurse kopeja e bagëtive, të cilët i drejtojnë ku të duan dhe si të duan! E pse jo... përderisa kanë të veshur xhybe, si xhybeja e filanit (të cilit i dëgjohej fjala verbërisht) dhe mbajnë në dorë një shkop si shkopi i tij, na mbetet vetem të dëgjojmë blegërimën e këndshme që ka e gjithë kjo kopë!!!

E VËRTETA NUK VLERËSOHET NË VARËSI TË NJERËZVE, POR NJIHE TË VËRTETËN PARAPRAKISHT QË T'I VLERËSOSH NJERËZIT

Ky është parim akademik i palëkundur, themelet e të cilit i hodhi Aliu³². Pra, sjellja korrekte është që njeriu, fillimisht t'a

³² Sh.p: Në fakt ky parim buron nga ajetet Kuranore dhe hadithet profetike, ku tregohet që njerëzit i nënshtrohen vlerësimit dhe gjykimit sipas parimeve dhe kriterëve të së vërtetës që Allahu shpalli dhe që Profeti komunikoi. Padyshim ky parim u zbatua më së miri nga Profeti SalAllahu alejhi ue selem, e pas tij nga halifët e drejtë, i fundit i të cilëve ishte Aliu, RadijAllahu anhum.

dëgjojë atë që thuhet dhe më pas ta shqyrtojë, për ta vlerësuar nëse ka të drejtë ose jo dhe jo të veprohet në mënyrë të kundërt. A nuk besojmë dhe themi se: E vërteta është synimi i muslimanit dhe ajo çfarë ai kërkon. Kudo që ta gjejë, e merr atë (e pranon, pavarësisht se ku, apo nga kush).

Ajo që ndodh sot (tek shijat) ka një panoramë të tillë: këtë libër mos e lexoni sepse autori është bashkëpunëtor me shërbimet sekrete, atë libër griseni sepse autori bën pjesë në filan organizëm dhe punon për interesat e tyre, këtë hatib braktiseni ³³, atë tjetrin vriteni, këtë konsiderojeni fasik, atë tjetrin kafir, e pse e gjithë kjo? Për arsyen e vetme se solli diçka të ndryshme nga ato që janë mësuar të shohin dhe të besojnë. Në të vërtetë ky është një përçmim i intelektit të njerëzve, dëbim i logjikës, terrorizëm ideologjik, imponim në kundërshtim me fenë dhe një konkurrencë e pandershme që u shkon për shtat vetëm tregtarëve.

Format e metodës së shpërfytyrimit të tjetrit, të rrëzimit të personalitetit dhe të përbaltjes, arrijnë deri aty sa për dikë (megjithëse është nga dijetarët e nderuar) thuhet, filani është me sjellje devijuese, e ka lënë rrugën e drejtë, është imoral, nëna e tij është kështu, e bija e tij është ashtu, etj., si këto!

Për fat të keq ky është realiteti dhe aktualiteti ynë, i cili na e ka shkatërruar jetën. Për një moment, le të supozojmë se ai që po flet është çifut apo amerikan, apo i çfarëdolloj kombësie ose ideologjie. A mos vallë duhet të mjaftohemi me këtë faktor dhe t'a hedhim poshtë fjalën e tij, megjithëse po thotë të vërtetën?! Ku e kanë humbur logjikën e shëndoshë?! Në këtë mënyre avulluan fjalët

³³ Sh.p: Çensurimi i librave, i autorëve, apo kritika dhe largimi nga ata që e meritojnë, të cilët më shumë dëmtojnë se sa përmirësojnë, ky është parim korrekt i themeluar nga selefët, por autori në këtë rast tregon se nëse ky parim keqpërdoret nga pushteti i cili mund të jetë kapur nga të devijuarit, i largon njerëzit nga e vërteta.

e docentit Musa el Meuseuij, nipi i autoritetit të lartë fetar dhe të mirënjohur Ebil Hasen el Asfahanij, e të tjerë si ai, avulluan dhe humbën fjalët e tyre në mes të kësaj zhurme propagandistike ose pothuajse u zhdukën. Le të dëgjojmë se çfarë thotë njëri nga zhurmuesit: “Parashtrimi i nevojave dhe halleve për zgjidhje tek dikush tjetër veç Allahut, shirku që i bëjnë në aspektin e pushtetit, e të tjera si këto vepra që shijat i bëjnë tek varret e “imamëve” dhe “evlijave”, kanë lidhje të drejtpërdrejtë me vështirësitë dhe nevojat, me të cilat njeriu përballet në këtë dynja.” **A mund të ketë vështirësi, hall më të madh dhe problem më të rëndë se sa shirku, se sa përpjekja e njeriut për të arritur nevojat e tij aty ku nuk mund të gjejë zgjidhje dhe as nuk mund të marrë përgjigje?! A ka problem më të rëndë se sa të kërkosh përgjigje dhe t’u lutesh njerëzve, gjë për të cilën ata nuk kanë mundësi të të përgjigjen?!** Ka vetëm një alternativë që lutjet të marrin përgjigjen e duhur, vetëm duke iu drejtuar Allahut, ashtu siç na urdhëron, në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe të drejtpërdrejtë në Kuranin e zbritur tek Profeti i Tij, ku thotë: **“Lutmëni Mua dhe Unë ju përgjigjem!” [Gafir 60]** dhe nuk tha: “Lutjuni dikujt tjetër veç Meje, profet apo imam, në mënyrë që të merrni përgjigje nga ndonjë prej tyre apo nga Unë, (mbaroi citati i tij).”³⁴

Ai gjithashtu thotë: Në librin *Metodat e shijave* të imam El Amilij 2/869 transmetohet:

1. Transmetohet nga Ebu Abdullahi se Aliu ka thënë: “Mos lër pikturë apo skulpturë pa e shkatërruar dhe as varr të ngritur (më shumë se duhet) pa e sheshuar (rrafshuar)”³⁵.

³⁴ Marrë nga libri *O ju shija nëpër botë, zgjohuni!*, fq. 55 me autor docent Musa el Meuseuij.

³⁵ Sh.p: Hadithi është i saktë, e transmeton Muslimi nr 969.

2. Transmetohet nga Ali bin Xhaferi, i cili ka thënë: “E pyeta Ebul Hasen Musain në lidhje me ndërtimin e diçkaje mbi varr, si dhe për qëndrimin tek varri dhe ai m’u përgjigj: “Nuk lejohet ndërtimi i varrit”.
3. Transmetohet nga Ebu Abdullahi i cili tha: “Profeti SalAllahu alejhi ue selem e ka ndaluar që njeriu të falet tek varri, apo të ulet mbi të (mbaron citati i el Meuseuij).³⁶

Ti e sheh që këto transmetime qëndrojnë të mbyllura diku prej shumë kohësh, duke i mbajtur të fshehura nga sytë e popullit, deri në atë pikë sa nëse dikush flet në përputhje me këto transmetime akuzohet me akuzën “më të tmerrshme”, për vehabizëm, megjithëse këto thënie (transmetime) burojnë nga shtëpia profetike dhe kandili i saj. Për këtë arsye, shumë njohës të këtyre transmetimeve i shmangen përmendjes së tyre, e si rrjedhim duke u mënjanuar nga vërteta, duke humbur transmetimet e sakta nga imamët e vërtetë. Nëse dikush pretendon se nuk është kështu, atëherë le të më thotë se cili është qëndrimi ynë në raport me transmetimet e mëposhtme dhe sa larg prej tyre jemi:

1. Nga Ali bin Husejni transmetohet se Profeti SalAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Mos u betoni për dikë tjetër përveç Allahut dhe kush betohet për Allahun le të thotë të vërtetën. Nëse para dikujt bëhet betim për Allahun, le ta pranojë, e nëse nuk e pranon atë, nuk meriton asgjë nga Allahu.”³⁷
2. Nga Muhamed bin Muslimi transmetohet se ka thënë: “I thashë Ebu Xhaferit në lidhje me ajetet Kuranore: **“Pasha natën kur ajo kaplon” [Lejl 1]** dhe: **“Pasha yllin kur ai bie” [Nexhm 1]**, e të tjera si këto ku përfshihen betime, ai

³⁶ Marrë nga fusnotat e librit *O ju shija nëpër botë, zgjohuni!* fq. 56. Sh.p.: Hadithi është i saktë, e transmeton Muslimi nr 972

³⁷ Furu el Kafij te el Kulejnij 7/438.

më tha: “Allahu ka të drejtë të betohet për çfarë të dojë prej krijesave të Tij, ndërsa njerëzit duhet të betohen vetëm për Allahun.” ³⁸

3. Transmetohet nga Semeate, i cili ka thënë: “E pyeta Ebu Abdullahun: “A lejohet që dikush, që ka të bëjë me ndonjë çifut, apo të krishterë t’i kërkojë atij të betohet për idhullin e tij? Ai m’u përgjigj: “Nuk i lejohet askujt që t’i kërkojë ndonjërit të betohet për dikë tjetër përveç Allahut!” ³⁹

Pyetja që shtrohet është: A mos vallë Profeti ynë apo imami Zejnul Abidini apo imami es Sadik janë vehabij? O ju të pa logjikshëm! Kthjellohuni! Prej njerëzve përmirësues, të cilët janë përballur me vështirësi, pengesa, përbaltje, akuza të lloj - llojshme, me qëllimin e vetëm për t’a larguar nga jeta publike dhe për t’i larguar njerëzit prej tij është dhe Ali Sheriatij, nga Irani dhe që jetonte në Iran, jeta e të cilit u mbyll me vrasje si pasojë e një atentati. E gjithë kjo i ndodhi për arsyen e vetme se ai po bënte thirrje të fuqishme për të bërë dallim ndërmjet dy llojeve të shi’izmit: njëri quhet shi’izmi safeuij, ndërsa tjetri shi’izmi alevij. Ali Sheriatij e përshkruan shi’izmin safeuj si një shi’izëm idhujtar, plot injorancë dhe bestytini dhe se kurrsesi nuk mund të konsiderohet rrymë apo orientim fetar, përkundrazi, mundësia më e madhe është që të jetë një deformim i qëllimshëm dashakeq i nxitur nga udhëheqësit safeuij. Më poshtë do paraqesim shembuj nga besimet dhe veprimet e tyre që arrijnë deri në shirk.

Transformimi i konceptit të shefatit (ndërmjetësimi në këtë dynja) në një mënyrë të tmerrshme, sa që të duket që ke të bësh me një kopjim në provim, disa pjesëtarë të klerit ndërhyjnë për të

³⁸ I njëjti burim 7/449

³⁹ I njëjti burim 7/451

favorizuar disa njerëz për të hyrë në Xhenet, megjithëse nuk e meritojnë. Kjo kategori klerikësh përhapin ide të ndryshme në popull, por që thelbi i tyre është se njeriu (sado vepra të këqija të ketë) mund të shpresojë në faljen e mëkateve dhe hyrje në Xhenet nëse ndërmjetësojnë për të “imamët” në tokë (d.m.th këta klerikë), kuptohet diçka e tillë arrihet kundrejt shumave të parave, zotimeve (para ose kurban), të cilat i emërtojnë “rite respekti” për varret dhe tyrbet e lyera me flori. Këto janë ceremoni që ngjasojnë me ritet fetare të adhurimit dhe që kanë për qëllim robërimin e njerëzve, frikësimin e tyre dhe hiperbolizimin e autoritetit të këtyre klerikëve dhe organizatorëve të këtyre organizmave. Në këtë mënyrë, trashëgimia e imamëve dhe varret e tyre shndërrohen në mjet për formimin e një “shtrese të lartë”, mbizotëruese ndaj masës popullore nëpërmjet fesë.

Kjo shtresë përdor të gjithë autoritetin fetar, për të bërë obligim ndaj popullsisë atë që ata e vlerësojnë si hallall apo haram, si dhe për të terrorizuar çdo intelektual, i cili bart një ide, duke arritur që vetëm ata të kenë monopolin e të menduarit dhe ideologjisë. Ndër organizatorët e kësaj që thamë është edhe autori Esh-Sheriatij, i cili konsideron klerikët safeuij se nuk kanë kurrfarë lidhje me shi’izmin aleuij dhe shpreson në të ardhmen se është më se i bindur se Islami i nesërm nuk do të jetë Islami që këta “klerikë” përfaqësojnë dhe se Islami ynë i çliruar nga këta “klerikë” do të rikthehet i shëndoshë dhe i pastër, ashtu siç ka qenë ⁴⁰. Esh-Sheriatij, gjithashtu, përmend disa debate që ka zhvilluar me disa “klerikë” lidhur me zotimet, ndërmjetësimin, vizitën tek tyrbet e “imamëve”, si dhe në lidhje me disa dukuri të tjera, të cilat bëjnë pjesë në kategorinë e shirkut, duke e paraqitur Islamin si një bestytini, apo karikaturë qesharake. Kjo sepse ata njerëz e pranojnë që këto rituale dhe ceremoni janë të

⁴⁰ Kështu foli Sheriatij fq. 63 - 65.

pavlera dhe të shpikura; janë dakord me çdo gjë që u thua, mirëpo më pas thonë: Por? ! ! Kjo “por...” nuk tregon për paaftësi, por shfaq mungesën e dëshirës së tyre për të thyer barrierat penguese, për të demaskuar këto bestytini që as ata vetë nuk i besojnë në të vërtetë, atëherë përse?! Sepse interesi i përbashkët i këtij grupimi si shtresë e lartë mbizotëruese ndaj shoqërisë, u imponon atyre që të vazhdojnë t'i përmbahen këtyre rriteve. Nëse klerikët shndërrohen në shtresë të veçantë, grupim i organizuar dhe i armatosur me mjete të forta ndikimi në masat popullore, atëherë me të vërtetë janë shndërruar në organizëm shtypës që na kthen në prapambetje, duke humbur çdo lloj lidhjeje dhe pike kontakti me parimet e mesazhit qiellor dhe qëllimet e tij, duke pasur si synim të vetëm mbrojtjen e interesave mesquine të kësaj shtrese dhe sundimit të saj. Shumë dijetarë të islamit (shiit) e kanë refuzuar dhe zhvlerësuar, por megjithatë nuk guxojnë të dalin haptazi t'a demaskojnë, ndaj dhe kanë zgjedhur metodën e *et-tekiheh*.⁴¹

JA PRA KËSHTU...

Ja pra, kështu zemra kullon dhe rënkon nga keqardhja në lidhje me këtë parim madhështor, i cili është boshti i gjithë fesë.

Teuhidi, i shndërruar në ikona shirku, në rite të pavlera, të cilat që të gjitha bazohen dhe janë të lidhura ngushtë me pasurinë, imoralitetin, kënaqësitë e dynjasë, larg nga feja e saktë, nga Suneti i Profetit dhe nga trashëgimia e saktë e imamëve të vërtetë.

⁴¹I njëjti burim i mëparshëm f. 63 - 65. Sh.p: *et-Tekijeh* në thelbin e saj nënkupton një lloj hipokrizie, shfaq diçka të ndryshme me atë që beson dhe është mjaft e përhapur tek shijat kur ata bien në kontakt me njerëz të ehli sunetit. Shtiren dhe veprojnë njësoj si ehli suneti, duke i imituar ata, në mënyrë që të fshihen në mesin e tyre. Ndërsa në rastin konkret, për të cilin autori po flet ka për qëllim se këta njerëz të ditur megjithëse e kanë kuptuar të vërtetën dhe i kanë njohur gabimet shtiren për të ruajtur vetet e tyre.

Kapitulli i tretë

NAMAZI SHTYLLA E FESË

Namazi është shtylla më e rëndësishme e fesë pas Teuhidit. “Kush e kryen atë siç duhet ka ngritur në këmbë fenë e tij dhe kush e shemb atë ka shembur gjithë fenë.” “Gjëja e parë për të cilën do të pyetet robi Ditën e Gjykimit është namazi, nëse atë e ka të rregullt, të gjitha veprat do i ketë të tilla, e nëse atë nuk e ka të rregullt, të gjitha veprat e tij ashtu do i ketë.” Tani, le të shohim çfarë ka ndodhur me namazin si pasojë e metodës fshirëse dhe gjymtuese.

KOHËT E NAMAZIT

Namazet janë reduktuar nga pesë në tre dhe si pasojë nuk thërritet ezani pesë herë dhe as nuk kryhen, përveçse në këto tre kohë. Për këtë nuk kam për qëllim të debatoj dhe të argumentoj nëse janë pesë apo tre, por qëllimi im është të theksoj faktin se në aspektin e kryerjes së riteve fetare, gjithnjë anohet drejt reduktimit ndërkohë që e kundërta ndodh me çështjet ku ka interes material, kënaqësi fizike dhe abuzime seksuale, ku tendenca është në shtimin dhe zgjerimin e kësaj fushe. “Argumentimi” me mënyra të paqarta nuk është aspak i vështirë për ata që e kanë në natyrë diçka të tillë, sepse ka qenë dëshira dhe urtësia e Allahut që të ekzistojnë disa tekste jo shumë të qarta (që kanë nevojë për sqarim dhe shtjellim që të kuptohen) si sprovë për njerëzit që kanë në vetvete devijim dhe që janë të predispozuar për t’iu shmangur argumenteve të qarta dhe të prera siç thotë i Lartësuari: **“Ai ka zbritur tek ty (o Muhamed) Librin, ku pjesa më e madhe e ajeteve të tij janë të qarta (të kuptueshme) dhe të cilat janë baza e Librit, por ka dhe disa jo shumë të qarta. Njerëzit që janë të sëmure**

(shpirtërisht) dhe të devijuar pasojnë këto të paqartat duke pasur si synim të shkaktojnë fitne (trazira).” [Ali Imran 7]

ABDESI

Nga rituali i abdesit është zhdukur larja e këmbëve. Me fshirjen e kokës mjafton të fshish hapësirën sa një gisht apo dy dhe nuk lejohet përsëritja e mes’hit më shumë se një herë.

NAMAZI I XHUMASË

Është fshirë dhe zhdukur plotësisht nga ekzistenca që në shekullin e pestë Hixhri. Ndodh nganjëherë që ndonjë fakih nxjerr fetva për të falur të Xhumanë, e praktikojnë vetëm pasuesit e tij, e nëse ndodh që ky fakih vdes apo vritet, atëherë dhe pasuesit e tij i nënshtrohen rikthimit tek fetvaja e një fakihu tjetër, i cili thotë që Xhumaja është thjesht diçka e preferuar apo e zhvlerëson plotësisht, duke mos marrë parasysh që tek të parët e tij, Xhumaja konsiderohej detyrë. Secili pretendon se ka argumentin nga ana e tij dhe se po pason medhhebin xhaferij.

Në këtë mënyrë, urdhri i Allahut është shndërruar në një peng që varet nga firmosja e njeriut, i cili “mund ta lejojë ose jo diçka të tillë të praktikohet”!!! Pra, sipas tyre, Allahu ka nevojë për miratimin e fakihut, ndërsa fakihu nuk ka nevojë për Allahun!!! Nëse fakihu thotë diçka, ajo do të zbatohet, edhe nëse është në kundërshtim me urdhrin e Allahut, ndërsa fjala e Allahut dhe urdhri i Tij, nuk praktikohet pa pasi të marrë miratimin e fakihut. Pikërisht, për këtë sëmundje na e tregon Allahu në lidhje me çifutët dhe të krishterët ku thotë: **“Ata i konsideruan ahbarët dhe ruhbanët zota në vend të Allahut” [Teubeh 31]**, pikërisht kjo e keqe i detyron banorët e Zjarrit që të thonë: **“Do të thonë: Ah sikur**

t'i ishim bindur Allahut dhe të Dërguarit. Do të thonë: O Zoti ynë, ne i jemi bindur parisë udhëheqëse dhe të mëdhenjve nga mesi ynë, por ata na paskan humbur nga rruga e drejtë.”
[Ahzab 66-67]

NAMAZI ME XHEMAT

Kjo dispozitë është e zhdukur ose është neglizhuar në ekstrem përveçse në raste të rralla ose si diçka e preferuar. Ata qëllimisht faljen me Xhemat e kushtëzojnë me kushte të vështira, apo të pamundura, si p.sh: ekzistenca e imamet të fshehur ose zëvendësit të tij, ose të jetë namazliu i përsosur në çdo aspekt dhe i pastër nga çdo e metë. Edhe nëse ndodh që namazi të falet me Xhemat, kjo kryhet në mënyrë të çrregullt dhe jo korrekte në radhitjen e safeve.

NAMAZI I BAJRAMEVE

Edhe ky namaz është i zhdukur, apo ekstremisht i shpërfillur, duke u zëvendësuar me vizita tek varret, tek të cilat njerëzit vërsulen që në mesnatë dhe në turma të mëdha, duke bërë garë me pritjen e agimit apo lindjen e diellit sepse përndryshe i vdekuri që po vizitojnë nuk do arrijë t'i shohë!!!

Në këtë mënyrë, ata e zhvlerësuan një nga simbolet më madhore të fesë. Ndërsa “Bajrami” për kujdestarin e varrit është festë e shumëfishtë dhe arsyeja është lehtësisht e kuptueshme për çdokënd që i ka dy sytë në ballë, apo qoftë dhe njërin. E shoh të panevojshme të flas më tepër, në mënyrë specifike në lidhje me çfarë ndodh gjatë këtyre vizitave ndërmjet dy gjinive!!! Sepse gjuha stepet, pështyma thahet dhe është e sikletshme. Medito edhe ti me mua se si kjo gjë i kushtohet padrejtësisht imamet Es-Sadik: Nga

Ebu Abdullahu transmetohet të ketë thënë: “Çdo besimtar që në ditë të zakonshme vjen tek varri i Husejnit, duke qenë i bindur për vlerën e tij, do i shkruhen 20 Haxhe dhe 20 Umre, të plota, të pranuar, si dhe 20 Haxhe dhe Umre në prani të një profeti të dërguar, apo të një imami të drejtë. Për sa i përket atyre që e vizitojnë atë ditën e Bajramit, i shkruhen njëqind Haxhe, njëqind Umre dhe njëqind beteja të kryera me një profet të dërguar, apo imam të drejtë.⁴² Përderisa është kështu, çfarë nevojë kemi për namazin e Bajramit?!

NAMAZI I TERAVIVE

Është eliminuar plotësisht, në xhami apo në shtëpi përveç natës së 23-të e cila mendohet se i korrespondon natës së Kadrit, ndërsa netët e tjera të Ramazanit shfrytëzohen për të lexuar vargje vajtuese rreth vrasjes së Husejnit.

NAMAZET NAFILE

Në praktikë nuk ekzistojnë, megjithëse teorikisht janë të shkruara. Kjo për arsyen e thjeshtë se reduktimi i namazeve nga pesë në tre, ka ndikuar tek shumica e popullit që ta kenë të vështirë kryerjen e nafileve.

LEXIMI I KURANIT NË NAMAZ

Përveç Fatihasë lexohen vetëm suret e shkurtra si Ihlassi, Kadri, Nasri etj, megjithëse Allahu thotë:

“Lexoni sa t’u vijë më e mundshme nga Kurani.” [Muzemil 20] I gjithë “ky lexim” i shkurtër është inekzistent në dy rekatet e fundit, duke qenë i zëvendësuar me disa thënie tesbihi.

⁴² Furu el Kafij 4/580.

NAMAZI I XHENAZES

Nuk është asgjë më shumë se sa një mënyrë për të tubuar pasuri. Namaz i braktisur nga përkushtimi në të, nuk i kushtohet rëndësi ose maksimumi që arrihet është t'i jepet rëndësi shtimit të numrit të atyre që i falin xhenazen, megjithëse shumica prej tyre nuk dinë as si t'a falin, duke u shndërruar ky namaz si të ishte një sekret që nuk e di kush tjetër përveç kujdestarit të varrit, ndaj dhe është e panevojshme që njerëzit t'a mësojnë këtë namaz dhe për të mos 'lodhur kokën' me të. Kjo është arsyeja që ky namaz nuk kryhet nëpër xhamira, por nëpër tyrbe (varre).

KOMPENSIMI I NAMAZIT ME PASURI

Nëse dikush vdes dhe nuk ka qenë falës i namazeve, nuk është aspak problem sepse ekziston mundësia e zhvillimit të një llogaritjeje të shpejtë rreth ditëve dhe viteve që ka lënë namazin, ditë dhe vite që sjellin bereqet për "klerikët" dhe i jepet zotëriut klerik shpagimi në të holla, me shpresën se ky i fundit do i kryejë këto namaze në vend të të vdekurit!!!

Këtij "zotëriu klerik" nëse do i vinin në ditë dhjetë njerëz të ndryshëm që t'i kërkonin të falej për të vdekurit e tyre, ai do pranonte pa kurrfarë hezitimi. Dikush dhe mund të thotë: "Po ty çfarë të shqetëson për këtë? Lëri njerëzit të sigurojnë riskun e tyre!"

Pra, me pak fjalë, kjo është vlera e namazit tek ata, vlera e simbolit më madhor fetar në mënyrë absolute (pas shehadeit), atëherë çfarë mund të themi për të tjerat?!

EL HUSEJNIJAT

Me këtë term njihen vendet e posaçme ku organizohen ngushëllimet dhe vajtimet për të vdekurit dhe që në disa kohë të

veçanta shoqërohen me goditje të vetvetes në shenjë pikëllimi. Këto organizime shoqërohen me të ngrëna, të pira, duhanpirje, etj., duke mos treguar kurrfarë respekti dhe konsideratë për faktin që e gjithë kjo bëhet në emër të Husejnit. Këto vende të përgatitura me karrige dhe kolltukë janë shndërruar në vendpushime ku kalohet koha, shkëmbehen biseda, ushqehen, pijnë, thithin duhan, aq sa në disa prej tyre kur hyn në fillim të lë përshtypjen se je në një kafene.

XHAMITË

Në përgjithësi, nuk falet e Xhumaja në to dhe as me xhemat (secili falet veçmas), ndërsa ezani thërritet vetëm 3 herë në ditë. Në këtë mënyrë xhamitë janë shndërruar në struktura që janë zhveshur nga përçimi i mesazhit, për të cilin janë ngritur dhe nga qëllimi, për të cilin Allahu ka urdhëruar të ndërtohen. Po të bësh një krahasim mes xhamive dhe shfrenimit në ndërtimin e tyrbeve, teqeve, vendeve që vizitohen, nuk gjen asnjë vend apo bllok banimi, qoftë dhe një fshat i vogël të shkëputur që të mos e ketë një të tillë. E gjithë kjo sepse këto objekte “kulti” sjellin përfitime të mëdha materiale. Ndërsa xhamitë, pothuajse po zhduken nga jeta e atyre të gJORëve, të cilët e njohin fenë vetëm nëpërmjet ritualit të vizitave që kryhen në këto tyrbe dhe ndërtesa, të cilat janë ngritur për të rivalizuar shtëpitë e Allahut (xhamitë). Këta njerëz janë të përkushtuar ndaj këtyre tyrbeve, duke i zbukuruar, duke i ngritur, duke i zgjeruar dhe duke i shumëfishuar, aq sa numri i madh i tyre nuk krahasohet me atë të xhamive, e në fakt, Allahu ka urdhëruar për xhamitë në Kuran dhe Sunet. Kjo që përshkrova është fenomen i dukshëm dhe konkret, dhe nuk ka njeri që mund t'a mohojë. I braktisëm xhamitë dhe gjallëruam tyrbet. Një fakt që të tërheq vëmendjen është se kur i afroresh një qyteti, cilido qoftë ai, gjëja e parë që do të vësh do të jenë minaret e tyrbeve dhe kubetë

(kupolat) e saj, e jo minaret e xhamive. Këto varre, sado me pozitë të jetë njeriu brenda tyre, kurrësi nuk mund të krahasohen me madhështinë e shtëpisë së Allahut.

Nuk mund të jetë flamuri i ushtarit më i dukshëm sesa flamuri i emirit të tij! Allahut i takon shembulli më i lartë!

DHIKRI DHE LEXIMI I KUR'ANIT

Diçka tjetër që bie në sy lehtësisht është interesi tepër i dobët i shfaqur kundrejt Kuranit. Nuk lexohet në namaz, memorizimi i tij nuk ekziston, deri aty saqë nuk gjen një dijetar (shi'it) apo fakih, e aq më pak njerëzit e thjeshtë që ta dinjë Kuranin përmendësh. Kjo është një çështje që kërkon meditim dhe reflektim serioz. Kurani nuk studiohet në Husejnijate, apo në qendrat e diturisë, nuk i ofrohet (i jepet) dikujt për ta mësuar, as të vegjëlve dhe as të mëdhenjve. Askush nuk interesohet të njohë rregullat e leximit të tij. Në Husejnijate kurrë nuk është njohur diçka që quhet *Kurs për mësimin e Kuranit*. Ka vetëm një mënyrë të shfrytëzimit të Kuranit: leximi i tij kundrejt pagesës, leximi për të vdekurit, leximi tek varret etj., kundrejt një shume të caktuar. Dihet shumë mirë fjala e Allahut drejtuar ehli Kitabit ku thotë: **“Mos i shkëmbeni ajetet e Mia me përfitime materiale që janë gjë e pavlerë (kundrejt fjalës së Allahut)!”** [Bekareh 41], gjithashtu na lajmëron se profetët e Tij u thoshin popujve të tyre: **“Unë nuk ju kërkoj shpërblim asgjë.”**[Shuara 109]

Njëherë shkova në përcjelljen e një xhenazeje në Kerbela. Arrita me vonesë aty dhe shoh një person buzë varrit, duke lexuar suren Jasin, atëherë unë i thashë: “A nuk e mediton mbi fjalën e Allahut në këtë sure: **“Pasoni ata që nuk ju kërkojnë shpërblim dhe që janë të udhëzuar...”** [Jasin 21] deri tek fjala e Tij: **“...ky është përkujtim dhe Kuran i qartë, me të cilin t'ua tërheqësh**

vërejtjen atyre që janë të gjallë.” [Jasin 69-70], ndërsa ti çfarë po bën? U tërheq vërejtjen të vdekurve dhe u kërkon shpërblim të gjallëve?! Nuk denjoi të përgjigjej me një gjest më shumë se sa një shikim me cep të syrit dhe një vetull të ngritur, e më pas u ngrit dhe u largua për të vazhduar ritualin me të tjerë të gjerë, kuptohet, pasi kishte marrë nga të gjerët e varfër të pranishëm të hollat e kërkuara. Një shoku im më tregon historinë e tij: Shkova për të vizituar një të afërmin tim ditën e Xhuma dhe shoh një burrë buzë varrit, duke i kënduar një të vdekuri suren Xhuma që akoma nuk ishte varrosur. Më erdhi për të qeshur dhe i thashë me ironi: “Namazi i Xhumasë nuk është obligim për të vdekurit!!! Më pas ky shoku im thotë: “Me sa duket, ky lexues paska mbaruar punë me thirrjen e të gjallëve dhe paska ardhur që të ftojë në Islam edhe të vdekurit. Qenka i veçantë në llojin e tij meqë po bën diçka që të parët nuk e kanë bërë: E drejton thirrjen e tij tek të gjallët dhe të vdekurit njëkohësisht! I thashë: “Vërtet, ashtu është gjendja e atij injoranti sepse Allahu thotë: **“Nëse i thërret të vdekurit, ata nuk ta dëgjojnë thirrjen, por edhe sikur ta dëgjonin nuk janë në gjendje që t’u përgjigjen”** [Fatir 14] dhe: **“Nëse Allahu do dinte që ka hajr në ta do i bënte të dëgjojnë. Por edhe nëse do të dëgjonin do zmbropseshin duke kthyer shpinën”** [Enfal 23]. E çuditshmja në këtë pikë është se ata (të gjallët) nuk e falin namazin e Xhumasë, madje me vendim “fetar”.

Ata i larguan njerëzit nga Kurani dhe meditimi i tij me arsye të kota dhe shpifje të ndryshme, p.sh. thonë: “Është i vështirë për t’u kuptuar, nëse e lexon, lexoje thjesht për bereqet.” Këta e harrojnë fjalën e Allahut në lidhje me Kuranin: **“Ky (Kuran) Libër që është zbritur tek ty, është libër i begatë. E zbritëm ashtu që të meditojnë në ajetet e tij dhe që të përkujtohen të logjikshmit”** [Sad 29]. Pra në këtë ajet tregohen të dy aspektet e përfitimit: bereqeti dhe meditimi. Ndër metodat për shmangien e

njerëzve nga Kurani është edhe pretendimi i tyre se Kurani është i mangët apo i ndryshuar, apo që Kurani i vërtetë ndodhet tek Mehdiu⁴³. El Kulejni transmeton nga Ebu Abdullahu, i cili ka thënë: “Kurani që Xhibrili ka sjellë tek Muhamedi ka pasur 17 000 ajete ⁴⁴. O Vëllai im! A e kupton se çfarë nënkupton ai me këtë thënie?! Ai do të thotë se ky Kuran që ne kemi sot ka vetëm 6 mijë e 600 e 60 ajete,⁴⁵ pra ku shkuan 11.000 ajetet e tjera?! Një transmetim (i tyre) tregon se shkakun e fshehjes së kësaj pjese është: Aliu u zemërua me sahabët që nuk e pranuan këtë pjesë nga Kurani, ndaj dhe ai e fshehu, duke ia dorëzuar vetëm fëmijëve të tij, të cilët e trashëgonin dorë pas dore, brez pas brezi, derisa arriti tek Mehdiu (i shijave) ⁴⁶ dhe që do të publikohet vetëm pasi ai të shfaqet. Nga shembujt që ata japin për të ilustruar ndryshimin e Kuranit është transmetimi që gjendet në librin El Kafij nga Ebu Abdullahu, ku thuhet se një person lexoi në prani të tij fjalën e Allahut: **“Thuaj: Veproni sepse veprat tua do shihen (do vlerësohen) nga Allahu, Profeti dhe besimtarët.”** [Teubeh 105] Ai (Ebu Abdullahu) tha: Ajeti nuk është kështu, në vend të fjalës: “besimtarët” duhet: “garantuesit” (*memnun*) dhe ne jemi garantuesit.⁴⁷

Shembull tjetër: Fjala e Allahut: **“Ditën kur vajza e groposur për së gjalli, do pyetet se për çfarë mëkati është vrarë”?** [Tekuir 9] ata thonë: Ajeti duhet të ishte kështu: Ditën kur dashuria që duhet të kemi për ehlu bejtin do të pyetet: për çfarë mëkati u vranë ata?

⁴³ Sh.p. Koncepti i shijave për Mehdiun është i ndryshëm nga besimi i ehlu sunetit për Mehdiun e vërtetë që do jetë prijësi i muslimanëve në ndodhitë para Kijametit në kohën e zbritjes së Isait.

⁴⁴ *Usulul Kafij* 2/634.

⁴⁵ Sh.p. Në të vërtetë janë 6 236.

⁴⁶ Marrë nga libri i Selim bin Kajsit fq. 361, transmetimi nr. 42.

⁴⁷ *Usul Kafij* 1/424, *Biharul enuar* kapitulli 20.

Kjo shpifje, padrejtësisht i atribuohet imamit es-Sadik⁴⁸. Me këto lloj shpifjesh është dobësuar besueshmëria e Kuranit tek njerëzit (shijat), qofshin dijetarë apo njerëz të thjeshtë, duke u shmangur prej tij, duke mos e memorizuar apo medituar dhe në të njëjtën kohë i gjen të përkushtuar pas librave me dua, pas broshurave të vizitave të varreve, për të cilat ata besojnë se të shërojnë nga sëmundjet, shmangin syrin e keq, hasedin (zilinë), largojnë të këqijat dhe të mbrojnë nga fatkeqësitë. Në të vërtetë, këto libra dhe broshura janë shndërruar në një mjet jo pak të rëndësishëm për të përfituar paratë e të gjorëve injorantë. Kujdestari i jetimit, nëse është njeri dashakeq që lakmon pasurinë e këtij jetimi, atëherë padyshim që nuk dëshiron që jetimi të arrijë moshën madhore (të pjekurisë) sepse e kupton (kujdestari) që do ta humbasë atë pasuri, me të cilën ka vepruar sipas tekave të tij. Po ashtu, ky umet e arrin pjekurinë e tij nëpërmjet kuptimit dhe meditimit të Kuranit, e arrin atëherë kur e konsideron atë si bosht referimi, ndaj dhe shumë nga këta “klerikë” lakmitarë, apo nga ata me qëllime të largëta dhe prapaskena të errëta, punuan shumë për të shmangur masat popullore nga Libri i tyre, Kurani i shenjtë, në mënyrë që të mbeten gjithmonë në periudhën e foshnjërisë ideologjike, duke ëndërruar çdo natë për kthimin e babait “të munguar” që prej shumë kohësh!

MËSIMET KËSHILLUESE

Pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për në xhami apo jashtë saj, në mexhliet e ngushëllimit etj., të gjitha bazohen në vajtime dhe goditje të vetvetes, fillim dhe mbarim. “Lexuesi” në këto mexhliet nuk lexon dot për hir të Allahut, pa kurrfarë interesi dhe

⁴⁸ *Usulul Kafij* 1/295, *Biharul enuar* kapitulli 44.

përfitimi material. Kjo ndodh edhe në Ramazan. I ofrohen ushqimet më të shijshme dhe pijet më të veçanta, kuptohet përveç “shpërblimit për mundin e leximit”, aq sa edhe fetvatë kanë çmim, pa përmendur aktet e martesës, apo divorcit.

Kapitulli i katërt

AGJËRIMI DHE HAXHI

AGJËRIMI I RAMAZANIT

Nënvlerësimi i agjëritimit dhe lojërat me të, janë diçka tepër e habitshme! E kanë nënshtruar Ramazanin ndaj synimeve politike dhe qëllimeve jo fetare, duke harruar se agjërimi ka të bëjë me Zotin e Madhërishëm, duke mos e ndjerë peshën e përgjegjësisë që kanë kundrejt miliona muslimanëve, të cilët ditën e parë të muajit nuk e agjërojnë dhe e shtyjnë më pas duke bërë gabimin tjetër: agjërojnë një, apo dy ditë nga ditët e Bajramit. Hëna, tek ata (shijat) nuk shfaqet nga perëndimi (siç është rregulli dhe fenomeni i mirënjohur), por presin shfaqjen e saj nga lindja. Këta “lindorë” (Allahu i udhëzoftë!) e kanë të qëllimshëm këtë veprim, duke dashur të jenë të ndryshëm nga të gjithë muslimanët e botës dhe aq më tepër që kjo ndodh çdo vit. **Ata nuk e fillojnë agjërimin atëherë kur e fillojnë muslimanët dhe as nuk e bëjnë Bajramin në të njëjtën kohë, me qëllimin e vetëm për të distancuar dhe shkëputur masat popullore Shi'ite nga pjesa tjetër e vëllezërve të tyre; shkëputje totale: si në besim, rituale, dispozita, simbole, vende adhurimi etj.**

Sa e sa herë ka ndodhur që kemi parë muslimanët të agjërojnë, hëna bëhet qartësisht e dukshme aq sa e shohin edhe njerëzit me shikim të dobët, ndërsa ata (shijat) sillen si të ishin të verbër që nuk shikojnë. Nuk agjërojnë (në të njëjtën kohë) dhe e kompensojnë më vonë! Me kalimin e viteve, me akumulimin e shqetësimit dhe dyshimit, masat e gjera kanë formuar një natyrë të mufatur, mbushur plot me dyshime dhe skepticizëm ndaj çdo gjëje. Kjo gjë i ka shtyrë ata që ta fillojnë agjërimin disa ditë para Ramazanit, në mënyrë që të jenë të sigurt se nuk do humbasin asgjë

prej tij. Kjo sjellje u shndërrua në zakon dhe madje mori një emërtim specifik: parapritje. Ky veprim është argument që tregon se ata të gjorë, thellë në brendësinë e shpirtit të tyre nuk janë të bindur dhe nuk i besojnë më askujt, në lidhje me përcaktimin e kohës, megjithëse e mbrojnë përcaktimin zyrtar me fanatizëm sektar, nga inati kundrejt palës tjetër. Kjo ishte një zgjidhje e mesme (që vetë populli e mendoj) kundrejt mosbindjes, mes pajtimit dhe besueshmërisë tek ata, por që sidoqoftë, ngelet hendeku ndërmjet besimit dhe veprës, ndërmjet teorisë dhe praktikës. Kjo gjë formoi tek ata një personalitet të ndërlikuar, të atillë që e sheh qartë të vërtetën, por megjithatë e mohon megjithëse argumenti është i qartë, lehtësisht i kuptueshëm dhe i drejtpërdrejtë.

Çfarë argumenti mund të jetë më i qartë dhe më i drejtpërdrejtë se sa hëna që shihet me sy të lirë?!

Njëherë, një i afërmi im më tregon se ai kishte dalë në treg në ditën e dytë ose të tretë të Fitër Bajramit dhe kishte ndaluar tek dyqani i një shokut të tij. Ishte koha afër akshamit. Vazhdoi tregimin: “E gjej shokun tim agjërueshëm dhe i them: “A nuk e sheh se ka dalë hëna (e muajit Sheual)?! Shiko!” - i thashë duke i bërë me shenjë në drejtim të hënës, e cila në ato çaste dukej qartë në qiell si shpatë e lakuar. Shoku im refuzoi në mënyrë kategorike të shihte nga drejtimi që unë i tregova, me gjithë përsëritjen e kërkesës dhe këmbënguljen time. Më pas nuk e kuptova pse e mbylli dyqanin, duke u drejtuar me shpejtësi nga shtëpia! Kjo fatkeqësi përsëritet çdo vit, pra kemi nënvlerësimin e kësaj shtylle madhore fetare dhe të dy simboleve, po ashtu madhështore: Fillimi i muajit të Ramazanit dhe respektimi i festës së Bajramit (që nuk lejohet të agjërohet).

JUSTIFIKIME TË KOTA, TË DEMASKUARA

“Dijetarët” janë treguar tepër tolerantë në lidhje me justifikimet dhe arsyet që e bëjnë të lejuar mos agjërimin, deri në atë pikë sa e

konsiderojnë detyrë mosagjërimin (iftarin) në udhëtim, sado i shkurtër që të jetë ai. Në gjithë këtë, ata përdorin justifikime të ftohta që në vetvete përbëjnë edhe humor. P.sh: Nxënësit apo studentët, në kohë provimesh, shkojnë dhe pyesin për fetva në lidhje me këtë çështje dhe u jepet kjo fetva: “Kryej çdo ditë një udhëtim fare të shkurtër, në një zonë aty afër dhe do merret në konsideratë distanca në vajtje dhe në ardhje.” Shembull tjetër: “Bëhet detyrë iftari (mosagjërimi) nëse kalon lumin, nga njëra anë në tjetrën, sado e shkurtër që të jetë distanca.” Shembull tjetër: “Bëhet detyrë iftari (mosagjërimi) për atë person që e zë agimi i mëngjesit xhunub dhe nuk ka arritur të lahet.”

Fatkeqësia e gjithë këtyre shembujve është se askush nuk e përmend apo thekson detyrimin e kryerjes së këtyre ditëve kaza, më vonë.

MARRËDHËNIET INTIME DHE NGACMIMET KANË KAPITULLIN E TYRE NË RAMAZAN

Në fetvatë e muajit të Ramazanit ka vend edhe për çështje të tilla, p.sh: lexo fetvanë e mëposhtme: “Nuk priset agjërimi nëse burri i zhveshur ngacmohet me bashkëshorten dhe “pa dashje” kryen raport seksual!!! Nëse këtë veprim e bën qëllimisht, por nuk është i sigurt, a u krye plotësisht akti seksual, atëherë agjërimi i tij priset, por nuk e ka detyrë shpagimin!”⁴⁹

Çfarë ndjen duke lexuar këtë lloj fetvaje?! A i ka ngelur vallë, sadopak shenjtëri dhe atmosferë fetare muajit të agjërimit?!

Lexo këtë fetvanë tjetër: “Nga gjërat që e prishin agjërimin është dhe kryerja e aktit seksual që shkakton xhunubllëkun. Ndërsa nëse diçka e tillë ndodh jo qëllimisht, “padashje”, kjo nuk e prish agjërimin.”⁵⁰

⁴⁹ *Minhaxhu es-salihin* 1/263.

⁵⁰ *El Mesailul muntehabe* nr. 498.

Fatkeqësia e kësaj fetvaje nuk qëndron vetëm në faktin se e edukon lexuesin që ta konsiderojë diçka normale të merresh me këto lloj ngacmimesh (lojërash dashurore) gjatë agjërimit, që ndonjëherë përfundojnë edhe në akt të plotë. Problemi më i madh qëndron në mënyrën e shpërfilljes së mëkatit, duke e fokusuar çështjen thjesht tek prishja e agjërimit, apo nëse ndodh ose jo raporti intim. Ndërkohë nuk e konsideron aspak si prishje të agjërimit homoseksualitetin, por shton: “Më e mira, thjesht për siguri, të agjërojë përsëri atë ditë.” dhe argumentimi është akoma më i çuditshëm sepse homoseksualiteti (“i cili nuk ndalohej”) nuk shkakton domosdoshmërisht xhunubllëk!!! Më poshtë shton, duke vazhduar argumentimin, se akti seksual jo gjithmonë shkakton xhunubllëk!!! Në daç beso e në daç jo!

EL MULAJATU DHE “EL MULAJIN”

Ramazani është sezoni, në të cilin shtohen *el mulajatu* (vajtueset me pagesë) për shkak të vajtimit dhe goditjeve gjatë vajtimit që ndryshe quhet dhe *el Kirajeh*. Gjithashtu, shtohen *el mulajin* (vajtuesit me pagesë), të cilët lexojnë poezitë rreth vrasjes së Husejnit, shtiren sikur qajnë dhe vajtojnë me dënësë. Mos pyet se cila është lidhja logjike ndërmjet Ramazanit dhe këtyre ritualeve sepse këtë nuk e di njeri tjetër “përveç atyre më të thelluarve në dituri”. Nuk janë asgjë më shumë se sa mjete fantastike për të rrjepur pasurinë e popullit dhe për të pasur rehati materiale. Pse të jetë ndryshe, a nuk është Ramazani muaji “i mirësive dhe bereqetit”?!

U zhvlerësua Kurani në muajin e Kuranit dhe u largua kjo pengesë nga rruga e tyre, duke u zëvendësuar me vajtime, lot të rremë, duke u shndërruar Ramazani në fushatë për tubimin e pasurisë dhe një mundësi më shumë për përzierje mes dy gjinive dhe shthurje!

VALLË, KËTË TRASHËGIMI NA KA LËNË EHLU BEJTI?!

Jo, pasha Allahun, kurrresi! Përkundrazi, ata e njihnin të vërtetën dhe e komunikuan atë, por jemi ne që po kundërshtojmë dhe nuk bindemi. Nga Ebu Abdullahu transmetohet se në lidhje me fjalën e Allahut: **“Dhe mos të të kundërshtojnë në të mira” [Mumtehana 12]** ka thënë: “E mira e përmendur në ajet është të mos shqyejnë rrobat, apo të godasin fytyrat (në shenjë vajtimi), të mos vajtojnë me mjerim (p.sh: Ah mjerë për mua!), të mos vizitojnë varret, të mos vishen me të zeza, të mos i lëshojnë flokët (në shenjë zie dhe trishtimi).⁵¹

Nga Ebu Xhaferi transmetohet se ai ka thënë: “A e dini shpjegimin e fjalës së Allahut: “Dhe mos të të kundërshtojnë ty në të mira”? Profeti SalAllahu alejhi ue selem i tha Fatimesë: “Kur të vdes unë, mos e gërvishit fytyrën për mua, mos i lësho flokët për mua (në shenjë pikëllimi), mos vajto me mjerim (p.sh: Ah mjerë për mua!) mos lejo njeri të më vajtojë, më pas tha: “Kjo është e mira, për të cilën foli Allahu.”⁵² Në një transmetim tjetër të Ebu Abdullahut nga Profeti SalAllahu alejhi ue selem gjejmë: “Mos godisni faqet, mos çirrni fytyrat, mos shkulni flokët, mos shqyeni rrobat, mos vishni rroba të zeza dhe mos u lutni me mjerim (p.sh: Ah mjerë për mua!).⁵³

HAXHI PËR NË SHTËPINË E ALLAHUT

Nëse ndonjë njeri i logjikshëm do të lexojë ato transmetime dhe fetva që unë kam lexuar në lidhje me Haxhin, fetva të cilat janë shpikur dhe vendosur posaçërisht për t’ia ulur vlerat dhe

⁵¹ *Furu el Kafij* 5/527.

⁵² I njëjti burim i mëparshëm.

⁵³ I njëjti burim i mëparshëm.

nëpërkëmbur atë, atëherë jam i bindur se lexuesi do tronditej dhe do i vërtitej bota dhe mendja vërdallë. Fatkeqësisht, të gjitha këto i atribuohen “imamëve” dhe rrugës së tyre. Edhe sot e kësaj dite vazhdojmë të lexojmë, apo dëgjojmë fetva të tilla që thonë: “Varri i Husejnit, apo i Aliut është më i vlefshëm se sa Qabeja!!! Për ta argumentuar dhe mbështetur këtë vlerësim, filozofojnë, shtrembërojnë, “interpretojnë” dhe krahasojnë, si p.sh. thonë: Xhamia profetike është më e vlefshme se Mesxhidul Harami (Qabeja)?! Pse? Sepse Profeti është i varrosur në të ndërsa në Qabe nuk është i varrosur njeri. Kjo do të thotë se meqë Husejni është djali i vajzës së Profetit atëherë dhe varri i tij është më i vlefshëm se Qabeja. Gjithashtu, duke qenë se Aliu është më me vlerë se Husejni, atëherë edhe varri i tij është më i vlefshëm se varri i Husejnit dhe, për rrjedhojë, është më i vlefshëm se sa Qabeja! Allahu e mallkoftë Iblisin sepse ai është i pari që përdori këtë mënyrë krahasimi, kur tha: **“Unë jam më i mirë se ai (Ademi), sepse mua më ke krijuar nga zjarri ndërsa atë e ke krijuar nga balta” [Araf 12]**, pra e la mënjane urdhrin e qartë: **“Bini në sexhde për Ademin” [Bekareh 34]** për t’u bazuar në logjikën dhe krahasimin e tij. Si mund ta pranojmë një arsyetim të tillë nga ata, kur vetë ata na thonë që nuk lejohet krahasimi (analogjia, kijasi) në çështjet e fik’hut, ndërsa vetë e përdorën analogjinë në çështjet e besimit?! Arrijnë deri aty, sa e konsiderojnë xhaminë e Kufes (atë të rrënuarën) më të vlefshme se sa Qaben, madje dhe rezidencën në krah të saj (xhamisë së Kufes) që sot është si një muze i zbrazur! Po! Është më e vlefshme dhe më e madhërishme në zemrat e atyre trilluesve, për arsyen e thjeshtë se Qabeja nuk ka kurrfarë vlere në zemrat e tyre. A e dini shkakun e armiqësisë dhe urrejtjes së tyre ndaj Qabes fisnike të madhërishme, që Allahu e ka vlerësuar dhe madhëruar? Besoj se tani (për shijat) ka ardhur koha që mendjet e tyre të çlirohen nga prangat dhe të meditojnë, duke e përdorur logjikën në atë funksion, për të cilin

është krijuar. Këto besime të trilluara, nuk kanë të bëjnë aspak me fenë e Allahut dhe nuk mund të jenë në përputhje me menhexhin e *ehlu bejtit*. Padyshim, këto bestytни janë sajese e duarve të fshehta, të cilat kishin si qëllim që varret e imamëve t'i shndërronin në rivalizuese të Qabes, në mënyrë që t'i shmangin zemrat e njerëzve nga Qabeja tek ato kulte dhe varre. Vini re, se si ata në të njëjtën kohë që zhvlerësuan Haxhin, madhëruan vlerën e vizitës tek tyrbet, madhërim ekstrem, aq sa njerëzit e shkretë filluan ta kryenin "Haxhin" atje. Tek këto tyrbe njerëzit thonë "telbijen"⁵⁴, atje luten, qajnë, bëjnë sakrifica, kërkojnë ndihmë dhe shpëtim, aty lëvizin, vrapojnë, rreth tyre bëjnë tavaf, fërkohen në muret dhe gurët e tyre, i puthin pragjet e portave, ofrojnë kurbane që i therin aty, përmbushin zotime, pra gjithçka sikur të jenë në Qabe. Nëse dikush dëshiron të vërtetojë (verifikojë) fjalën time, le të shkojë në Kerbela në Ditën e Arafatit... pjesa dërrmuese e popullit tonë, sot besojnë se vlefshmëria e Haxhit është e kushtëzuar nga vizita tek "imamët sepse përndryshe Haxhi do të konsiderohej i pasaktë dhe i pavlerë, ndërsa e anasjellta nuk qëndron!" Po ashtu, moskryerja e Haxhit mund të shtyhet dhe kompesohet, duke paguar një shumë parash tek ndonjë dexhall aty, duke mos pasur nevojë të shkosh deri tek shtëpia e lashtë e dalluar nga Zoti i botërave!

Përsa i përket asaj çfarë ndodh tek vizita e tyrbeve nga përzierja e burrave me gratë dhe shthurjes, që arrijn deri në kryerjen e aktit imoral (duke marrë parasysh "shenjtërinë" e vendit), ekzistojnë plot tregime dhe transmetime që janë të mirënjohura për të gjithë, ndaj nuk ia vlen t'i përmendim këtu.

⁵⁴ Sh.p. *Telbija* është thënia e teuhidit që haxhiu e përsërit shpesh "Lebbejke Allahumme, Lebbejke (Të përgjigjemi ty, o Allah, të përgjigjemi!)." Duhet të theksohet se "telbija" që shijat bëjnë është e ndryshme me telbijen e mësipërme të muslimanëve monoteistë, ata thonë "Lebbejke ja Husejn (Të përgjigjemi ty, o Husejn!)."

Pyetja që shtrohet është: A është kjo feja e *ehlu bejtit*?! Çfarë familje mund të jetë ajo që ka këtë lloj feje?! Lidhja e këtyre njerëzve me varret dhe të vdekurit është diçka e habitshme dhe tronditëse, gjë të cilës nuk i ndahen dot edhe kur janë në Qabe! Njerëzit po shohin anomali dhe veprime qesharake, të cilat na kanë mbuluar me turp si p.sh: goditje të fytyrës, vajtimi për Husejnin etj., pikërisht në kohën kur haxhinjtë në Arafat po përjetojnë çastin më kulminant të lidhjes mes tokës dhe qiellit. Madje edhe në Arafat, në atë vend dhe në atë ditë të shënuar ka pasueses të rremë të *ehlu bejtit* që vajtojnë dhe goditen! Më thoni çfarë duhet të mendojnë njerëzit për *ehlu bejtin*, nëse i besojnë propagandës dashakeqe që kjo është rruga e *ehlu bejtit*?! Një njeri i besueshëm më ka treguar: “Po bëja tavaf në Qabe, kur papritmas shoh një burrë (që në dukje ishte Iranian) i cili thërriti shokët e grupit të tij dhe u tha: “Ejani të vizitojmë Husejnin!” Rreth tij u mbledhën një grup nga kopeja e humbur, u drejtuan me fytyrë nga Kerbelaja dhe filluan të thërrisnin në mënyrë të përsëritur: “Es-selamu alejke, o biri i vajzës së Profetit!” Pas kësaj, filluan të shanin të pranishmit që ndodheshin në Qabe! Në fund, i njëjti person e mbylli turpin e tij duke thënë: “U realizua vizita e Husejnit, e cila është më e vlefshme tek Allahu se 70 Haxhe!”

Shoku im që po më tregonte historinë tha: “U trondita dhe u zemërova nga ajo që pashë, aq sa vendosa t’i kundërpërgjigjem, ta ofendoj, ta mallkoj, ta bëj të heshtë me çfarëdolloj mënyre, në mënyrë që të mos shihen këto turpe demaskuese, mirëpo kisha frikë se mos kjo bënte pjesë në debatin e ndaluar në Haxh, ndaj dhe hoqa dorë nga ideja ime dhe vazhdova rrugën.

BURIMET E BELASË (REFERENCËS)

Transmeton el Kulejnij nga Ebu Xhaferi se një ditë prej ditësh, ai i pa njerëzit që po bënin tavaf rreth Qabes dhe iu tha: “Ja,

kështu bënin Haxhin në xhahilijet, ndërsa në një transmetim tjetër: Po bëni veprime si veprimet e xhahilijetit! ⁵⁵ Transmetohet nga Ebu Abdullahi se ai një ditë po qortonte një person që kishte vajtur tek ai pa vizituar më parë varrin e Aliut dhe i tha: “Sa keq që ke vepruar! Nëse nuk do ishe i palës tonë (shija) nuk do të të shihja me sy. Pse nuk e vizitove atë që e viziton Allahu bashkë me engjëjt, profetët dhe besimtarët? ⁵⁶ Subhanallah! A mund të thuhet për tavafin rreth Qabes: Veprime si ato të xhahilijetit, apo që varrin e Aliut e viziton Allahu! A mund të besohet, apo të pranohet logjikisht që këto fjalë kufri të burojnë nga kandili profetik?!

⁵⁵ *Usulul Kafij* 1/392

⁵⁶ *Furu el Kafij* 4/580

Kapitulli i pestë

ZEKATI, NJË E PESTA DHE RREGULLAT E TJERA NË LIDHJE ME PASURINË

ZEKATI

Allahu e ka vlerësuar shumë çështjen e Zekatit dhe e ka bërë që të jetë shtylla e tretë madhore e Islamit, prej pesë shtyllave mbi të cilat bazohet feja. Zekati përmendet në shumë ajete dhe hadithe, duke u treguar vlera e tij dhe urdhëri për dhënien e tij. Ndërsa tek ne (shijat) ndodh e kundërta: është diçka e lënë në harresë, nuk praktikohet dhe as nuk përmendet, përveçse rrallë dhe si rrjedhojë, masat e popullit të thjeshtë nuk njohin asgjë nga dispozitat e tij më elementare dhe lehtësisht të kuptueshme, po pse?!

Pas një meditimi të gjatë rreth shkakut të kësaj gjendjeje, e kuptova se kleçka qëndron tek një e pesta (*el khumus*).⁵⁷

Zekati është e drejta, nga e cila përfitojnë të gjithë të varfërit, ndërsa *el khumus* (një e pesta) i përket në mënyra të veçanta një shtrese specifike, të cilët janë “zotërinjtë klerikë” dhe “fukahatë”. Ky është dallimi i parë, ndërsa dallimi i dytë është se vlera e zekatit është fare e papërfillshme në krahasim me vlerën e *el khumusit*, ndërkohë që obligimi i njerëzve me të dyja njëkohësisht është i vështirë, ndaj duhet të zgjedhim ndërmjet këtyre të dyjave. Padyshim, ai që u zgjodh për të qëndruar është *el khumusi* (një e

⁵⁷ Duhet theksuar se një e pesta e pasurisë që shijat propagandojnë është tërësisht e ndryshme nga dispozita fetare e një të pestës nga plaçka e luftës, ndaj tregohu i vëmendshëm.

pesta), sepse në vlerë është shumë më e madhe dhe për një shtresë të caktuar, ndaj e lanë pas dore Zekatin, e injoruan dhe e harruan qëllimisht, ama nëse dikush e jep atë, nuk përbën problem dhe nuk qortohet.

Në këtë mënyrë e mbyllën ose pothuajse ia arritën të mbyllnin, një nga portat e mëdha të bamirësisë në dobi të shoqërisë dhe ndërkohë çelën një portë tjetër në vend të saj që është në funksion të përfitimit sa më të madh, në aspektin e interesave dhe kënaqësive personale. Në fillim të librit unë e përmblodha idenë e fesë së shpikur në një thënie përgjithësuese: **Një fe, e cila në aspektin e adhurimit dhe bamirësisë, bazohet në ngushtimin e këtyre sferave, ndërsa në aspektin e pasurisë dhe përjetimit epshor bazohet në zgjerimin maksimal të kësaj fushe dhe tolerimin e shfrenuar.**

Në kohët e mëhershme, kur nuk ishin klerikët ata që e merrnin *el khumus*, siç ndodh sot, dhe që akoma nuk ishte ekzagjeruar kaq shumë siç është sot, ai thjesht përmendej si temë, por nuk i kushtohej rëndësi me këmbëngulje pagesës së tij dhe as nuk ishin përzier fukahatë në mbledhjen e kësaj “takse”. Në atë kohë thuhej kështu: *El Khumus* është e drejtë e veçantë për “imamin e shumëpritur” që është i fshehur. Dhënësi i kësaj “takse” nuk është i detyruar për diçka të tillë, por nëse dëshiron që ta japë, atëherë atë pasuri e gropos në tokë ose ia dorëzon në mirëbesim një njeriu të besueshëm që t’i ruhet ajo pasuri, deri në kohën e shfaqjes së Mehdiut (shi’it, imamit të fshehur). E gjithë kjo ndodhte, para se të përzihej feja me tregtinë dhe hilet e saj dhe para se fukahatë ta përdornin atë për blerjen e shtëpive, martesat, etj., gjëra që nuk ndodhnin në kohën e fukahave të mëdhenj, si El Murteda, El Mufid dhe Et Tusij ⁵⁸. Pra, në atë kohë nuk kishte burim tjetër përveç Zekatit, ndaj dhe dijetarët flisnin shumë dhe ashpër në lidhje me të, p.sh: lexo këtë transmetim si shembull ilustrues dhe dëshmi për

⁵⁸ *En-Nihajeh fi muxherad el-fikh* fq. 200, të *et-Tusij*

rregullin e mësipërm. Nga Ebu Abdullahu transmetohet se ka thënë: “Çdo vepër që njeriu ka bërë në kohën kur ishte i humbur dhe nasibij (urries i *ehlul bejtit*) dhe më pas udhëzohet dhe pendohet, do shpërblehet për të mirat e tij të mëparshme, përveç Zekatit, të cilin e ka detyrë ta përsërisë.”⁵⁹ Sa më shumë që zgjerohet porta e *el khumusit* (madje shqyhet kjo portë dhe shkulet fare nga vendi) aq më shumë ngushtohet hapësira e Zekatit dhe zhvlerësohet, duke e shndërruar në diçka të pa nevojshme.

ÇFARË ËSHTË EL KHUMUSI (NJË E PESTA)?

Koncepti i *el khumusit* (një e pesta) që kanë zgjedhur dijetarët (shi’itë), në të vërtetë është një shpikje (bidat) e pabazë. Ata morën vetëm emrin, por vetëm emrin ama, nga një ajet Kuranor dhe u lidhën pas tij, në mënyrë që të mashtrojnë popullin naiv me justifikimin se pasuritë që po ua marrin njerëzve janë nën përkufizimin e një dispozite të përmendur në Kuran. D.m.th. e huazuan termin dhe i dhanë vetë ata një koncept dhe përmbajtje tjetër, i cili është tërësisht i ndryshëm nga dispozita fetare që Allahu ka për qëllim me fjalën e Tij në ajetin kuranor: **“Dijeni se çdo gjë që ju e arrini si plaçkë lufte, një e pesta është për Allahun, të Dërguarin, të afërmit, jetimët, të varfrit dhe udhëtarët që mbeten në rrugë. Kjo, nëse i besoni Allahut dhe asaj që i ka zbritur robët tonë në Ditën e Furkanit, në atë ditë kur u përballën dy palët (dy ushtritë). Vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë!”** [Enfal 41]

Dita e Furkanit është dita e betejës së Bedrit, në të cilën u përball ushtria Islame me ushtrinë e kafirave. Një e pesta e përmendur në këtë ajet është një e pesta e plaçkës së luftës, d.m.th. e pasurive të ndryshme që u merren armiqve kafira të përfshirë në luftë. Në lidhje me këtë imami es-Sadik ka thënë: “Një e pesta është

⁵⁹ *El Istibsar* 2/145, et-Tusij

dispozitë e veçantë vetëm për plaçkën e luftës ⁶⁰. Ndërsa pasuritë e kafirave që janë në paqe me muslimanët, nuk lejohet kurrsesi marrja e tyre. Këtu lind pyetja: “Çfarë mëkati paskan bërë muslimanët (shi’it) kundrejt atyre që po u grabisin në mënyrë të vazhdueshme një të pestën e pasurisë, e që kjo taksë të përfshijë edhe këpucët, edhe çdo gjë që vishet?! Depot e gllabëruesve të një të pestës janë mbushur plot me flori dhe pasuri të marrë padrejtësisht, të cilat më pas ata i ndanë mes tyre, duke mos arritur asgjë tek të varfrit, vejushat, të ngratët dhe nevojtarët e kategorive të tjera, madje përkundrazi, “taksa e zullumit” i përfshin dhe këta të fundit. Pra, është përmbysur dispozita, të varfrit paguajnë tek të pasurit, ndërsa këta bëjnë qejf. Me këto pasuri, këta banditë po ndërtojnë institucione financiare madhështore në Londër dhe vende të tjera, ndërsa populli naiv dhe i shkujdesur mendon se ato shpenzohen për kategoritë në nevojë. A mund të pranohet logjikisht ky realitet i hidhur shi’it, ku sipas teorisë së tyre një e pesta e pasurive të umetit Islam (i cili e kapërcen një miliard dhe me pasuri të mëdha) të shkojnë për një pakicë njerëzish, për një shtresë të caktuar si “zotërinjtë klerikë” dhe “fukahatë” që nuk janë më shumë se disa qindra vetë, por edhe nëse do ishin disa mijëra, disa qindra mijëra, apo edhe një milion.

Profeti SalAllahu alejhi ue selem ishte njeriu më i distancuar nga kjo dynja dhe bukuritë e saj, nga pasuritë, thesaret dhe pallatet e saj. Allahu i thotë atij: **“Thuaj: Unë nuk u kërkoj asgjë nga pasuritë tuaja si shpërblim, sepse shpërblimi im është tek Allahu dhe Ai është dëshmuar për çdo gjë” [Sebe 47]** dhe: **“A mos ndoshta po u kërkon nga pasuria e tyre, sepse begatitë e Allahut janë më të vlefshme dhe Ai është furnizuesi më i mirë.”**

⁶⁰ El Istibsar 2/56

[Muminun 72] dhe: “Ne të kemi dhënë ty shtatëshen që përsëritet **[Fatihanë]** dhe Kuranin famëlartë. Mos lakmo llojet e pasurisë që ne u kemi dhënë atyre.” **[Hixhr 87-88]** Pra, Allahu zgjodhi që Profetit të Tij t’i jepte Fatihanë dhe Kuranin famëlartë dhe jo kënaqësitë afatshkurtra të kësaj dynjaje, ndërsa ata të cilët sot pretendojnë se janë zëvendësit e tij në umet jetojnë në rehati dhe kënaqësi, si rezultat i grabitjes së pasurive në emër të *el khumusit*. Profeti SalAllahu alejhi ue selem nuk ka dërguar kurrë dikë tek ndonjë fis, familje apo treg që t’u marrë atyre një të pestën e pasurive dhe një veprim i tillë nga Aliu RadijAllahu anhu nuk është raportuar asnjëherë në histori. Me këtë që thashë nuk isha në pozicionin e kundërpërgjigjes ndaj këtij bidati zullumqar dhe zhvlerësimit të tij (sepse kjo kërkon më shumë kohë dhe më shumë trajtim), por qëllimi im kryesor ishte t’i bëja thirrje mendjeve të hapura dhe të çliruara nga terrori ideologjik që nëpërmjet vështirimit kritik në realitetin devijues që po jetojmë, të shquajnë hendekun e madh, humnerën gjigande që ekziston ndërmjet fesë false që ata praktikojnë dhe fesë së vërtetë, me të cilën erdhi Profeti dhe që e ndoqën dhe zbatuan *ehlu bejti*. Një nga format e devijimit që të bën të qeshësh dhe të qash në të njëjtën kohë është fakti se gllabëruesit në emër të fesë së tyre, kur e kuptuan se sa i vështirë është vënia në zbatim i rregullave të *el khumusit*, vendosën ta zbusin paksa çështjen, sipas filozofisë: Nëse do që njerëzit të të binden, atëherë urdhëroi aq sa mund të bëjnë. P. sh: Dikush duhet të japë një të pestën që arrin vlerën një milion dinarë dhe kur vjen “kleriku” për ta marrë, personi thotë: “Tani nuk kam më shumë se 50 mijë.” Kleriku i përgjigjet: “S’ka problem, jep atë që ke.” dhe ia thekson herë pas here: “Ke dhënë pesëdhjetë...”, pastaj ia kthen, ia merr përsëri dhe i thotë: “U bënë njëqind.” Kjo ecejake vazhdon ndërmjet tyre, derisa arrihet shuma e duhur dhe atëherë kleriku i thotë: “Arriti, u përmbush!”

Nganjëherë ndodh edhe kështu: “Zotëriu klerik” ⁶¹ tregohet bujar me të ngratin që qëndron para tij i përulur dhe i jep sadaka nga pasuria që sapo ia mori atij. Atëherë, i ngrati e merr atë sadaka, duke shprehur njëqind falënderime dhe lutje për shëndet dhe jetë të gjatë!!! Ku janë mendjet e njerëzve?! Ku është logjika?!

A E DI?

A e di se ajeti ku flitet për një të pestën ka zbritur për të sqaruar ndarjen e plaçkës së luftës në betejën e Bedrit? A e di se fakihu, apo kleriku nuk bën pjesë në kategoritë e përmendura në ajet? A e di se përfshirja e tyre si kategori e merituar është trillim i bazuar në kijas (analogji) me “imamin” dhe se kijasi në medhhebin xhaferij nuk merit për bazë në dispozitat e fikhut? A e di se “zotëriu klerik” nuk e jep një të pestën e pasurisë së tij, madje as Zekatin, po ashtu dhe fakihu? Po ashtu, a je në dijeni se Zekati në Sheriat është obligim vetëm ndaj të pasurve dhe e kushtëzuar me arritjen e kuotës së caktuar? Si p.sh: paratë vlerësohen për Zekat, nëse arrijnë vlerën monetare të gramaturës së caktuar të floririt, ndërsa *el khumusi* i përfshin të gjithë, të pasurit dhe të varfrit? A e di se Zekati është obligim në disa lloje të veçanta të pasurisë dhe jo në çdo gjë që njeriu ka në pronësi, p.sh: shtëpia, makina, mjetet e punës, veshjet, frutat dhe perimet, etj., nuk kanë zekat, ndërsa një e pesta (shi’ite) përfshin absolutisht të gjitha pasuritë dhe gjendjen ekonomike?

HABI DHE ÇUDIRA

El khumus është detyrë në çdo tepricë mbi nevojat e jetesës së një viti, fitime nga puna, nga bujqësia, tregtia, zejtaria, fitimet e qirave. Një e pesta është detyrë për dhurata, shpërblime, çmime të

⁶¹ ‘Zotëriu’ quhet kleriku, i cili e ka prejardhjen nga familja e Profetit, por ta dini se sa e lehtë është sot të blesh me para një dëshmi që demonstron një pemë gjenealogjike që lidhet me familjen profetike.

fituara në konkurse, amanetet e lëna për dikë. Një e pesta është detyrë në çdo tepricë në shtëpi si: orizi, mielli, gruri, elbi, sheqeri, çaji, nafta, drutë, qymyri, vaji, ëmbëlsirat, etj., nga plaçkat e shtëpisë, të vogla qofshin apo të mëdha. Po ashtu një e pesta është detyrë edhe për librat, rrobat, tapetet, enët dhe pijet, të tepërta, apo që nuk përdoren. Ka disa kategori pasurish, prej të cilave dhënia e një të pestës është detyrë dy herë si p.sh., pasuria e vjedhur apo kamata, njëherë është detyrë që të kthehet në pasuri hallall dhe njëherë si obligim fetar⁶². Si mund ta pranojë muslimani që këto çmendurira të jenë prej Sheriatit të Allahut?! Si mund të bëhet hallall vjedhja dhe kamata?!

A e di se një e pesta, dikur në kohën e dijetarëve të mëdhenj (shi'it) të medhhebit si shejh el Mufid apo et-Tusij, nuk i jepej fukahave? A e di se diçka e tillë ka ndodhur shumë vonë me fetva të disa dijetarëve të mëvonshëm të pa bazuar në asnjë argument, apo fjalë të “imamëve”, e jo më të kenë mbështetje në Kuran dhe Sunet?

A e di se fetvatë e atyre dijetarëve të hershëm si el Mufid, et-Tusij, el Murteda dhe disa shekuj me radhë, kanë qenë kontradiktore: dikush e shfuqizonte obligueshmërinë e dhënies së tij, për arsye të tilla, si “imami i shumëpritur” nuk është i pranishëm dhe kjo taksë është e drejtë vetëm e tij dhe sepse ekzistojnë thënie të drejtëpërdrejta nga “imamët” që përmbajnë shfuqizimin. Disa fetva të tjera obligojnë groposjen e një të pestës në tokë, derisa të shfaqet “imami i fshehur”.

Disa thonë duhet ta lërë me amanet (testament) tek dikush i besueshëm, në prag të vdekjes. Tek ky mendim anon shejhu el Mufid. Ndërsa et-Tusij ka zgjedhur mendimin e ndarjes në dy pjesë: Gjysma u jepet atyre që e meritojnë dhe gjysma groposet në tokë ose lihet me testament.⁶³

⁶² Këto fetva i gjen në shumë libra, p.sh: libri i *El khumusit* me autor Muhamed Sadik Sadr dhe *Minhaxhu es-salihin* me autor el Hauji

⁶³ Shih librin *En-Nihajeh* fq. 200, të et-Tusij dhe *El Mukniah* fq. 64, të el-Mufid.

Nëse bën krahasimin mes këtyre fetvave dhe asaj që shkruhet në kohët e vona, do të shohësh çudira dhe kontradikta në mendime dhe që padrejtësisht që të gjitha në fund i atribuohen imamit Xhafer es-Sadik.

NJË E TRETA E PASURISË SË TË VDEKURIT

Nga gjërat e habitshme është pretendimi se për atë ndodhet në prag të vdekjes preferohet që të lërë me testament një të tretën e pasurisë së tij për udhëheqësin shpirtëror, për klerikun referues.

A e keni dëgjuar këtë ndonjëherë më parë këtë gjë?! Pse pikërisht kjo përqindje, një e treta? Allahu ealem! Por çfarë do të mbetet për trashëgimtarët?! Një të tretën e pasurisë duhet ta lërë me testament, një e treta shpenzohet për larje, varrosje, ndërtimin e varrit, shpenzimet e ditëve të ngushëllimit, një vjetorin, marrjen me qira të dikujt për t'i falur kaza namazet që ai ka lënë pa falur. Më pas, nga pjesa e mbetur merret një e pesta! Në daç beso, e në daç jo!

SADAKATË, “PAGESA KUNDREJT MUNDIT” DHE LLOJE TË TJERA TË ARDHURASH, PAMBARIM!

Zhvatësit që marrin pasuritë e njerëzve në emër të *ehlu bejtit*, i kanë lejuar vetvetes diçka të tillë, nën emërtime të ndryshme dhe të shumta, të kamufluara me petkun fetar, por edhe të shpikura. E rëndësishme është që pasuritë e ndryshme të arrijnë në duart e tyre, pa marrë parasysh lejimin apo ndalimin fetar, duke ecur sipas proverbit: “E lejuar është çdo gjë që arrin ta shtiesh në dorë, ndërsa e ndaluar është ajo çfarë nuk e arrin dot!” Ah, sikur t'i shihje dot në kohën e sezoneve për të mbledhur pasuritë dhe fushatës fermë më fermë dhe shtëpi më shtëpi, duke u marrë nga prodhimet bujqësore, kafshët, drithërat, të hollat dhe çdo gjë tjetër

që syri sheh dhe lakmon. As balli nuk djersin, as fytyra nuk skuqet, as syri nuk ia bën tërr, as gjuha nuk belbëzon, për të kërkuar këto pasuri, madje e sheh këtë kategori të thotë pa asnjë ndjenjë turpi ose mirësjelljeje, me plot bindje në vetvete dhe qartësi: “Kërkoj shpërblimin për mundin tim!” Vini re se sa të zellshëm që janë, por për çfarë? Analizoni angazhimin e tyre, me çfarë ka të bëjë? Atyre nuk u intereson aspak çfarë ndodh rreth tyre në shoqëri, e cila po përjeton një largim të frikshëm nga feja, një degradim të rëndë moral ku sjellja normale është e bojkotuar, besimi i vërtetë është përçmuar, namazi është i braktisur ose i sakatuar. Mirëbesimi ka humbur, ndërsa për veprat e ndaluara ka shumë për të folur, si p.sh: zinaja, vrasja, vjedhja, grabitja, kamata, mashtrimi, magjia, përgojimi, thashethemet, mosrespektimi i prindërve, sjellja e keqe me fqinjët. Pa përmendur më të përhapurat: gënjeshtrenë dhe hipokrizinë, fjalorin e pistë, shthurjen e grave, korrupsionin, injorimin, etj. Gjithashtu, vini re vështirësitë me të cilat njerëzit po përballen çdo ditë, si p. sh: varfëria apo ndonjë nevojë specifike, për shkak të së cilave njerëzit janë në konflikt me njëri - tjetrin, prishin lidhjet fafërisore, ka degraduar niveli moral, duke shitur edhe nderin. Të gjithë këto fatkeqësi ndodhin, ndërkohë që ata thjesht shohin çfarë po u ndodh vëllezërve dhe bashkatdhetarëve të tyre, bashkëkombësve, banorëve të të njëjtit vend, pasuesve të të njëjtit medhheb, duke mos ndjerë keqardhje, duke mos u përlotur, duke mos u skuqur aspak dhe duke mos menduar ndonjëri prej tyre që të bartë mbi vete një pjesë sado të vogël të këtij obligimi madhor, të kësaj përgjegjësie fisnike, të cilën Allahu ia ka ngarkuar njeriut të ditur: “T’u mësojë njerëzve çështjet fetare, elementare dhe themelore të jetës së tyre si p.sh: Mësimi i ajeteve Kuranore, apo urdhërimi për të mira, dhënia e sadakasë apo reflektimi i ndonjë virtyti moral ose ndonjë mirësie të harruar, ndonjë obligimi të lënë pas dore ose sunet të braktisur, ndonjë fisnikërie të nëpërkëmbur

ose lidhje familjare të shkëputur, ndonjë të drejte të mohuar ose dituri të dhënë, fe të ndryshuar ose një mënyrë jetese të pa orientuar, ku shumica jetojnë si kafshët ose akoma më të humbur se kafshët. Të përjashtuar nga ky vlerësim janë një pakicë të vogël njerëzish, të cilët vërejnë ç’po ndodh, por që janë të detyruar të heshtin apo të qortojnë me zë të ulët. Ne jemi duke folur për shumicën, për pretenduesit e rremë, të cilët angazhimin e tyre të vetëm kanë tubimin e pasurisë, përjetimin e kënaqësive dhe përfitimin e “pagesave për mundin” që shpenzojnë në shërbim të popullit. Çfarë paradoksi! Vallë, si janë përmbysur çështjet dhe janë deformuar kriteret e vlerësimit?! Profeti SalAllahu alejhi ue selem , tek i cili ata pretendojnë se e kanë prejardhjen dhe çirren për ta pohuar këtë fakt (me të cilin krenohen pa masë) i përmbushte të drejtat e njerëzve, si në çështjet fetare, ashtu edhe në ato të dynjasë, duke dhënë maksimumin e tij në këtë aspekt nëpërmjet kontributit vetijak dhe pasurisë së tij, duke mos e zgjatur dorën e tij fisnike tek pasuritë e tyre, qoftë edhe për një dërmim të vetëm, si shpërblim kundrejt mundit, luftës, thirrjes, bamirësisë, apo çdo gjë tjetër që ai ofronte. Kurrë nuk pretendoi se kishte “të drejtën” t’u trashëgonte nipërve të tij një pjesë të pasurive të popullit. Ai nuk mblidhte “të drejtat” (shpërblimet për mundin) dhe as merrte një të pestën nga çdokush. Ai nuk depozitoi dërmim dhe as dinarë. Ndryshe nga ajo që veprojnë pretenduesit pasardhës të familjes fisnike, të cilët gllabërojnë pasuritë, depozitojnë floririn dhe sendet e çmuara, themelojnë shoqëri tregtare dhe bëjnë që të gjallërojnë banka të huaja në kurriz të pasurive të njerëzve të giorë naivë dhe që në të vërtetë këta pseudo-klerikë nuk përmbushin asnjë lloj detyrimi kundrejt edhe një dërmi të vetëm nga ato që marrin, asnjë detyrim fetar apo shoqëror.

Njerëzit përreth tyre përjetojnë uri, varfëri, dhimbje, ndërsa ata ndodhen në tjetër gjendje: ngopje, pasuri dhe rehati, madje jo

vetëm kaq, por në luks, kapadaillëk dhe shpërdorim. Në vend që të japin sadaka për nevojtarët, të bëjnë bamirësi, qoftë edhe duke dhënë Zekatin më së paku të pasurive që kanë, flori, sende të çmuara, thesare të larmishme, të cilat i kanë arritur me anë të zhvatjes së pasurive të njerëzve të gjorë, pa kurrfarë mëshire dhe pa asnjë dallim ndërmjet të varfrit dhe të pasurit, ndërmjet vejushës apo jetimit!

Një miku im fermer më tregoi, se një nga këta “klerikët” kishte shkuar tek ai në një nga sezonet e “vjeljes”, për të kërkuar “shpërblimin e mundit të tij”. Pasi u kryen shërbimet e kërkuara dhe mori “të drejtën” e tij në të holla, prodhime dhe bagëti, papritmas vuri re disa qengja aty pranë, të cilët në fakt ishin pronë e fëmijëve jetimë të motrës së fermerit (fëmijët jetimë që banonin pranë dajës së tyre, së bashku me nënën e tyre vejushë). Ai (kleriku) mori një prej qengjave. Atëherë fermeri i revoltuar i thotë: “Këta qengja i përkasin fëmijëve jetimë, të varfër dhe të ngratë.” Ai u përgjigj: “Unë jam si dajë për ta, ndaj nuk konsiderohen më jetimë.” E mori atë që deshi dhe vazhdoi i qetë!

Për sa i përket zotimeve ⁶⁴ që bëjnë për dikë tjetër përveç Allahut, ka shumë për të thënë rreth mënyrës se si e kanë përhapur këtë koncept dhe se si arrijnë t’i mbledhin përfitimet nga këto zotime. Mbi të gjitha qëndron dhe një fakt tjetër: këta njerëz (klerikë) nuk japin kurrfarë Zekati për pasuritë që kanë. Mesa duket kjo shtyllë madhore prej shtyllave të Islamit është e fshirë nga lista e tyre.

⁶⁴ Sh. p. Zotimi është një lloj betimi nëpërmjet të cilit njeriu i obligon vetes kryerjen e një veprë të caktuar (adhurim) ose dhënien e një vlere materiale sadaka, nëse i pranohet lutja apo i përmbushet kërkesa e tij. P. sh. nëse Allahu ma shëron fëmijën tim, unë do jap sadaka 1000 dinarë ose do të kryej haxh. Ky ishte zotimi i pranuar fetarisht në të cilin robi zgjidhjen dhe dermanin e tij e pret nga Allahu, ndërsa zotimi i shiave e kërkon shërimin, zgjidhjen, dermanin nga të vdekurit, (p. sh. i drejtohet Husejnit apo dikujt tjetër).

KAMATA

Për të lejuar kumatën dhe përfitimin prej saj ata kanë fetva dhe hile të ndryshme, p. sh:

Çështja nr. 1: Nuk lejohet marrja e borxhit (kredisë) në bankë, nëse vihet kusht kthimi me shtesë sepse kjo është kamata e ndaluar. Për t'i shpëtuar këtij problemi mund të përdorësh mënyrat e mëposhtme: Marrësi i borxhit (kredi-marrësi) mund të blejë nga banka një mall me vlerë më të madhe se vlera reale, 10 deri në 20 përqind, ndërkohë që i kërkon edhe një borxh me para në dorë. Një mënyrë tjetër është të shesë një mall më lirë se sa vlera e tregut, por duke i vënë kusht në këtë kontratë që t'i japë borxh një shumë të caktuar për një afat të caktuar, për të cilin të bien dakord. Në këtë mënyrë lejon kredi-marrje dhe nuk ka kumatë në të.⁶⁵

Pa asnjë dyshim, këtu kemi të bëjmë me kumatë sepse banka nuk ia dha kredinë pa i vënë kusht që të blinte një mall me vlerë të shtuar mbi realen, me 10 ose 20 përqind. Duket qartë që shtimi i vlerës së mallit që i obligohet ta blejë është me qëllim kumate, duke ndryshuar paraqitjen e jashtme: nuk i vihet shtesa borxhit në mënyrë të drejtpërdrejtë, por i shtohet mallit. Sido që të jetë, në të dyja rastet, barra bie në xhepin e atij që merr borxhin, duke e dëmtuar atë, pra nuk i nxori paratë nga xhepi i djathtë për të paguar kumatën, por nga i majti. I njëjti gjykim është edhe për rastin nëse personi detyrohet që t'ia shesë mallin bankës me vlerë më të pakët se vlera e tregut. Pra, veprojnë si beni israilët, i hidhnin rrjetat ditën e premtë dhe i mbledhnin peshqit ditën e diel.

Çështja nr. 2: Nuk lejohet depozitimi i parave në bankë me interes sepse konsiderohet kumatë.

⁶⁵ Marrë nga *Minhaxhus-salihin* 1/406

Deri këtu është në rregull, por lexo vazhdimin për të kuptuar se si futet fshehurazi nga dritarja, pasi ka dalë nga dera. Nga kjo e keqe mund të shpëtosh duke i depozituar paratë pa kushtin e interesit, d. m. th. ai le të bëjë nijet në veten e tij që nëse banka nuk ia jep interesat, ai nuk do ia kërkojë. Nëse banka ia jep, i lejohet t'i marrë ato, duke i konsideruar pasuri që nuk i dihet pronari dhe që gjykatësi ia ka lejuar marrjen e tyre ⁶⁶. Është e rëndësishme leja e dhënë nga gjykatësi, a e dini pse? Padyshim që ky lloj nijeti është i pakuptimtë dhe i pavlerë dhe nuk ndikon aspak në ndryshimin e realitetit sepse banka e ka rregull që duhet t'i japë interesat, qoftë t'i kërkojë depozituesi, qoftë jo. Kjo çështje i përngjan lejimit të një veprë të ndaluar, duke i ndryshuar vetëm emrin.

KUPONAT E FALJES !!

Cilido që ka bërë një faj ose ka lënë pa kryer një obligim fetar, apo i ka hyrë dikujt në hak, mund të japë një shumë parash dhe i falen mëkatet. Këtë veprim e quajnë: kompensimi i padrejtësive. Padyshim që kjo sjellje është pikërisht, pa asnjë ndryshim, institucioni i indulgjencës (shlyerja e mëkateve, kundrejt një pagese), e cila zotërohej dhe komandohej nga priftërinjtë në Evropë në kohën e mesjetës. Le të shohim shembuj nga transmetimet e shpikura në lidhje me këtë:

Kulejni transmeton nga Ebu Abdullahu se ai ka thënë: “Nuk ka gjë më të dashur tek Allahu se sa dhënia e dërrhemëve tek “imami”. Allahu e shndërron një dërrhem sa mali i Uhudit, në Xhenet ⁶⁷. Në një transmetim tjetër thuhet: “Një dërrhem që i jepet “imamit” është më i vlefshëm se një milion dërrhemë të dhëna për ndonjë vepër tjetër të mirë. ⁶⁸

⁶⁶ Marrë nga *Minhaxhus-salihin* 1/407

⁶⁷ *Usulul Kafij* 1/537

⁶⁸ *Usulul Kafij* 1/538

FESTA TË NDRYSHME ME EMRA USHQIMESH

P.sh: Buka e Abasit, Çaji i Abasit, Buka e Fatimes etj., ku thelbi i të gjithave qëndron në tubimin rreth ngrënies dhe pirjes, p.sh: Gëzimi i Fatimes, Zgjidhësi i Problemeve, Gjelbërimi i Iljasit, Agjërimi i Zekerijas, Përkujtimorja, etj.

Nga gjërat qesharake është dhe fakti se libri el Kafij i Kulejnit ka një vëllim të tërë që flet për festat që gëzojnë emërtime sipas emrave të ushqimeve, pijeve, frutave, etj. P. sh: Kapitulli i hallvës, Kapitulli i trangujve, Kapitulli i karrotës (e çfarë di ti rreth Kapitullit të karrotës¹) Kapitulli i preshit, i qepës, Kapitulli i shegës, Kapitulli i shishqebapit, Kapitulli i zgarës, Kapitulli i peshkut, vezës, i pulës, etj. Zoti të ruajttë nga veprat që nuk llogariten dot dhe që është e vështirë të numërohen dhe përmenden!

Jo vetëm kaq, por autori tregon për secilin ushqim dhe pije dobi të shumta specifike qesharake ku patjetër një pjesë prej tyre kanë të bëjnë me aktivitetin seksual, p. sh: nga Ebu Abdullahu transmetohet se ai ka thënë: “Konsumimi i karrotës ngroh mushkëritë dhe ndihmon në aktivizimin e organit mashkullor.”⁶⁹ Po nga ai transmetohet se ka thënë: “Karrota të ruan nga krimbat dhe ndihmon në marrëdhënie intime.”⁷⁰ Një tjetër transmetim nga i njëjti transmeutes është se kur një profet u ankua tek Allahu për dobësinë e tij fizike dhe impotencën seksuale, Ai e urdhëroi të hante qull me miell misri.⁷¹

⁶⁹ Furu el kafij 6/372

⁷⁰ Furu el kafij 6/372

⁷¹ Furu el Kafij 6/320

Kapitulli i gjashtë

MARTESA DHE ÇDO GJË TJETËR E LEJUAR APO E “VETË-LEJUAR”

“TOLERANCË” E FRIKSHME

Zgjerimi dhe toleranca në lidhje me këtë çështje delikate (marrëdhëniet intime) konsiderohet një nga belatë me rrezikshmëri të përhapur dhe e keqe që përfshin të gjitha sferat. Shumë njerëz kanë rënë shumë poshtë, duke neglizhuar, duke qenë të pavëmendshëm, të pa preokupuar për nderin, pa xheloziz familjar, veprues të veprave absurde e të pa tolerueshme, të tilla si: zinaja me të afërmit familjarë (inçesti), homoseksualiteti, etj. Situata është vërtet për të ardhur keq, ndërkohë që realiteti është akoma edhe më i rëndë, si rrjedhim edhe më i pamundur për t’u përshkruar. Të gjitha këto ndodhin para syve të atyre që pretendojnë diturinë dhe përmirësimin, duke mos pasur asnjë lloj reagimi kritik, refuzues, qoftë edhe me pëshpëritje, apo me ndonjë përpjekje për të kuruar ndonjë problem akut. Të shumtë janë ata që pretendojnë se janë përmirësues, por çfarë përmirësimi mund të presim prej tyre, përderisa fatkeqësitë dhe belatë shtohen në përpjesëtim të drejtë me shtimin e tyre (“përmirësuesve”)?! Jemi përballë një realiteti shoqëror që kërkon vëmendje, në mënyrë që të arrijmë të identifikojmë burimin e së keqes dhe institucionin që jep këto fetva.

Në çështjen e marrëdhënieve intime janë zgjeruar pa masë, aq sa kanë lejuar disa veprime dhe praktika seksuale që nuk kanë dallim me zinanë e qartë, përveç emërtimit. Në shërbim të këtij qëllimi kanë trilluar transmetime nga “imamët” (gjë prej së cilës imamët janë të pastër), në mënyrë që t’ua lehtësojnë njerëzve naivë

kryerjen e zinasë dhe t'ia lehtësojnë vetes barrën e qortimit ndaj tyre. Më hollësisht mbi këtë çështje do të lexoni në vijim.

“MARTESA” E PËRKOHSHME (NIKAHUL MUTAH)

Ajo çfarë ndodh nën emërtimin *el mutah* (përjetim i përkohshëm, martesë me kontratë afatshkurtër), në të vërtetë është zina e qartë. Nëse nuk do të ishte kështu, atëherë pse duhet të emërtohen këto lloj lidhjesh seksuale të pseudo-lejuara, me emërtimin *el mutah* (përjetim i përkohshëm kënaqësie)?! Më poshtë do sjell disa shembuj për të kuptuar idenë, duke iu shmangur debatit të pavlerë rreth faktit se a ka qenë fillimisht e lejuar kjo lloj marrëdhënie apo jo, bazuar në Kuran dhe Sunet, me qëllim që t'i shmangemi lojës në të cilën ata duan të na vënë për të na larguar nga vështrimi kritik i realitetit të hidhur, i cili përmban veprime aspak të pranueshme, për të cilat që të gjithë janë dakord se ato bien ndesh me sjelljen normale njerëzore, e për të mos folur më pas për kundërshtimin e dispozitave fetare të drejta, plot urtësi.

Le të lexojmë së bashku këto fragmente që përmbajnë një nivel të lartë imoraliteti e flasin rreth marrëdhënieve seksuale, të cilat veprohen dhe konsiderohen të lejuara të kryhen ndërmjet njerëzve, të cilët Allahu i ka dalluar mbi krijesat e tjera. E gjithë kjo ndodh nën perden e emërtuar *el mutah*.

Nëse do t'u drejtosh këtë pyetje shijave: A i lejohet një mashkulli që të marrë një femër dhe të veçohet me të diku për të kryer me të marrëdhënie intime si të dojë dhe më pas ta lerë atë, për të bërë të njëjtën gjë me një femër tjetër. E gjithë kjo “ligjërohet” duke shkëmbyer disa fjalë rreth çmimit dhe kohëzgjatjes (të kontratës) ose “numrit të herëve” ose duke thënë “të dhurova veten”, duke mos pasur nevojë për kujdestar apo dëshmitarë! Madje

as nuk është e nevojshme të dish nëse femra është e martuar apo punon si prostitutë. Padyshim që përgjigjja e pyetjes që thamë do të jetë kjo, madje nga “burimet më të besueshme” të diturisë:

Në emër të Zotit, kjo lejohet!!! ⁷²

Shembull tjetër: Ngacmimi dhe raportet intime me vajza virgjëresha të moshës 7, apo 9 vjeçare lejohet, por pa kryer aktin seksual, me qëllim që të mos kritikohet më vonë për zhvirgjërimin e saj. Pra, nuk trajtohet çështja si diçka e ndaluar apo cënim moral, apo sjellje jokorrekte ⁷³. Pas kësaj, ke të drejtë të paramendosh dhe analizosh gjatë se çfarë të ardhme do ketë morali i kësaj vogëlusheje, e cila në këtë moshë sheh dhe ambientohet me organet gjenitale mashkullore, me ngacmimet seksuale që arrijnë në çdo gjë përveç “aktit final”. Mos të harrojmë se akti seksual, sipas tyre, nuk është mirë të ndodhë në organin gjenital femëror, e që do të thotë se marrëdhënia anale është e lejuar!

A mund të pranojë një njeri fisnik xheloz, diçka të tillë për bijën e tij të vogël, apo motrën e tij, të afërmen e tij apo për çdokënd nga fëmijët e botës?! Çfarë ndjenje do përjetosh nëse vetëm e përfytyron diçka të tillë të ndodhë me vogëlushen tënde të pafajshme, thjesht përfytyroje?! Padyshim që lejimi dhe ligjërimi i kësaj sjelljeje shtazarake të përçmuar, mund të shprehet vetëm nga një shejtan, apo armik shtazarak i racës njerëzore. Si mund t’i atribuohet diçka e tillë imamëve tanë dhe t’i ngarkohet Sheriatit tonë?! Si është e mundur?! A nuk është kjo sjellja e Mizdekut ⁷⁴ dhe shfrenimi i mexhusëve?! Si mund të pretendohet që pislleku i këtij

⁷² Sa për ilustrim, shih librin *Furu el kafij* 5/540

⁷³ Për ilustrim, shih në burimin e mësipërm 5/462

⁷⁴ Mizdek bin Mubadhan (v. 531 g.) pretendues i profetësisë, i lindur në Persi, ka pasur si filozofi shoqërore zgjidhjen e problemeve, duke i konsideruar pasuritë dhe gratë e njëri - tjetrit diçka të përbashkët. Në histori njihet për teoritë e tij perverse.

“ligjërimi” të dalë nga goja e pastër e *ehlu bejtit*, për të cilët Allahu ka thënë: **“Allahu dëshiron që të largojë të keqen nga ju, o anëtarë të familjes (*ehlu bejtit*) dhe t’u pastrojë plotësisht!”** [Ahzab 33]

A mund të ketë pisllek më të madh se ky?

Shembull tjetër: “Imami i kohës” dhe “udhëheqësi i umetit” e trajton çështjen në këtë mënyrë: Nuk lejohet kryerja e marrëdhënieve seksuale me bashkëshorten, e cila është nën moshën 9-vjeçare, qoftë kjo martesë e vazhdueshme (e qëndrueshme), apo e përkohshme. Ndërsa llojet e tjera të kënaqësive me ngacmim, nëpërmjet prekjeve, përqafimeve, etj., lejohen pa asnjë problem qoftë edhe me foshnjat! ⁷⁵

As foshnja e shkretë nuk shpëtoi dot nga ata! Vallahi, këto janë sjelljet e Mizdekut dhe mexhusëve, të cilat përpiqen t’i zbukurojnë dhe ia mveshin pa kurrfarë turpi *ehlu bejtit*, në mënyrë që ta bëjnë sa më të pranueshme tek njerëzit e gjorë. Zgjuhuni nga kllapia që u ka kapluar, o ju gjumashë! O ju të gjorë që shihni ëndërra!

Një grup studentësh në “një shkollë”, në një nga ambientet e brendshme, kishin sjellë një femër të përdalë dhe ndërkohë që njëri prej tyre bënte zina me të, të tjerët prisnin në sallë që t’u vinte radha. Kështu realizohet kjo lloj “martese” diku në një vend çfarëdo, në një pjesë kohe të natës, apo të ditës. Kjo është *el mutah*!

Ne duhet të dimë edhe diçka tjetër mbi *el Iddeh* (koha e pritjes pas ndarjes), e cila është detyruar, por edhe për të përdorin një hile për ta mënjanuar. Burri bën ç’të dojë me atë femër, për aq kohë sa bien dakord, më pas, kur mbaron afati i kontratës, bën një akt martese të vazhdueshme dhe më pas e ndan menjëherë, pa

⁷⁵ Shih librin Tahrirul uestileh 2/241, të el Khumejnit

patur marrëdhënie me të, shtunë mënyrë që të konsiderohet e lejuar për dikë tjetër. Të gjithë këtë hile e bëjnë për të bazuar në ajetin kuranor: **“O ju të cilët keni besuar, kur të martoheni me besimtarët dhe më pas i ndani para se të kryeni marrëdhënie me to, nuk kanë asnjë detyrim për kohë pritjeje.”** [Ahzab 49] Këtë hile e ka përmendur Ni’metullah el Xhezairi në librin e tij *Zehru-rabia*.

Disa vëllezër tregtarë udhëtuan në një shtet fqinj, ku morën me qira një shtëpi dhe pajtuan një grua që t’u shërbente në të gjitha format sipas kësaj formule: Erdhi i pari dhe bëri *el mutah* me të për aq ditë sa do rrinte atje, derisa të vinte i dyti dhe t’ia zinte vendin, më pas i treti, e kështu me radhë... Allahu na ruajttë!

Bashkëshortja e njërit u sëmur dhe u shtrua në spital. Motra e saj shkoi në shtëpinë e saj për t’u kujdesur për fëmijët. A e di se si i bëhet e lejuar zinaja këtij burri me atë grua?! I thotë “fakihi”: “Ndahu nga bashkëshortja, por mos i thuaj ndokujt që të mund ta lajmërojë atë. Më pas, kur ajo të kthehet nga spitali, vendos me nijet që ta kthesh atë përsëri nën kurorën tënde dhe kështu zgjidhet problemi! Në këtë mënyrë ky njeri imoral bashkëjeton me kunatën dhe fle me të, për dyzet ditët që bashkëshortja ndodhet në spital. Edhe sot e kësaj dite ky njeri i tregon, pa kurrfarë turpi, shokëve të tij për dyzet ditët e “lumtura, duke ndjerë keqardhje që ajo ngjarje nuk përsëritet më, sepse shpirti i tij e lakmon “prenë” e atyre ditëve “fatlume”. Pra, si mendoni, nëse kunata do vizitojë një herë tjetër shtëpinë e motrës së saj, gjë që do të ndodhë patjetër, çfarë do të ngjajë nëse ajo takohet dhe veçohet me “shokun” e saj?!

Një fe si kjo, pa kurrfarë ndalese dhe as mahremi, si mund të pretendohet të jetë feja e *ehlu bejtit*?

Lexo më poshtë pyetjen dhe përgjigjen përkatëse, që do t’i sjell tekstualisht siç janë:

Pyetje: A lejohet ngacmimi i një vajzë muslimane të virgjër, pa dijeninë dhe lejen e kujdestarit të saj, nëse ajo ka frikë se mund të bjerë në haram?

Përgjigje: Po, nëse kujdestari e pengon atë të martohet me një burrë të denjë për të, megjithëse ajo e do atë dhe kjo pengesë është në kundërshtim me interesin e saj, atëherë nuk merret parasysh leja e tij. Lejohet ngacmimi në martesë të përkohshme (*el mutah*) me kusht që të mos kryhet akti seksual dhe as anal.⁷⁶

Pyetje: A është kusht leja dhe miratimi i kujdestarit të virgjërshës, për takimin intim mes tyre, por pa kryer aktin seksual?

Përgjigje: Në martesë të përkohshme, nuk është kusht leja dhe miratimi i kujdestarit, por duhet të shprehet verbalisht kushti i moskryerjes së aktit seksual.⁷⁷ Ama vetëm verbalisht!

O ju shija! O ju të nderuar! Këta ujqër duan të shyejnë bijat tuaja, të shkatërrojnë familjet tuaja, ndërsa ju në shkujdesje të plotë, nuk po kuptoni. Padyshim, vjedhja e nderit është më e rëndë se vjedhja e pasurisë. Ata janë njësoj si shejtanët që e përshkallëzojnë njeriun hap pas hapi, ndaj ruajuni prej tyre: **“Mos pasoni hapat e shejtanit, ai për ju është armik i hapët.”** [Bekare 168]

Zbatimi i këtyre fetvave u mundëson njerëzve të konsiderojnë të lejuara shumë nga lidhjet intime të fshehta, si p. sh: një student takohet disa herë me një shoqen e klasës dhe përparon lidhja mes tyre, derisa një ditë ai i kërkon asaj që të veçohen në një skutë të fshehtë, shtunë mënyrë që ajo t’i shfaqë atij bukuritë dhe hiret e saj. Më pas, përshkallëzohet lidhja, duke kryer me të, të gjitha veprimet intime (nuk është e nevojshme të përmendim detajet), por në një moment, ajo refuzon të vazhdojë më tej sepse

⁷⁶ Mesail ue rudud, Muhamed Sadik Sadr fq. 55

⁷⁷ I njejt burim i mëparshëm

është e virgjër dhe nuk dëshiron të turpërohet. Ndërsa ai e qetëson duke i thënë të mos shqetësohet sepse mund të kemi raport, pa kryer aktin seksual ose mund të përdorim “alternativën tjetër”. E në mënyrë që ai të triumfojë mbi hezitimin dhe turpin e saj, nxjerr një libër të Muhamed Sadik Sadr, me titull *Mesailu ue rudud*, në kapitullin e rregullave rreth martesës dhe i lexon asaj fetvanë që përmendëm më sipër. Pra, pse duhet të hezitojë kjo vashë, përderisa ky zotëri “i nderuar” e ka lejuar diçka të tillë? A nuk janë ata “mëkëmbësit e Allahut” në tokë dhe më të besueshmit për mbrojtjen e fesë së Tij? Qysh në këtë moment vajza dorëzohet, duke i lënë trupat e ndezur të takohen, e zjarri epshor të fiket në mënyrë të ndaluar, zjarr i ndezur nga bereqeti i “zotërinjve dijetarë” nën mantelin e “martesës së përkohshme”. Në vizitat që shkëmbejnë njerëzit mes tyre, brenda rrethit familjar ose miqve, gjejmë se këto fetva që i përmendëm më sipër i lejojnë një djaloshi nga familja mikpritëse të bjerë dakord që me një vajzë nga familja vizitore të veçohet në ndonjë skutë dhe të bëjnë çdo gjë: përqaftim, puthje, zhveshje, apo akoma më larg se kaq, e rëndësishme është të mos ketë akt seksual. Në dhomën tjetër, në sallonin e miqve, “i nderuar” e “krenar” qëndron i ati, duke shkëmbyer biseda me të zotët e shtëpisë, e duke rrufitur çaj, ndërsa e bija e tij i jep fund nderit të saj (virgjërisë). Kjo ndodh, nëse vajza është e virgjër, por nëse bëhet fjalë për një femër jo të virgjër, atëherë çdo gjë është e lejuar, e shijshme dhe mund të ketë akt seksual në të gjitha format!

Vërejtje: Nëse vajza është e virgjër, mund të ketë marrëdhënie anale, ndërsa nëse është e martuar, nuk ka nevojë të pyetet mbi virgjërinë! Kjo nuk është gjë tjetër, përveçse shthurje e shfrenuar dhe shoqëri ku funksionon ligji i pyllit, ku shtazët grabitqare gllabërojnë të tjerët. Të jeni të bindur se fetvaja e mësipërme e “zotërisë” në lidhje me raportin anal është një lloj nxitjeje dhe rrugëzgjdhjeje për vajzat e virgjëra, e që ju mundëson raport seksual, duke mos humbur virgjërinë derisa të vijë koha për t’u

martuar me “dhëndrin fatlum” në natën e shumëpritur, në të cilën ai do të takohet me bashkëshorten e tij “të ndershme”, “fisnike” të ruajtur mirë si një margaritar! O ju të nderuar! O ju muslimanë të medhhebeve të tjera! Ju lutem, mos mendoni kështu për të gjithë vëllezërit tuaj shi’itë sepse ata nuk janë dakord me këtë shthurje të shfrenuar, me këtë shtazëri. Ata nuk mendojnë dhe nuk e kuptojnë që fetuatë e atyre “zotërinjve” janë shkaku i arritjes në këtë nivel degjenerimi, madje shumica e popullit nuk ka dijeni fare për këto fetva. Shumë prej tyre, edhe nëse do t’i lexonin, nuk do ndaleshin shumë në to sepse nuk e kanë guximin t’i diskutojnë këto gjëra, e aq më pak t’i konsiderojnë gabim dhe as që bëhet fjalë që dikush t’u kundërvihet atyre. Populli i thjeshtë është edukuar me “shenjtërimin” e klerikëve, apo të atyre që hiqen si të tillë dhe me peshën e autoritetit klerik, deri në atë masë sa i konsiderojnë ata të pagabueshëm! Nuk mund të shpjegohet ndryshe kjo situatë sepse kush është ai njeri i ndershëm e xheloz që pranon diçka të tillë për nderin e tij! Kush do e kapërdinte të kishte bashkëshorte një grua me një historik të tillë, plot turpe për vite të tëra, duke u transferuar nga njëri prehër në tjetrin, ku njeri i vjen nga para dhe tjetri nga pas! A mund ta besosh se kjo është feja e Muhamedit?! A mund ta pranosh se *ehlu bejti* e miraton diçka të tillë?! A mund të mendosh se morali i arabëve, për të cilin u dërgua Muhamedi që ta përsoste, e lejon dhe aprovon këtë gjë?! Profeti më i nderuar ka thënë: “Jam dërguar që të përsos moralin e njerëzve...”, pra, “që të përsos” dhe jo që të përdhos!

SHTHURJA E SHFRENUAR EVROPIANE

Në mënyrë që të hapim siparin, dhe jo më shumë, në lidhje me shfaqjen e realitetit, duke mos qenë e nevojshme të hyjmë në komente të zgjatura dhe detaje, po ju servir tekstin e kësaj fetvaje.

Çështja 289: A lejohet interesimi për vajza evropiane, apo perëndimore, pa lejen e kujdestarit të tyre?

Përgjigje: Nëse supozojmë që kujdestari i saj e ka lënë atë të lirë të bëjë çfarë të dojë dhe të bëjë vetë zgjedhjet e saj si të dojë, atëherë nuk ka nevojë për miratimin e tij, madje edhe nëse po flasim për një muslimane! Po ashtu, nëse ajo vajzë beson se nuk e ka kusht miratimin e prindit, lejohet, pa pasur nevojë të kërkohet leja e prindit, madje edhe nëse ajo është muslimane!

Kjo situatë është e njëjtë me rastin kur prindi e pengon të martohet me një njeri të duhur që është paraqitur për martesë dhe nuk ekziston një kandidat tjetër më i përshtatshëm, atëherë nuk merret më parasysh miratimi dhe leja e tij.⁷⁸

A nuk përbën ky fakt ligjërimin e kaosit seksual që ndodh në Evropë, apo në Perëndimin e shthurur ku ekziston shfrenimi shtazarak? A nuk është kjo fetva, një përpjekje e demaskuar nga ana e “zotërisë” që ka si rezultat transferimin e kësaj shthurjeje në shoqërinë tonë Islame? Dikush pyet lidhur me shoqërinë evropiane ose perëndimore, vajzat evropiane dhe përgjigjja i vjen nga “zotëria” është se lejohet diçka e tillë, madje dhe me një vajzë muslimane në shoqërinë tonë Islame Lindore, e rëndësishme në këtë çështje është përmbushja e kushtit: Prindi e ka lënë të lirë të bijën të bëjë çfarë të dojë! Ose nëse vajza rebelohet dhe beson se nuk duhet t’i bindet prindit të saj sepse në zgjedhjen e saj nuk ka pse të pyesë prindin për këto çështje. Mirëpo “zotëria” nuk na sqaroi gjykimin fetar për këtë lloj prindi, i cili e lë të bijën të lirë të bëjë çfarë të dojë... Një shoqëri e këtillë ka nevojë të kurohet me terapi intensive dhe doza të forta ilaçi dhe jo thjesht me garza për pastrimin e plagës, nga e cila rrjedh qelb dhe papastërti. Përballja me fetva të tilla, të cilat ekzekutojnë me vdekje ndershmërinë e shoqërisë, zbulimi i të fshehtave që ndodhin pas perdeve përbën një nga shkaqet madhore që na bëjnë të bërtasim: “Shpëtojeni rrugën e *ehlu bejtit*!”

⁷⁸ *Mesail ue rudud*, Muhamed Sadik Sadr, fq. 55

Pse duhet t'i qortojmë vëllezërit tanë të medhhebeve të tjera, të cilët tallen me një medhheb të tillë, në të cilin kanë dhënë fetvatë dijetarët e tij?

Pse i kritikojmë ata për neverinë që ndjejnë ndaj këtij medhhebi? Përderisa ata e shohin me sytë e tyre atë që ndodh realisht dhe lexojnë gjëra të turpshme dhe poshtëruese që ndodhin tek ne, ndërsa ne çfarë bëjmë? Maksimumi ynë është të përpiqemi që të arnojmë këtë realitet të demaskuar, nëpërmjet disa letrave të shkruara ku thuhet: “Ka thënë filan fakih, apo filan mufti...”, “... i thashë ...”, “... tregohet...”, “... transmetohet...” Si mund të më bindësh që të kem besim tek një mjek, nga klinika e të cilit pacientët dalin plot me sëmundje dhe viruse vdekjeprurëse, thjesht duke më thënë: “Këto janë bazat e mjekësisë dhe rruga që ndiqet...” Unë, në cilësinë e njeriut që Allahu më ka nderuar me logjikë medituese, gjendem përballë dy alternativave: ose ky doktor është sharlatan që nuk e njeh profesionin siç duhet, ose na del detyrë që të rishikojmë dhe të rivlerësojmë ato baza dhe ato procedura që janë ndjekur në përgatitjen e këtij doktori.

Le të lexojmë më poshtë diçka akoma më të çuditshme:

Çështja 237: Në shumë vende të botës prostitucioni është i përhapur dhe shumë nga vajzat e atyre vendeve që punojnë si prostituta konsiderohen si burim fitimi. Nëse dikush shkon në këto shtete dhe dëshiron që të kalojë mirë në ato vende, a e ka detyrë të pyesë vajzën që do ketë të bëjë me të, nëse është e martuar apo prostitutë, apo e divorcuar në kohë pritjeje, apo çfarë?

Përgjigje: Nuk e ka detyrë të informohet rreth gjendjes së saj përveçse, problemit nëse ajo është e martuar dhe bindet për këtë fakt, pa asnjë dyshim, apo është e ndarë nga burri për së pari herë, le ta pyesë nëse është e lirë apo e zënë? Nëse ajo pranon që është e lirë, kjo mjafton. Ose e pyet nëse i ka mbaruar koha e pritjes dhe nëse pranon, kaq mjafton. Ndërsa ato që njihen si prostituta,

marrëdhënia nuk lejohet me to, për efekt sigurie, përveçse rastit nëse është penduar, atëherë lejohet raporti me të, qoftë i përkohshëm, qoftë akt martese afatgjatë ⁷⁹. Vini re argumentimin e ndalimit “për efekt sigurie” që do të thotë se nuk është ndalim i prerë, por më e mira është që të ruhesh. Padyshim, këto lloj “elementesh sigurie” që lihen në dëshirën e çdokujt, zhduken dhe harrohen kur njeriu zhytet dhe përlyhet në këto çështje, duke mos pasur kurrfarë vlere reale, përveçse tek një pakicë e vogël, për të mos thënë ndonjëherë në të rrallë, apo ndoshta nuk ekziston fare kjo kategori.

Përdorimi i këtyre argumentave, si “për siguri”, “nuk pëlqehet” etj., nuk është gjë tjetër, veçse mjet për të fshehur realitetin dhe për të zbutur efektin tronditës që mund të ketë njeriu, i cili neveritet nga këto fetva, apo nga refuzimi i tij. Të mos harrojmë se burime të tjera dhe “zotërinj” të tjerë e lejojnë diçka të tillë, edhe pa kushtin “për siguri”.

Çështje nr 293: A e ka për detyrë gruaja ta vërë në dijeni mashkullin, me të cilin do të martohet përkohësisht, për faktin se ajo akoma nuk ka dalë nga koha e pritjes prej një tjetri nga një “martesë e përkohshme e mëparshme”?

Përgjigjja: Nuk e ka për detyrë t’i tregojë. (!!!) ⁸⁰

Si nuk e ka për detyrë?! Sipas cilës fe dhe cilit popull?! Si është e mundur kjo, kur ekziston mundësia që ajo të jetë shtatzënë me të mëparshmin? Nëse më pas zbulohet shtatzënia, atëherë i kujt do të jetë fëmija?

NJË KATASTROFË TJETËR

Çështja 290: A lejohet “martesa e përkohshme” me vajzën e virgjër që është në moshë madhore, pa lejen e askujt, përderisa i ka vdekur i ati dhe ka vetëm të ëmën?

⁷⁹ *Mesail ue rudud*, Muhamed Sadik Sadr, fq. 55

⁸⁰ I njëjti burim i mëparshëm

Përgjigjja: Nuk ka asnjë problem. (!!!) Nëse do ta kishte gjallë gjyshin nga ana e babait, preferohet marrja e lejes prej tij, e nëse as ai nuk është, nuk ka nevojë për leje ⁸¹.

Çfarë mendon nëse një ditë vejusha e gjorë do të shohë burra të panjohur në shtëpinë e saj që kanë raport seksual me bijat e saj, madje në shtratin e saj të dikurshëm bashkëshortor, si do të veprojë ajo dhe çfarë reagimi do të ketë, nëse i thuhet që kjo është “martesë e përkohshme” pa lejen e askujt? Edhe nëse ajo do të shkojë tek “zotëriu”, ka për të marrë përgjigjen e mëposhtme: “Në emër të Zotit lejohet!”

Një shoqëri e tillë, ku udhëheqësit e saj shpirtërorë (dhe për çfarë udhëheqësish bëhet fjalë) ligjërojnë shthurjen dhe nxisin prishjen, duke i prirë karvanit të njerëzve të ndyrë, në të vërtetë është një shoqëri në gjendje më të keqe se vetë shoqëritë evropiane, në fund të fundit evropianët atë që bëjnë nuk e bëjnë në emër të fesë, apo nën bekimin e klerikëve, përkundrazi e kanë pastruar fenë e tyre nga këto pislleqe, duke marrë përsipër me kurajë dhe transparencë përgjegjësinë e përlyerjes në mëkate. Për shembull, ai që pi alkool duke besuar në ndalimin e tij bën një mëkat të vetëm, ndërsa ai që e konsideron të lejuar në emër të fesë bën dy mëkate, madje është kafir nëse e di gjykimin e ndalimit të saj. Por çfarë mund të themi për ata që e bëjnë të obligueshme në emër të fesë së pastër?! Shoqëria amerikane, megjithëse e përdalë, është më fisnike, më e pastër, më e çiltër dhe më transparente me veten e saj, atëherë kur gjykuan presidentin e tyre Klinton për lidhjen e tij të dyshimtë me punonjësen e shtëpisë së Bardhë. Pra, nëse Klintoni do ndiqte një fe të tillë, e cila nëpërmjet fetvave të tilla do t’ia lejojonte këtë gjë, nuk do t’i ndodhte ky problem. Ai me thjeshtësinë më të

⁸¹ I njëjti burim i mëparshëm

madhe do të pretendonte se ajo lidhje ishte një “martesë e përkohshme”, asgjë më shumë. Padyshim, ai do i kishte mësuar nga “klerikët” disa norma dhe kushte syfaqësore, si p.sh. shprehja të kam dhuruar veten time apo rënia dakord mes tyre për vlerën monetare dhe afatin. Këto mjaftojnë që lidhja të bëhet e ligjshme “fetarisht” dhe të mos ketë asnjë problem! Këta “klerikët” tanë e bëjnë çdo ditë dicka të tillë, madje edhe haptazi, atë që Klintoni bëri me një punonjëse. A e beson dot?!

“FËMIJË HALLALLI”

Çështja 194: Nëse bashkëshorti “i përkohshëm” fle me bashkëshorten “e përkohshme” pa e ditur se afati i martesës së përkohshme ka mbaruar dhe si pasojë e kësaj lind një fëmijë, si do ta konsiderojmë këtë fëmijë?

Përgjige: Ky fëmijë konsiderohet “fëmijë hallalli”.⁸²

U RIKTHEVA PËR KËRKIME DHE STUDIME

Thashë: A është e mundur të pranohet logjikisht se Islami erdhi në shoqërinë arabe të xhahilijetit, në të cilën gjeti shthurjen e shfrenuar dhe më pas e miratoi atë, madje e bekoji atë?

Kjo më shtyu që t’u rikthehem burimeve (librave) të referencës, duke lexuar, medituar dhe kërkuar. Aty gjeta atë që kërkoja, e cila më qetësoi dhe më gëzoi. Së pari: Gjeta që *nikahu mutah* (“martesa e përkohshme”) që ishte ekzistente në kohën e ardhjes së Muhamedit si profet, ishte martesë që nuk dallonte shumë nga martesa e ligjshme, përveç faktit të përcaktimit të kohës dhe trashëgimisë. Pra, do të thotë se miratimi i kujdestarit dhe dëshmia e dëshmitarëve ishte kusht, ndërsa ky lloj akti i shëmtuar, të cilin e

⁸² *Mesail ue rudud*, Muhamed Sadik Sadr, fq. 55

lejojnë “fukahatë” (e shijave) nuk ka të bëjë fare me atë të dikurshmin, përveç përputhjes në emërtim. Duke qenë se martesë e përkohshme në atë kohë ndryshonte nga kjo e sotmja, argumentimi me lejimin e asaj të dikurshmes është gabim trashanik, gjë që bazohet vetëm në lojën e përngjasimit në emërtim dhe asgjë më tepër. Megjithatë, edhe këtë lloj martesë, Profeti SalAllahu alejhi ue selem e ndaloi në fund të jetës së tij dhe pasi u nda nga jeta e kishte ndaluar këtë veprim ashtu, në të njëjtën mënyrë siç u ndalua alkooli me përshkallëzim. Një nga argumentet që tregojnë për ndalimin e kësaj lloj martesë është dhe fakti se asnjë nga imamët e *ehlu bejtit* nuk ishte i lindur nga kjo lloj martesë, po ashtu, asnjëri nga fëmijët apo pasardhësit e tyre në vazhdimësi për tre shekuj, deri në kohën e asaj që njihet si “fshehja e madhe.”⁸³ Pra, gjatë kësaj kohe të gjatë, ata kanë lidhur qindra martesë dhe kanë lindur prej tyre qindra fëmijë, meshkuj dhe femra. Kemi plot libra biografish, specifikisht vetëm për ta, ku përmenden pasardhësit e *ehlu bejtit* dhe nënat e këtyre fëmijëve, të cilët i ndajnë nënat në dy kategori: gra të lira dhe gra robëresha. Nëse martesë e përkohshme do konsiderohej e lejuar, atëherë nga kjo do të kishin lindur qindra fëmijë të tjerë dhe do përmendeshin në librat e biografive të tyre. Apo mos ndoshta kërkon prej meje të pranoj logjikisht dhe të besoj se ata e praktikonin këtë lloj “martesë” me qindra gra, por megjithatë asnjëra prej tyre nuk lindi fëmijë ndaj dhe nuk përmendet në librat e biografive?

Padyshim, fakti që të gjithë imamët e *ehlu bejtit* kanë qenë larg këtij veprimi, tregon se ata i largoheshin për shkak të argumentit të prerë që ekzistonte për ndalimin e kësaj vepre. Nëpër librat e transmetimeve gjejmë shumë thënie të transmetuara prej

⁸³ Sh. p: Fshehja e “imamit të fundit” nga frika se mos vritej për t’u shfaqur në kohën e përshtatshme.

tyre, por që shijat janë munduar t'i fshehin, përveç sekti Zejdij, të cilët e shfaqin haptazi ndalimin e saj nga imami i tyre Zejd bin Alij. Po marrim shembull një rast: në librin *er-Raudu en-nedir* në fikhun Zejdij vëllimi 4/218, thuhet: "Transmetohet nga imam Zejdi nga babai i tij Aliu nga gjyshi i tij Husejni nga Ali bin Ebi Talibi se ai ka thënë: "Profeti SalAllahu alejhi ue selem e ka ndaluar *nikahul mutah* (martesa e përkohshme) në vitin e Hajberit." Në një transmetim tjetër nga nipi i imam Zejdit, Hasen bin Jahja mbi këtë çështje, i cili konsiderohej fakihu i Irakut në kohën e tij, ka thënë: "Familja e Profetit ka qëndrim unanimit në lidhje me urrejtjen e *el mutah* dhe ndalimin e saj.

Vini re thënien e tij "qëndrim unanimit"!

Nga imami es-Sadik transmetohet se ka thënë: "El Mutah është zina!" Po ashtu, nga imami el Bakir transmetohet se ka thënë: "Ajo është vetë zinaja!"

Nëse i referohemi burimeve të shijave Ithneasherijeh (dymbëdhjetë imamët) do gjejmë këto transmetime: El Kulejni me isnadin e tij transmeton nga el Mufedal bin Umer, i cili tha: "E kam dëgjuar Ebu Abdullahun të ketë thënë: "Hiqni dorë prej saj! A nuk u vjen turp që t'ju shohë dikush në një situatë të turpshme dhe të përhapet lajmi tek shokët dhe vëllezërit tuaj? ⁸⁴Nga imam Zejdi transmetohet prej paraardhësit e tij, Ali bin Ebi Talibi, i cili ka thënë: "Profeti s.a shpalli ndalimin e mishit të gomarit dhe martesës së përkohshme në ditën e Hajberit." ⁸⁵ Këto transmetime janë në përputhje me transmetimet e mësipërme nga Zejditë. Nga es-Sadik transmetohet se u pyet në lidhje me *el mutah*, ai u përgjigj: "Këtë veprim tek ne e bëjnë vetëm gjynahqarët e prishur. ⁸⁶"

⁸⁴ *Furu el Kafij* 5/450 të el Amilij

⁸⁵ *Tehdhibil ahkam* 7/251 të et-Tusij, el Istibsar 3/142

⁸⁶ *Biharul enuar* 100/318 të el Mexhlisij

Imami Ebul Hasen tregon një arsyetim të mençur dhe me vlerë rreth pavlefshmërisë së kësaj martese, duke e konsideruar si shkak për të lënë pas dore bashkëshortet dhe duke dëmtuar interesin e tyre bashkëshortor. Fakt ky i ndjeshëm në realitetin që përjetojmë, ku bashkëshortet ankohen për burrat që përdorin *el mutah*, nëse doni të verifikoni mund të pyesni, madje mund të bëhet shkak që edhe bashkëshortja të shturet nga ana tjetër. Ai thotë kështu: “Mos u merrni me martesë të përkohshme dhe të braktisni shtratin bashkëshortor sepse kjo i detyron gratë të mohojnë mirësitë e kësaj martese, të luten dhe të mallkojnë burrat e tyre.⁸⁷ Nëse shi’iti vendos t’i përmbahet transmetimeve që e ndalojnë *el mutah*, kjo nuk do të thotë që ai braktis apo hedh poshtë medhhebin e tij, por në të vërtetë, ai po i jep përparësi dhe vlerë disa transmetimeve, ndaj të tjerave. Duke qenë se i gjithë medhhebi është i bazuar mbi parimin e dhënies përparësi të disa transmetimeve, ndaj të tjerave, nuk mund të ketë çështje për të cilën të mos ketë përplasje ndërmjet transmetimeve të imamëve, fakt ky që i ka bërë të vuajnë gjithmonë dijetarët e hershëm dhe ishte pikërisht ky shkak që shtyu shejh et-Tusijn, prijësin e sektit, që të shkruante librin *Tehdhibul ahkam (Përzgjedhja e dispozitave)*. Pra, çfarë mund të themi nëse çështja e pretenduar është mendimi më i dobët dhe që nuk aprovohet as me fe dhe as me logjikë?

“THUAJ: PO JU KËSHILLOJ ME DIÇKA TË VETME”

Nëse një femër, e cila jeton pa bashkëshort (e tillë si, e divorcuar, vejushë apo virgjëreshë), mbetet shtatzënë si pasojë e kryerjes së zinasë dhe nëse ky fakt i turpshëm zbulohet nga familja, atëherë ajo për të shpëtuar veten e saj gënjen me pretendimin se e

⁸⁷ *Furu el Kafij* 5/453

ka shtatzëninë nga martesë “e ligjshme” që është *el mutah*, si do të mund të arrijmë t’i japim zgjidhje kësaj çështjeje?

O ju njerëz! Një fe e tillë, në të cilën zhduket dallimi ndërmjet së keqes dhe të mirës, nuk njihen kufijtë ndarës ndërmjet shirkut dhe teuhidit, ndërmjet gënjeshtërsë dhe çiltërsisë, ndërmjet zinasë dhe martesës; një fe që i lejon një mashkulli të qëndrojë tek pragu i portës së tij, duke iu ofruar grave që shkojnë dhe vijnë për të pranuar që të mbyllen në dhomën e gjumit për t’u çiftëzuar, qoftë edhe për një orë (e pse jo edhe për më pak) dhe më pas ta lërë të qetë që të largohet, në mënyrë që ai të kërkojë një tjetër femër dhe ajo të ndalojë tek një tjetër mashkull, veprim ky që nuk dallon aspak nga veprimtaria e prostitucionit. Ah po, dallon vetëm nga përdorimi i disa termave për mënyrën e marrëveshjes mes tyre, për atë kohë të caktuar, kundrejt një grushti me grurë ose kafshate buke. Një fe që toleron gjëra të tilla, kurrë nuk mund të jetë feja e Allahut apo Sheriati i ligjëruar për *ehlu bejtin* e Profetit. Nëse dikush bën të njëjtin veprim me një grua të marrë nga rruga, konsiderohet zinaqar dhe mbi të zbatohet ndëshkimi, i cili mund të jetë edhe me gurëzim, deri në vdekje, vetëm e vetëm “nga pakujdesia” në shqiptimin e formaliteteve të fshehta, të cilat nuk ndryshojnë nga zinaja dhe duke qenë se aty merremi vesh për pagesën dhe kohën e shfrytëzuar.

VALLË, KU KA SHKUAR LOGJIKA?

Lexo me mua, transmetimin e mëposhtëm të el Kulejnit në librin *Raudatul Kafij*, ku thotë: “Nga Muhamed bin Muslimi transmetohet se ka thënë: “Hyra tek shtëpia e Ebu Abdullahut dhe i thashë: “Kam parë në ëndërr sikur hyra në shtëpi dhe pashë gruan time që kishte thyer shumë arra dhe i kishte shpërndarë para meje. U habita nga kjo ëndërr, çfarë komentimi ka?” Ai m’u përgjigj: “O

Ibni Muslim, ti bën *el mutah* me grua tjetër dhe këtë e merr vesh bashkëshortja jote dhe ajo nga inati shqyen rrobat sepse lëvözha e arrës është veshja e bërthamës.” Ibn Muslimi tha: “Vallahi, komenti i tij u bë realitet mëngjesin e Xhumasë, kur unë po rrija tek porta e shtëpisë dhe kalon pranë meje një vajzë që më pëlqeu shumë. E ftova të hynte në shtëpi, bëra me të *el mutah*. Në një moment më ndjeu bashkëshortja ime, e cila donte të hynte në dhomë. Vajza u largua me të shpejtë, ndërsa gruaja ime, nga inati më grisi rrobat e reja që i kisha bërë gati për festa.”⁸⁸

MARRËDHËNIA BASHKËSHORTORE

Vini re se si janë zgjeruar në këtë çështje! A lejohet seksi anal! Unë jam i bindur që nëse gruaja do të kishte alternativa të tjera nga ku mund të kryhej akti seksual, ata do ta bënë të lejueshme. Fundja, pse jo (sipas tyre)? (!!!)

Kulejnj transmeton se kur er-Rida u pyet: “A i lejohet burrit të ketë marrëdhënie anale me gruan e tij? Ai u përgjigj: “Po i lejohet.”⁸⁹ Padyshim, ky pohim është shpifje për Ridanë sepse ai nuk mund ta thotë diçka të tillë. Ndërsa në lidhje me raportin seksual me gratë gjatë menstruacioneve tregohen ekstra tolerantë, duke e lejuar marrëdhënien me të dhe duke e mbyllur çështjen me anë të kompensimit me një shumë të caktuar të hollash. Për sa i përket marrëdhënies anale, nuk obligohet asnjë lloj kompensimi sepse maksimumi që kanë thënë “fukahatë” është mospëlqimi i këtij veprimi. Përderisa pretendohet kështu, atëherë nuk i mbetet asnjë lloj kuptimi i ajetit kuranor: **“Largohuni nga marrëdhëniet me gratë gjatë menstruacioneve dhe mos iu afroni atyre (për marrëdhënie) derisa të pastrohen” [Bekare 222]** sepse kontakti

⁸⁸ Raudatul Kafij 8/292

⁸⁹ Furu el kafij 5/540

seksual anal lejohet në çdo rast (sipas tyre), ndaj më thoni si mund të arrihet përmbushja e largimit prej tyre, kur ekziston kontakti?

Cili organ është me më shumë papastërti?! Allahu thotë: **“Të pyesin për menstruacionet. Thuaj: Është periudhë papastërtie ndaj largohuni nga marrëdhëniet me gratë gjatë menstruacioneve” [Bekare 222]**, pra shkak i moskryerjes së marrëdhënies qenka ekzistenca e papastërtisë në organin gjenital femëror gjatë menstruacioneve, por a nuk është organi tjetër (anusi) gjatë gjithë kohës bartës madje i një niveli akoma më të lartë papastërtie? Nuk mendoj se dikush mund të më kundërshtojë në këtë pikë.

Lexoje fetvanë e mëposhtme:

Çështja 67: Nuk lejohet marrëdhënia seksuale me gruan gjatë ditëve të menstruacioneve, ndërsa marrëdhëniet anale kanë një lloj paqartësie dhe debati, por më e sakta është se ajo lejohet nëse gruaja është dakord, por nëse ajo nuk është dakord, më e mira dhe më e sigurt është të ketë një raport të tillë! ⁹⁰

Më poshtë e toleron çështjen akoma edhe më shumë duke thënë:

Çështja 68: Më e mira dhe më e sigurt është që të japë shpagim për marrëdhëniet e kryera me gruan gjatë zakoneve, nëse ky veprim bëhet me vetëdije. ⁹¹

Vini re: “Më e sigurt” dhe jo “e detyrueshme”!!! Ndërsa shejhu i sekti, Ebu Xhafer et-Tusij transmeton si më poshtë nga Ebu Jafari, i cili tha: “E kam pyetur Ebu Abdullahun në lidhje marrëdhënien anale dhe ai më është përgjigjur se nuk ka problem nëse gruaja pranon një raport të tillë! E kam pyetur Ebul Hasen er - Ridanë në lidhje me marrëdhënien anale dhe ai më është përgjigjur se ajeti kuranor ku tregon thënien e Lutit e lejon: **“Këto janë vajzat**

⁹⁰ E Mesailul muntehabeh 35-36 të es-Sistani

⁹¹ I njëjti burim i mëparshëm

e mia, janë më të pastra për ju” [Hud 78] dhe ai e dinte bindshëm se populli i tij pëlqenin vetëm marrëdhënie anale. Et-Tusij e bën këtë komentim pas dy transmetimeve që tregojnë ndalimin e kësaj veprë, ku në njërën prej tyre transmetohet nga Ebu Abdullahu se Profeti SalAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Marrëdhëniet anale me gratë janë të ndaluara për popullin tim”, këto dy transmetime kanë për qëllim mospëlqimin dhe se më e mira është moskryerja e kësaj veprë, megjithëse është lejuar. Ky pohim vërtetohet nëpërmjet asaj çfarë transmetohet nga Ahmed bin Muhamed bin Isa nga el Bekij nga Ebu Jafari, i cili tha: “E pyeta në lidhje me marrëdhëniet anale me gratë dhe m’u përgjigj se nuk ka asnjë problem, por nuk është e preferueshme. Po ashtu, ekziston mundësia që transmetimet të jenë thënë në formë e *et tekijeh* (sa për sy e faqe). (!!!)⁹²

VEÇIMI ME GRATË

Prej dukurive më të përhapura tek shijat, tek ata që pretendojnë se janë “klerikë” dhe “zotërinj”, është se kur duan t’i këndojnë rukje ndonjë gruaje, i vënë kusht asaj që të veçohen vetëm për vetëm dhe i largojnë shoqëruesit e saj. Në krahinën tonë kemi një të tillë që kur i shkon një burrë me gruan, apo motrën e tij, i thotë “Ne pranojmë vetëm gratë” dhe refuzon ta fusë burrin brenda.

Në këtë mënyrë janë hedhur bazat e disa zakoneve shoqërore të rrezikshme. Një djalë i dajës tim më tregoi: “Isha me një shokun tim në treg dhe ai më ftoi në shtëpinë e tij. Aty gjetëm një djalosh të ri që po bëhej gati për t’u larë në dush dhe shërbimet përgatitore po ia kryente motra e shokut tim. Shoku im kur e pa atë u gëzua shumë, i uroi mirëseardhjen në mënyrë të zjarrrtë, duke përsëritur shpesh thënien: “Mirësevjen “zotëri”, na paska ardhur bereqeti i “zotërisë” tënde”, ndërsa “zotëriu” ndodhej gjysmë i

⁹² *El Istibsar* 3/242 të et-Tusij

zhveshur dhe “për fat” ishte i pashëm dhe i bukur. Pas pak dolëm nga shtëpia duke i lënë në shtëpi “zotërinë” me tre motrat e shokut tim (tre vajza të vetme!!!). Gjatë rrugës i pëshpërita në vesh: “Si mund të lësh një burrë të huaj në shtëpinë tënde vetëm, me femrat e shtëpisë?!” Kur papritmas përgjigjia e tij qortuese dhe me sy të flaktë ishte: “Çfarë? Ti dyshon tek “zotëriu”?!!!

ZOTIMET E GRAVE PËR TEK “ZOTËRIU”

Ky është një fenomen i përhapur, megjithëse në vetvete përmban përçmim të grave, eliminim të personalitetit të tyre dhe njerëzillëkut. Njëherë erdhi një grua dhe më pyeti: “Nëna ime më kishte premtuar që kur isha fëmijë tek një “zotëri”, por nuk e përmbushi zotimin e saj dhe unë u martova me një tjetër, por nuk shkoj aspak mirë me bashkëshortin. A mos vallë shkak i gjithë kësaj është ndëshkimi për mos përmbushjen e zotimit?!

ÇUDIRA, HABI DHE PARADOKSE

Shikimi i fytyrave të grave të bukura lejohet.⁹³ Shikimi i auresit të jomuslimaneve lejohet.⁹⁴

Sipas këtij transmetimi të trilluar, i cili i mveshet *ehlu bejtit* padrejtësisht, është e lehtë të arrish në përfundimin se lejohet shikimi i filmave pronografikë të huaj sepse aktorët e tyre janë jo muslimanë. Ndërsa aureti i muslimanit mjafton të mbulosh me dorë organin gjenital, sepse anusi është i mbuluar vetvetiu.(!!!)⁹⁵ Aureti i mashkullit që duhet mbuluar në namaz është organi gjenital, testikujt dhe anusi. (!!!)⁹⁶ Pra, vini re se deri ku kanë arritur në

⁹³ *Furu el kafij*, 5/542

⁹⁴ *Furu el kafij*, 6/501

⁹⁵ *Furu el kafij*, 6/501

⁹⁶ *El mesailul muntehabeh*, fq. 100 të es-Sistani

mbulimin në namaz. Imagjino një burrë që po falet në këtë formë mbulimi, apo një xhemat burrash duke u falur...

Lejohet vështrimi i trupave femërorë të grave që zbulohen pjesërisht, me kusht që të mos ketë për qëllim kënaqësinë epshore, duke mos pasur dallim ndërmjet grave muslimane dhe jomuslimane, ashtu siç nuk ka dallim në atë çfarë sheh, mund të jetë dorë, fytyrë, apo ndonjë pjesë tjetër e trupit që ato e kanë zakon t'i zbulojnë.⁹⁷ Mund të shohësh edhe kofshët, më lart ose më poshtë, për sa kohë që ato e konsiderojnë gjë (normale) të zakonshme zbulimin e tyre! Kushti që vënë është që të mos kesh për qëllim kënaqësinë epshore. Është njësoj si të thuash: "Lejohet konsumimi i alkoolit, me kusht që të mos dehes. Lejohet veçimi me një grua të huaj me kusht që të jesh i sigurtë se nuk do të ndodhë diçka e ndaluar."⁹⁸ O Zot, çfarë kushti!

Lejohet që gruaja të mësojë drejtimin e makinës me një burrë të huaj dhe ata të dy të shkojnë në vendet e posaçme për praktikë dhe mësim, megjithëse ato vende mund të jenë të veçuara nga njerëzit, me kusht (gjithmonë i rëndësishëm është kushti!) që të mos bien në haram!⁹⁹ Pra siç thashë edhe më sipër "pi alkool, por me kusht që të mos dehes".

Lejohet që burri të flejë ndërmjet dy grave në të njëjtin shtrat.¹⁰⁰ Gjithashtu, lejohet (sepse çdo gjë është e lejuar) që burri të shohë bashkëshorten e skllavit të tij dhe nëse i pëlqen dhe dëshiron të flejë me të, e urdhëron skllavin e tij ta lerë (dhe më pas, nëse zotëriu dëshiron) t'ia kthejë përsëri.¹⁰¹ Me pak fjalë ta marrë hua përkohësisht!

⁹⁷ *El mesial të es-Sistani*, fq. 348, çështja nr. 1 020

⁹⁸ I njëjti burim i mëparshëm, çështja nr. 1 030

⁹⁹ *Mesial ue rudud* fq. 77, çështja nr. 407, të Muhamed Sadik Sadr.

¹⁰⁰ *Furu el Kafij* 5/560

¹⁰¹ I njëjti burim 5/481

Lejohet që dikush t'ia japë përkohësisht gruan vëllait të tij ... T'i japë hua çfarë?! T'i japë... për përdorim gjenitalet e skllaves së tij, në mënyrë që ai të kryejë marrëdhënie me të dhe më pas, t'ia kthejë mbrapsht (pra, t'ia japë hua). ¹⁰² Ata thonë që Umeri përdhunoi vajzën e Aliut dhe Aliu e pranoi këtë fakt nga frika prej tij dhe i gjithë ky trillim i atribuohet imamit es-Sadik, duke e formuluar historinë thriller me shprehje të tilla që e trondisin njeriun: “Na është përdhosur nderi...” ¹⁰³

Përdhunimi është vepër e dënueshme edhe në Sheriatin e Klintonit, Blerit, Ehud Barakut. Të gjitha shoqëritë, qoftë edhe ato të shthururat, e konsiderojnë krim të dënueshëm me ligj. Sipas thrillerit të mirënjohur dhe të mirëtrilluar, Aliu ia mori hakun dyfish sepse një herë kur kishte shkuar mysafir tek Umeri e kaloi natën në gjirin e motrës së Umerit, pa dijeninë e tij. Më pas, ata vazhduan ta frekuentonin njëri - tjetrin: Umeri tha: “A nuk kam dhënë urdhër që kush jeton në qytet të mos flerë i vetëm?” Aliu u përgjigj: “Për këtë pyet motrën tënde.” ¹⁰⁴ Pse jo, pas gjithë kësaj, ata hëngrën iftar së bashku dhe në fund u përshëndetën me njëri – tjetrin duke qeshur. Vallë, a është kjo panorama e shoqërisë profetike?! Apo është ç'nderim?!

Si të duket dhe çfarë do të ndjeje nëse do të ftoje një mikun tënd në shtëpi, e kur të zgjoheshe pas mesnate ta gjeje në shtratin e motrës tënde? Çfarë qëndrimi do të mbaje? Mos vallë do t'ju kërkoje ndjesë për shqetësimin dhe do të mbyllje derën sërish, apo çfarë? Sepse kështu veproi Aliu, sipas transmetimeve të trilluara dhe fetvave të mësipërme që e lejojnë diçka të tillë.

¹⁰² I njëjti burim 5/470

¹⁰³ *Zehru er-rabi* fq. 14, të Nimetullah el Xhezairi

¹⁰⁴ *Furu el kafij* 235

PRETENDIM SKANDALUZ DHE SHPIFJE E TURPSHME

Në librin *el Kafij* të el Kulejnijit lexova dhe se më i zgjedhuri i Allahut nga njerëzit, më i moralshmi, ai më i turpshmi, kur dëshironte të martohej me ndonjë grua, dërgonte dikë që ta shihte paraprakisht dhe porosiste një nga gratë: “Shikojni nyjen e këmbës sepse nëse e ka të mbuluar me mish (pra, pothuajse nuk duket) tregon për madhësinë e organit gjental. Sa skandaloze ishte ajo që lexova!¹⁰⁵

Po ashtu kanë trilluar dhe shpifur për gratë e profetëve, duke pretenduar për to gjëra të turpshme.¹⁰⁶ Pra, nëse kjo është gjendja e më të mirit prej njerëzve që është dhe shembulli për ta, atëherë ç’mund të presim nga populli i thjeshtë?

ABUZIMI ME DETAJET MBI INTIMITETIN DHE MARRËDHËNIET SEKSUALE NËPËR LIBRA DHE BROSHURA

Ajo që të bie në sy në burimet e referimit të shijave është përmendja e shpeshtë dhe përdorimi i detajeje rreth marrëdhënieve seksuale, me shprehje në zhargon vulgar. Gjithashtu, përmendim edhe vepra të shëmtuara që janë të neveritshme për njerëzit me mendje të shëndoshë, përmendje kjo e cila ka si qëllim shpikjen e hileve “fetare” për t’u çliruar nga gjynahu që meritojnë për ato veprime, gjë, e cila të lë të kuptosh se këto krime dhe veprime të ulta janë shndërruar në një rutinë normale, pas së cilës njerëzit janë dhënë në mënyrë maniake dhe i kryejnë ato pa hasur

¹⁰⁵ *Furu el Kafij* 5/335

¹⁰⁶ *Usulul Kafij* 2/404

në kurrfarë qortimi apo kritike, qoftë dhe nga “dijetarët”. Në rastet me krimin e homoseksualitetit apo krime të ngjashme, i gjithë preokupimi kryesor i “fakihut” është të zgjidhë dilemën e guslit: nëse është uaxhib apo mustehab! Fjalët fryhen dhe stërhollohen në mënyrë të tepruar, në lidhje me gjëra që dhe lapsi ka turp t'i shkruajë, si p. sh: marrëdhëniet homoseksuale me babanë e nuses, me vëllanë, me xhaxhanë, me gjyshin e saj, apo marrëdhëniet seksuale me nënën, apo tezen e saj. Pra, turpe dhe fatkeqësi që kanë përfshirë shoqërinë në mënyrë tronditëse. Ata, nëpërmjet kësaj mënyre ligjërimit dhe shkrimit i nxisin njerëzit, duke ua zbutur peshën e gabimit, u mësohet veshi duke i dëgjuar pa ndërprerë, madje gjatë shfletimit të fletëve të këtyre librave “të fikhut” ndjen sikur u afroresh më shumë këtyre veprimeve të ulëta, sikur të ftojnë vetvetiu. Marrim shembull fetva të tilla: Marrëdhënia anale me hemafroditin ¹⁰⁷ e detyron vepruesin të marrë gusl, për siguri, ndërsa Nëse hemafroditi kryen marrëdhënie me një mashkull ose femër, pa ejakulim, nuk e ka detyrë guslin. ¹⁰⁸ Raporti seksual vaginal ose anal me gratë, e bën detyrë guslin, ndërsa në marrëdhënien seksuale me të tjerë veç grave, gusli është thjesht për siguri. ¹⁰⁹

Vini re: “Me të tjerë veç grave” (!!!) Kuptimi praktik i këtyre lloj fetvave nuk është gjë tjetër veçse alternativë e “një rruge tjetër kalimi në rast trafiku”. Të gjithë këtë e mundëson “fakihu i mençur” që meriton “të falënderohet dhe shpërblehet”, pse jo?! Ai që udhëzon për të mira është njësoj si vepruesi.

¹⁰⁷ Që i ka të dyja organet gjenitale mashkullore dhe femërore.

¹⁰⁸ *Minhaxhus salihin* 1/47, të el Khauij. MashAllah, çfarë minhaxhi dhe Allahu “i bekoftë” njerëzit e mirë!

¹⁰⁹ *El mesailul muntehabeh* fq. 14, te el Khauij

Fetva tjetër: Çështja nr. 982: “Nëse kryen zina me tezen e tij, para se të lidhë aktin e martesës me bijën e saj, ajo vajzë i bëhet e ndaluar, për siguri. (Vallë, pse?) Ndërsa, nëse bën zina pas lidhjes së aktit, nuk i bëhet e ndaluar ajo martesë.”¹¹⁰

Çështja nr. 983: Nëse bën zina me një grua të huaj, më e mira dhe më e sigurta është (pra, vini re: “më e sigurta, por jo e detyrueshme”) që të të mos martohet me të bijën e saj. Nëse e ka lidhur aktin e martesës me të bijën dhe pastaj bën zina me të ëmën, padyshim që martesë nuk i bëhet e ndaluar.¹¹¹

Çështja nr. 985: Nëse bën zina me një grua të martuar, apo me një grua të divorcuar në kohën e pritjes, martesë me të i ndalohej përgjithmonë, thjesht për siguri, ndërsa nëse gruaja e divorcuar është në ndarje pa të drejtë kthimi, martesë me të nuk konsiderohet e ndaluar, kështu pasi ajo të kryejë kohën e pritjes ai mund të martohet me të.¹¹² Sa larg është kjo fetva nga fjala e Allahut: **“Me laviren mos të martohet dikush tjetër, përveç një laviri ose idhujtari. Diçka e tillë ndalohej për besimtarët!”**
[Nur3]

Çështja nr. 986: Nëse bën zina me një grua të pamartuar, apo të divorcuar që nuk është në kohë pritjeje, më pas martesë me të lejohet por për siguri duhet të vonojë lidhjen e aktit të martesës, derisa të kalojë një herë të përmuajshmet. I lejohet dikujt tjetër (jo ai që bëri zina me të) të lidhë martesë me të, edhe pa pritur ardhjen e zakoneve, por më e mira është të presë.¹¹³ Pra, i lejohet dikujt tjetër që të martohet me atë grua, përveçse nëse ajo njihet për kurvëri, atëherë preferohet që të mos martohet me të para se ajo të

¹¹⁰ *Mesailul el muntehabeh*, fq. 339 të es-Sistani

¹¹¹ I njëjti burim i mëparshëm

¹¹² I njëjti burim i mëparshëm

¹¹³ *El mesailul muntehabeh*, fq. 300 të el Khaui.

pendohet. Pra, më e mira dhe më e sigurta është të pritët sa ajo femër të kalojë njëherë zakonet, me qëllim që të pastrohet nga zinaja. ¹¹⁴

Çështja 989: Gruaja nuk konsiderohet e ndaluar për burrin e saj nëse ajo bën zina, edhe nëse ajo vazhdon me këmbëngulje në atë veprim, por më e mira (vini re: ‘më e mira’) për burrin është që ai ta ndajë, përderisa ajo nuk pendohet. ¹¹⁵

Singerisht, unë nuk e kuptoj se kujt i drejtohet kjo fetva dhe tek kush kërkon të ndikojë? Nuk bën gjë tjetër veçse kërkon të formojë një personalitet mashkullor të shpëlarë, pa pikë xhelozie dhe burrërie. A mund të presësh nga ky lloj mashkulli i shpëlarë të pyesë rreth hallallit dhe haramit në një shoqëri të tillë ku e keqja konsiderohet e mirë dhe e mira shihet si e keqe. Një shoqëri, ku këto veprime të shëmtuara i konsiderojnë gjëra të lehta dhe bashkëjetojnë me to, si të ishin diçka normale sepse përndryshe për çfarë i duhen këto fetva këtij lloj njeriu, i cili pranon për veten dhe familjen e tij diçka që as kafshët nuk e pranojnë ta shohin në mesin e tyre? Çfarë vlere ka një shoqëri e tillë ku kryhen këto turpe pa kurrfarë qortimi? Çfarë përfiton nga këto fetva? Nuk kanë asnjë rol tjetër përveçse të firmosin miratimin dhe qarkullimin e këtyre veprimeve, madje të vulosura nga “fukahatë”! Vallë, a është ky roli që ata duhet të kenë? Pse në shtetet e tjera Islame këto turpe nuk ekzistojnë dhe fukahatë as që kanë nevojë atje të flasin rreth këtyre temave, apo të japin fetva në lidhje me to?

Fakihu tek ne (shijat), në fetvanë e tij nuk i kushton rëndësi thelbit të çështjes, por përqendrohet në hollësira dhe detaje dytësore, duke u marrë vetëm me to. Marrim si shembull faktin që “fakihu” nuk përmend fare peshën e madhe të krimit që bën burri

¹¹⁴ *El Mesailul muntehabeh* të es-Sistani 339.

¹¹⁵ I njëjti burim i mëparshëm, fq. 340

që nuk ka xheloz, duke lejuar poshtërsitë të ndodhin në familjen e tij dhe që një burrë i tillë nuk hyn në Xhenet, ¹¹⁶ e cila në të vërtetë është gjëja më e rëndësishme në këtë çështje. Mirëpo “fakihi” ynë e anashkalon dhe neglizhon plotësisht trajtimin e kësaj gjëje esenciale, duke e humbur kohën me detaje rrethimore të parëndësishme.

Lexo me mua këtë fetva: Çështja nr. 991: Nëse një i rritur kryen marrëdhënie homoseksuale me një të mitur, atëherë këtij personi i bëhet e ndaluar martesë me nënën, motrën ose të bijën e partnerit (vini re: vetëm gratë e brezit të parë). Ndërsa nëse ka dyshime mbi kryerjen e aktit seksual anal, këto gra nuk i ndalohen, po ashtu nuk konsiderohen të ndaluara për të edhe nëse mashkulli aktiv është i mitur, ndërsa mashkulli pasiv është i rritur. (!!!) ¹¹⁷

Çështja nr. 992: Nëse burri martohet me një grua dhe më pas kryen marrëdhënie homoseksuale me babanë ose me vëllanë e saj, apo edhe me djalin e saj, ky fakt nuk ia bën të ndaluar bashkëshorten. ¹¹⁸

Një shoqëri e tillë, e cila ka nevojë për fetva të kësaj natyre, në të vërtetë është një shoqëri e degjeneruar dhe për t’u ardhur keq. Ata “dijetarë” dhe “fukaha”, ekzistenca e të cilëve në këtë shoqëri të degraduar nuk arrin të japë ndikimin e duhur për frenimin e këtij degjenerimi ekstrem, duhet të marrin plaçkat dhe ta braktisin këtë

¹¹⁶ Sh. p. Një pretendim i tillë ka nevojë për një hadith ku të mbështetet, por edhe nëse do të kishte një hadith të tillë të saktë, kuptimi do të ishte që ky person meriton të ndëshkohet për këtë faj, aq sa e gjykon Allahu të drejtë, por më pas, përfundimi i tij është Xheneti nëse ka vdekur me besim të pastër, qoftë edhe sadopak.

¹¹⁷ *Mesailul muntehabeh*, fq. 300, të el Khauij

¹¹⁸ *El mesailul muntehabeh*, fq. 340, të es-Sistani

vend, në të cilin misioni i tyre ka dështuar, sidomos nëse kujtojmë faktin se ata jetojnë nëpërmjet pasurisë, mundit dhe djersës së popullit, i cili kontribuon për ta. Cila është detyra e fakihut: Të merret me një rast të veçuar anomal, apo të studiojë aktualitetin dhe më pas të japë udhëzimet dhe fetvatë e duhura? Mos vallë detyra e tij është akoma më shumë se kaq: Frenimi dhe pengimi i shoqërisë në mënyrë parandaluese nga rënia në veprime të tilla ose së paku të përpiqen të gjejnë mënyrën e saktë të shërimit efikas në rastet spontane ku situata ka dalë jashtë normalitetit, me gjithë shkaqet parandaluese? Është e papranueshme që anomaliteti të zërë vend dhe të shndërrohet në realitet të pashmangshëm, ndaj të cilit askush nuk qorton, refuzon, apo kritikon. Një sëmundje, e cila zhvillohet dhe përparon si pasojë e “fetvave të bereqetshme” të muftive që e shohin të keqen me qetësi, gjakftohtësi, nerva të patrazuara, a thua se çështja s’ka të bëjë fare me ta; a thua se kjo shoqëri nuk është shoqëria e tyre nga ku kanë dalë dhe ku jetojnë. Një situatë të tillë nuk i kam gjetur dot diçka të ngjashme, përveçse në Teuratin e çifutëve që ata e quajnë Libri i Shenjtë, ku shenjtërojnë të keqen. Nëse dikujt do t’i thuhej “vajza jote ka ngelur shtatzënë prej zinasë së kryer, ndaj ajo dëshiron që ta abortojë këtë fëmijë”, ai të përgjigjet “po e ka këtë të drejtë!” ose “jo, kjo gjë nuk lejohet!” Pasi mbaron këtë fjalë mbulon kokën me batanije dhe zhytet në gjumë të thellë!!!

Unë dyshoj në prindërimin e këtij njeriu dhe e them prerazi që ai është *dejuth* (njeri që pranon të ndodhin turpe në familjen e tij). Të dyja zgjidhjet janë të hidhura. Sipas këtij shembulli, krahaso atë që po ndodh sepse kjo është sjellja e fukahave me popullin e tyre në raport me krimet dhe paturpësitë që po ndodhin.

Ndoshta zemra jote po çahet si me thikë nga ajo çfarë po dëgjon! A nuk të paralajmërova se kemi përballë një realitet të hidhur?! Por, ... megjithatë, më mirë të shijojmë thikën në dynja

sepse thikat e ahiretit janë më të rënda. Së fundmi, lexo edhe këtë skandal të tmerrshëm dhe që si ky ka shumë e shumë të tjerë:

Një nga gjërat që e bëjnë detyrë guslin është dhe kryerja e marrëdhënieve seksuale, akt i cili quhet i kryer me depërtimin e fillimit të organit gjenital mashkullor, brenda organit gjenital femëror ose anusit të saj. Në rastin kur organi mashkullor depërton jo në organin gjenital femëror, më e mira është të marrë gusl dhe abdes, si p.sh: homoseksuali aktiv dhe ai pasiv, nëse kanë qenë pa abdes para aktit, por nëse kanë pasur abdes, u mjafton vetëm të marrin gusl. ¹¹⁹

Shih çfarë kujdesi i devotshëm tregohet “...nëse kanë pasur abdes nuk ka nevojë!” Pra, nëse homoseksualët kanë pasur abdes para kryerjes së kontaktit, kanë detyrë vetëm guslin dhe jo abdesin, gjithmonë ki parasysh faktin që “kjo është më e mira, për siguri”!!! A e imagjinon dot çështjen? Një homoseksual me abdes, a thua se është bërë gati për të falur namaz dhe jo për të kryer një veprim mëkatar që është nga gjynahet më të turpshme dhe më të rënda!!!

Në këtë mënyrë ata “fukaha besnikë ndaj fesë së Allahut” i bekojnë turpet dhe veprat e ndyra. Zbatimi në praktikë i kësaj fetvaje mund të imagjinohet në ndonjë nga këto tre situata:

-Homoseksuali aktiv dhe ai pasiv ishin bërë gati për të falur namazin, mirëpo në një moment ju lindi dëshira për marrëdhënie dhe nuk është çudi që të jenë mysafirë pranë Qabes. Përderisa ata abdesin nuk e prishën dhe guslin e kanë vullnetar sipas dëshirës, atëherë qetësisht mund të ngrihen dhe ta falin namazin plot përkushtim dhe përulje!!!

-Ose në një situatë tjetër, ata e kryejnë marrëdhënien pas namazit.

-Ose morën abdes para marrëdhënies dhe “preferohet” që të marrin përsëri abdes, thjesht “për siguri”. Kjo ndodh sipas

¹¹⁹ Minhaxhus-salihin 1/47 të el Khauij

minhaxhus-salihin ("rrugës së të mirëve"), ndaj nuk e imagjinoj dot se si mund të jetë situata sipas rrugës së të prishurve! A të zuri dhimbja e kokës? A po të përzihet përbrenda? Nëse dëshiron të vjellësh lexo këtë recetë:

Profeti e këshilloi Aliun (sipas tyre) dhe i tha:

"O Ali, kur nusja të hyjë në shtëpinë tënde, hiqja sandalet kur të ulet dhe laja këmbët (imagjinoni prijësin e besimtarëve, trimin e trimave, duke i hequr sandalet nuses dhe duke i larë këmbët!).

"O Ali, mos kryej marrëdhënie me gruan tënde në fillim të muajit, në mes dhe në fund të tij sepse çmenduria, sëmundjet vdekjeprurëse dhe paraliza do të prekin atë dhe fëmijën e saj."

"O Ali, mos kryej marrëdhënie me gruan tënde pas dreke sepse nëse ngjizet një fëmijë, ai do të jetë sy shtrembër."

"O Ali, mos fol gjatë kryerjes së marrëdhënieve sepse nëse ngjizet një fëmijë, ai do të jetë memec."

"Asnjëri të mos shohë organin e bashkëshortes së tij, ta ulë shikimin gjatë aktit intim sepse vështrimi i organit shkakton verbërim tek fëmija."

"O Ali, mos kryej marrëdhënie me bashkëshorten tënde duke menduar për një tjetër sepse nëse ngjizet një fëmijë në atë kohë, kam frikë se do të jetë hemafrudit ose femër e paralizuar.

"O Ali, kur të kryesh marrëdhënie, ti mbaj me vete një copë leckë dhe gruaja jote të mbajë një copë leckë, në mënyrë që të mos fshihen të dy me të njëjtën leckë sepse kjo shkakton armiqësi mes jush dhe më pas çon në ndarje."

"O Ali, mos kryej marrëdhënie në këmbë sepse ai ishte veprim i gomerëve dhe nëse në atë kohë ngjizet një fëmijë, ai do të jetë prej atyre që urinojnë në shtrat, ashtu siç urinon gomari kudo që vete."

“O Ali, mos kryej marrëdhënie natën e Kurban Bajramit sepse nëse ngjizet një fëmijë, ai do të dalë me katër ose gjashtë gishtërinj.”

“O Ali, mos kryej marrëdhënie nën një pemë të frytshme sepse nëse ngjizet një fëmijë në atë kohë, ai do të jetë xhelat, tiran, gjakpirës.”

“O Ali, mos kryej marrëdhënie nën dritën e diellit, por mbulohuni me diçka.”

“O Ali, mos kryej marrëdhënie ndërmjet ezanit dhe ikametit...”

“O Ali, mos kryej marrëdhënie veçse duke qenë me abdes.”

“O Ali mos kryej marrëdhënie në mes të muajit Shaban sepse nëse ngjizet një fëmijë, ai do të jetë i pafat dhe me shenjë në fytyrë.”

“O Ali, mos kryej marrëdhënie në tarracë ...”

“O Ali, mos kryej marrëdhënie në udhëtim mbi tre ditor ...”

“O Ali kushtoji rëndësi marrëdhënieve natën e të hënës sepse nëse ngjizet një fëmijë, ai do të jetë hafiz.”

“O Ali, nëse kryen marrëdhënie natën e martë dhe ngjizet një fëmijë, ai do të jetë shehid.”

“O Ali, nëse kryen marrëdhënie natën e të enjtes dhe do ngjizet një fëmijë, ai do të jetë sundimtar ose dijetar, nëse kryen marrëdhënie ditën e enjte në drekë dhe ngjizet një fëmijë, atij nuk do t'i afrohet shejtani derisa të plaket.”

“O Ali, nëse kryen marrëdhënie natën e Xhuma dhe ngjizet një fëmijë, ai do të jetë hatib (ligjërues), nëse kryen marrëdhënie pas ikindie fëmija do të jetë njeri i famshëm, dijetar i mirënjohur.”

“O Ali, mos bëj marrëdhënie në pjesën e parë të natës sepse nëse ngjizet një fëmijë, ai mund të dalë magjistar.”

“O Ali, merre parasysh këtë porosi, ashtu siç e kam ruajtur unë atë nga Xhibrili.” ¹²⁰

¹²⁰ Marrë nga libri *Fakihu men la jehdurul fakih* 3/358

El Kamij harroi të na thoshte në ç'rrethana marrëdhënieje mund të na lind një imam i "pagabueshëm"!!!

"Imami i kohës sonë" e praktikoi dhe mori në konsideratë këtë porosi, duke e përfshirë në një nga fetvatë e tij në mënyrë të përmbledhur: "Nuk pëlqehet kryerja e marrëdhënieve në këmbë, apo nën rrezet e diellit, apo nën pemën e frytshme..." etj.¹²¹ Pas gjithë këtyre porosive, ai për të shfaqur devotshmërinë dhe ndershmërinë (Zot, më fal!) shprehet se nuk është e pëlqyeshme që të flitet gjatë marrëdhënieve, përveçse të bësh dhikër. ¹²²

TË GJITHA MËKATET JANË TË FALURA!

Me gjithë sa thamë më sipër, mos u mërzisni sepse që të gjitha gjynahet mund të shlyhen lehtësisht, sado të mëdha apo të shumta që mund të jenë, megjithëse ata nuk bëjnë dallim mes gjynaheve të vogla dhe të mëdha. Pse habitesh, a nuk i do dhe beson tek "imamët"?! Vallë, a mjafton kjo për të shpëtuar nga dënimi i Allahut? Po, sipas atyre, sepse "imamët" ndërmjetësojnë për çdo njeri që i do ata, sado i keq të jetë, sado vepra të shëmtuara të ketë, kurrsesi nuk e lënë "imamët" atë që të hyjë në zjarr, nuk ka se si, përderisa ai beson tek ata, i do dhe pret ndihmë prej tyre!!! A nuk është imam Aliu, ai që i ndan banorët e zjarrit dhe të Xhenetit?! A nuk është imam Aliu, ai që iu shpërndan fletët e hyrjes çdokujt që hyn në Xhenet dhe përcakton se cili është kushti për të hyrë në të?! Aliu nuk do lerë asnjë nga "shijat" e tij, por do t'u japë këtë fletë-hyrje, do t'i shpëtojë ata, pavarësisht mëkateve që kanë mbi supet! Në këtë mënyrë, është shndërruar feja në një teori të zhveshur nga sjelljet praktike dhe morali fetar. Lexo këto transmetime të cilat gjenden në "burimet më të besueshme" dhe më pas medito mbi

¹²¹ *Tahrirul uestileh* 2/239 të el Khumejnit

¹²² *Tahrirul uestileh* 2/239 të el KHumejnit

aktualitetin dhe atë ndodh në të, duke qenë në përputhje me këto transmetime dhe që ecën sipas metodës së tyre!

Allahu i ka premtuar Profetit që të mos i lerë pa falur asnjë mëkat (të madh apo të vogël) pasuesve të Aliut, si dhe t'ua shndërrojë mëkatet në vepra të mira. ¹²³ Allahu ka turp të dënojë një popull që i beson imamit të drejtë të “pagabueshëm”, sado mëkate që të kenë. ¹²⁴ Mëkati i një shí'iti është më i mirë se vepra e mirë e të tjerëve (sunive). ¹²⁵

Ebu Abdullahu ka thënë: “Nëse një besimtar në një ditë - natë kryen 40 mëkate të mëdha dhe thotë: I kërkoj falje Allahut që nuk ka të adhuruar me të drejtë tjetër veç Tij, i Gjallë, i Përjetshëm, Shpikësi i qiejve dhe tokës, i Madhërishmi, i lutem të çojë salavate mbi Muhamedin dhe të më pranojë pendimin, veçse Allahu do ia falë mëkatet. Nuk ka hajr për dikë që kryen më shumë se 40 mëkate në një ditë - natë. ¹²⁶

Merre me mend! Një besimtar që bën 40 mëkate, jo të vogla, por të mëdha, në një ditë - natë, si p. sh: zina, homoseksualizëm, pirje alkooli, vjedhje, etj, nëse kjo është gjendja e besimtarëve, atëherë çfarë pritet nga kafirat?!!

Tregohet se një grua mëkatare që ndodhej pranë vendit ku vajtohej për Husejnin, shkoi aty të merrte zjarr nga zjarri i tyre, por e gjeti të fikur. Atëherë, ajo e ndezi me vështirësi, aq sa i digjnin sytë nga tymi. Për këtë vepër, iu falën gjynahet. ¹²⁷ Këtë histori të pavlerë e dëgjon të përmendet dhe transmetohet si argument nëpër kuvendet e njerëzve, apo nëpër ngushëllime. Një miku im më

¹²³ *Usulul Kafij* 1/444

¹²⁴ *Usulul Kafij* 1/376

¹²⁵ *Usulul Kafij* 2/464

¹²⁶ *Usulul Kafij* 2/438

¹²⁷ *Enuarul uilajeh* fq. 338 të el Kelbajikani

tregon: “Mora pjesë në një ngushëllim ditën e Ashurasë dhe dëgjo “hoxhën” që thoshte: “Një grua zinaqare doli nga shtëpia e saj për të kërkuar zjarr. Rugës kaloi pranë një tenxhereje me qull misri, të cilës i ishte fikur zjarri. Ajo i fryu thëngjinjve, derisa e ndezi përsëri zjarrin dhe mori atë që donte. Më pas, ajo sheh një ëndërr, ku dikush i thotë: “Allahu t’i ka falur të gjitha gjynahet e mëparshme sepse ndeze zjarrin!” “Hoxha” tha: “Ky është shpërblimi i atij që e ndez zjarrin, edhe pa e ditur se çfarë po ngroh me të, pra ç’mund të themi për shpërblimin e atij që e gatuan qullin e Ebu Abdullahut?! Atëherë filluan zërat të ulërinin: “Allahumme Sali ala Muhamed ue ali Muhamed...” Miku im i thotë “hoxhës”: “Zotëriu im, ndoshta ti nuk e di (ose edhe mund ta dish), se shumica dërrmuese e pjesëmarrësve në këto kuvende janë të zhytur në mëkatet e zinasë, alkoolit, etj., ndaj këto fjalë që ti thua, mund të shërbejnë si nxitje për ata që të vazhdojnë në mëkatet e tyre, përderisa çdo gjë mund t’u falet me kaq lehtësi, mjafton që të hedhin dru poshtë tenxheres me qull (d. m. th. nuk paska fare nevojë për diçka që quhet pendim)?! Atëherë, lind pyetja: Për kë është kërcënimi i ashpër në Kuran dhe Sunet në lidhje me zinanë, vrasjen, pirjen e alkoolit, përgojimin, gënjeshtren, etj.? Në atë moment, “hoxha” shtangu, ishte përballë diçkaje të habitshme dhe të papritur, i ndodhte për herë të parë që dikush nga xhemati të guxonte të shkelte kufijtë e prepotencës së tij, e zuri të papërgatitur, ndaj nuk dinte si të reagonte, iu mbyll goja si me vulë. Unë them (autori) se nëse në çdo mexhlis (kuvend) do të kishte nga një person të tillë, të lirë në mendime dhe me karakter të fortë, i cili rebelohet ndaj prangave të pasimit të verbër, nuk do të kishim këtë gjendje dhe këta pseudo-klerikë nuk do të guxonin të prishnin njerëzit, të vidhnin pasuritë e tyre dhe e gjithë kjo të ndodhë në emër të *ehlu bejtit*. Në këtë mënyrë, njerëzit do të arrinin të kuptonin dhe të qartësoheshin pak nga pak se këta pseudo-klerikë janë diçka, ndërsa *ehlu bejti* është

tërësisht diçka tjetër. Realiteti tregon se këtyre transmetimeve të trilluara ju ka dalë boja dhe kanë lënë pas fryte të hidhura.

Më besoni në këtë ngjarje që do t'ju tregoj, megjithëse është ngjarje e pështirë, e neveritshme dhe rrënjëthënëse, por është e vërtetë dhe i ka ndodhur një të afërmit tim. Do ta tregoj këtë ngjarje me shpresën se do të shkaktoj nxitje të karakterit dhe krenarisë tek njerëzit e ndershëm dhe fisnikë, shpresoj të tërheq vëmendjen e njerëzve xhelozë, në lidhje me humnerën e thellë, në të cilën kanë rënë shumë vetë që mashtrohen nga disa trillime e që i mvishen *ehlu bejtit*. Duhet të kemi parasysh faktin se kjo që unë do t'ju tregoj është vetëm një pikë në pellgun e kënetës, gjëra të cilat i dinë shumë vetë, por që nuk guxojnë t'i thonë ato për një mori arsyesh të ndryshme. Një i afërmi im më tregon se njëherë vizitoi një mikun e tij që punonte si mësues. Në formë respekti, ky “mikpritës”, “mësues edukator” i bëri mysafirit një ofertë rrënjëthënëse. Ai i thotë: “Kam një nxënës magjepsës dhe është shumë i bukur.... Hë, si thua..., nëse frenohesh se ke frikë nga gjynahu, mos u mërzit, e kemi banjon gati, laheshe dhe më pas shkojmë këtu afër tek “imami”, i bëjmë një vizitë ceremoniale dhe kështu mbaron çdo gjë.”

SHTHURJA NDODH SI PASOJË E PËRSHTATJES SË MJEDISIT

Për këtë gjë janë pjekur kushtet dhe është përshtatur mjedisi, duke i dhënë mundësi kultivimit të çdo lloj gjynahu dhe turpi, e duke u shthurur moralisht dhe ç'nderuar përfundimisht. Është një realitet i hidhur dhe i dhimbshëm. Ka ardhur koha që të pranojmë hidhësinë e tij dhe se ne për shumë kohë kemi gëlltitur hidhësirën nën etiketën e ëmbëlsirës dhe mjaltit. Hapi i parë që duhet të hidhet në rrugën e shërimit është që i sëmuri ta pranojë faktin që është i sëmurë. Pra, të ketë guximin dhe kurajon për të

pranuar, së pari në raport me veten dhe së dyti në raport me mjekun e tij besnik. Kjo duhet bërë sepse kokëfortësia nuk i jep gjë tjetër të sëmurit, përveçse shtim të sëmundjes dhe vazhdimësi të vuajtjeve.

PËRMBYLLJE DHE NJË PARIM SHI'IT!

Feja islame është fe që e lartëson njeriun dhe e largon nga papastërtitë dhe gjërat e ulëta, e shmang nga egoizmi dritëshkurtër, drejt bashkëpunimit frytëdhënës. Ndërsa kjo fe e (shijave) e transformuar në mënyrë të përçudnuar është tërësisht e kundërta, e ul njeriun në nivelet më të ulëta dhe e shthur atë, ndaj kurrsesi nuk mund të jetë kjo feja e shpallur nga Zoti i gjithësisë, apo rruga e ndjekur nga *ehlu bejti*. Ajo (e tyre) është një fe që bazohet në pasimin e veprave të dyshimta sipas rregullit të mëposhtëm:

Çdo argument, ajet ose transmetim që mund të kuptohet në më shumë se një alternativë, nëse ka të bëjë me pasurinë, apo marrëdhëniet intime, atëherë do të komentohet sipas alternativës më tolerante që lejon sa më shumë hapësira veprimi. Nëse argumenti ka të bëjë me adhurimet, atëherë do të komentohet sipas alternativës më të kufizuar e që i ngushton sa më shumë hapësirat, apo që i eliminon fare ato, edhe nëse ai lloj komentimi është ekstremisht i largët dhe as që të shkon në mendje një lidhje e tillë, ndërmjet argumentit dhe komentit.

Në përmbyllje themi se këto ishin fjalët e një këshilluesi që ndjen keqardhje dhe dhembshuri, të cilat unë i ofroj duke qenë i bindur plotësisht, me lejen e Allahut, se do gjejnë veshë dëgjues, zemra të gjalla dhe të vëmendshme në brezin e ri që ka filluar të zgjohet dhe të çelë sytë, duke kërkuar të prekë me dorë shenjat që e

orientojnë në rrugën e drejtë. Këtij brezi po i ndriçojnë (qoftë edhe nga larg) dritat e shpëtimit, në prag të një shprese lumturose.

SHTOJCË 1

SHPËTIMI I TË MBYTURIT DHE NDRIÇIMI I RRUGËS

**Pyetje dhe përgjigje nga shejhul Islam Ibn Tejmijeh, Allahu e
mëshiroftë, në lidhje me shijat**

Mbiodhi: Sherif bin Ali er Rraxhihi

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botërave. Paqja, lutjet dhe mëshira e Allahut qofshin mbi më të zgjedhurin e profetëve, Muhamedin (Sallahu alejhi ue selem!) mbi familjen dhe shokët e tij, e mbi çdokënd që ndjek rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit!

Prej mirësive të Allahut të Lartësuar ndaj këtij umeti është ekzistenca e dijetarëve, të cilët ngrihen dhe mbrojnë Islamin, përballen me armiqtë e Islamit dhe tërheqin vërejtjen kundër tyre, thërrasin për lidhje të fortë pas Librit të Allahut dhe pasimit të Sunetit të Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!).

Prej këtyre dijetarëve të mëdhenj dhe kolosëve të dijes ishte shejhul Islam Ebul Abas Ahmed bin AbdulHalim bin Tejmijeh (Allahu e mëshiroftë!), i cili luftoi në rrugë të Allahut, me forcën e argumentit dhe me shpatë. Librat dhe shkrimet madhështore të këtij dijetari patën një ndikim të madh dhe dobi të shumta, dhe me të vërtetë ishin udhëzim për atë që ishte në dyshime, shpëtim për të mbyturin, ndriçim i rrugës së vërtetë, pikë-referimi (orientimi) për çdo musliman të kapur pas Kuranit dhe Sunetit. Për këtë arsye, dijetarët e mëdhenj dhe nxënësit e dijes, i kushtuan vëmendje dhe i dhanë rëndësi këtyre librave, ashtu siç janë kujdesur për to sundimtarët (udhëheqësit) e këtij vendi (fjala këtu është për Arabinë Saudite, Allahu e ruajttë nga çdo e keqe dhe intrigë e armiqve!) sepse vetëm pas themelimit të shtetit të Arabisë Saudite e njohën dritën e diellit, u botuan dhe u shpërndanë librat e Shejhul

Islamit. Ashtu siç vlen të përmendet kujdesi i veçantë që i kushtoi këtyre librave dijetari dhe muftiu i asaj kohe në Arabinë Saudite, Muhamed bin Ibrahim Ali Shejhu, si dhe pas tij, dijetari dhe muftiu i kohës AbdulAziz bin Abdullah bin Bazi (Allahu i mëshiroftë!).

Duke dëshiruar që të jem pjesëmarrës në shpërblim, në përhapjen e dobisë dhe hajrit mes muslimanëve u mundova të mbledh disa përgjigje dhe fetva të këtij dijetari të madh (shejhul Islam Ibn Tejmijeh) rreth disa çështjeve të besimit. Kam sjellë tekstin e pyetjes dhe përgjigjes, pa bërë asnjë ndërhyrje në të.

Allahu e mëshiroftë dhe e faltë shejhul Islam Ibn Tejmijeh dhe e shpërbleftë me shpërblimin më të mirë! Allahu e shpërbleftë atë, i cili merr përsipër botimin dhe shpërndarjen e librave të tij, për hir të Allahut!

Pyetja 1: Cili është qëndrimi i *Ehlu Sunetit* në lidhje me sahabët?

Përgjigje: Prej bazave të besimit të *Ehlu Sunetit* uel xhemeah është pastërtia dhe çiltërsia e zemrave ndaj shokëve të Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) dhe ruajtja e gjuhës në lidhje me ta, ashtu siç e përmend Allahu i Lartësuar në suren Hashr, ajeti 10: **"Edhe ata që erdhën pas tyre thonë: Zoti ynë, na fal neve dhe vëllezërit tanë të cilët u pajisën para nesh me besim dhe mos lejo në zemrat tona asnjë grimcë urrejtje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë, me të vërtetë Ti je Dashamirës, Mëshirues."**

(Shpjegimi i Akides Uasitije, fq. 184)

Pyetja 2: Cili është qëndrimi i *Ehlu Sunetit* në lidhje me *Ehlu Bejtin* (familjen dhe pasardhësit e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!))?

Përgjigje: *Ehlu Suneti* e duan familjen dhe pasardhësit e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) ndjejnë dashuri për ta dhe kanë mbajnë parasysh porosinë e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!), ku thotë: "U përkujtoj me Allahun (u tërheq vëmendjen që të keni

kujdes) në lidhje me *Ehlu Bejtin* (familjen dhe pasardhësit e mi)". Gjithashtu, kur erdhi Abasi, xhaxhai Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) dhe u ankua tek ai se disa kurejshë nuk e respektonin fisin Beni Hashim, Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) i tha: "Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, nuk besojnë (nuk plotësohet besimi i tyre), derisa t'ju duan juve (*Ehlu Bejtin!*) për hir të Allahut dhe për shkak të afërsisë tuaj me mua." (*Shpjegimi i Akides Uasitije*, fq. 195)

Pyetja 3: Cili është qëndrimi i *Ehlu Sunetit* në lidhje me gratë e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!)?

Përgjigje: *Ehlu Suneh* i duan dhe i respektojnë gratë e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!), të cilat janë njëkohësisht nënat e besimtarëve. Ata besojnë se gratë e tij në dynja do të jenë dhe gratë e tij në Ahiret, në veçanti Hadixheja, e cila ishte e para që i besoi Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) e ndihmoi dhe përkrahu me gjithë çfarë zotëronte, ishte nëna e shumicës së fëmijëve të Profetit SalAllahu alejhi ue selem dhe gëzonte një pozitë të lartë tek ai. Si dhe Aishja, e sinqerta bija e të Sinqertit, për të cilën Profeti SalAllahu alejhi ue selem tha: "Mirësia e Aishes ndaj grave të tjera është si mirësia e theridit¹²⁸ ndaj ushqimeve të tjera." (*Shpjegimi i Akides Uasitije*, fq. 198)

Pyetja 4: Cili është qëndrimi i *Ehlu Sunetit* në lidhje me Rafidat (shijat) dhe Neuasibet?

Përgjigje: *Ehlu Suneh* është larg prej rrugës së shijave (rafidijve), të cilët i urrejnë dhe i shajnë sahabët, po ashtu është larg prej rrugës së grupit Neuasib, të cilët e ofendojnë *Ehlu Bejtin* dhe i lëndojnë pasuesit, qoftë me fjalë apo me vepra. (*Shpjegimi i Akides Uasitije*, fq. 201)

¹²⁸ Sh. p: Theridi është një lloj ushqimi i vecantë, i cili preferohej shumë nga arabët e asaj kohe.

Pyetja 5: Cili është qëndrimi i *Ehlu Sunetit* në lidhje me çfarë ka ndodhur mes sahabëve?

Përgjigje: *Ehlu Suneh* nuk flet rreth asaj që ka ndodhur mes sahabëve. Transmetimet dhe lajmet që transmetohen, në të cilat përmenden gabimet e sahabëve, një pjesë prej tyre janë gënjeshtër, në një pjesë tjetër ka shtesa ose mangësira, pjesës tjetër i është ndryshuar kuptimi i vërtetë. E vërteta në këtë mes është se të gjithë sahabët janë të justifikuar (nuk ka qortim për ta), ata u përpoqën të arsyetojnë drejtë dhe ia qëlluan të vërtetës, ose u përpoqën të arsyetojnë drejtë, por nu ia qëlluan të vërtetës.

Ehlu Suneh nuk është me parimin se çdo sahab është i ruajtur prej gabimeve, qofshin ato të mëdha apo të vogla. Pra, në përgjithësi themi se sahabët mund të kenë rënë në gabime, por ata kanë pasur mirësinë që ishin muslimanët e parë dhe kanë vepra të mira të shumta, të cilat i fshijnë gabimet që ata mund të kenë bërë, madje atyre ju është falur edhe ndonjë gabim që nuk u falet të tjerëve pas tyre, pasi sahabët kanë vepra të mira, të cilat nuk i kanë ata që vijnë pas tyre.

Nga Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) është saktësuar, se ai ka thënë për sahabët se janë brezi më i mirë, dhe se sadakaja me një sasi sa grushti e dhënë prej tyre është më e vlefshme sa mali i Uhudit me flori, nëse është dhënë nga dikush tjetër që vjen pas tyre. Veç kësaj, edhe sikur ndonjëri prej tyre të bënte ndonjë mëkat, pendohej menjëherë ose bënte aq vepra të mira sa ia shlyenin atë mëkat. Mëkatet u faleshin edhe për shkak ishin ndër muslimanët e parë ose nëpërmjet ndërmjetësimit të Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!), duke qenë se sahabët janë të parët që e meritojnë ndërmjetësimin e tij. Një arsye tjetër ishte edhe sprovimi i tyre në dynja me sprova që shlyenin gabimet.

Pra, duke qenë se kjo është gjendja e tyre kur me të vërtetë kanë bërë mëkat, çfarë mund të themi në ato raste, në të cilat ata ishin muxhtehida, ku në qoftë se ia qëllonin të vërtetës kishin dy shpërblime, ndërsa kur nuk ia qëllonin kishin vetëm një shpërblim dhe gabimi i tyre ishte i falur. Veç kësaj, duhet të kemi parasysh se

gabimet që kanë bërë disa prej sahabëve janë të pakta dhe të papërfillshme, në krahasim me mirësitë dhe veprat e tyre të mira, duke filluar që nga besimi tek Allahu, tek i Dërguari i Tij, hixhreti i tyre, lufta në rrugë të Allahut, ndihma që i dhanë Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!), dija e dobishme që morën, puna e tyre e mirë, etj.

Nëse hedhim vështrimin nga historia me mendje të kthjellët dhe dituri, si dhe duke pasur parasysh mirësitë që Allahu i Lartësuar ua dhuroi atyre, e kuptojmë dhe bindemi plotësisht se sahabët janë njerëzit më të mirë që kanë ekzistuar pas profetëve, as nuk ka pasur e as nuk do të ketë si ata. Ata janë ajka e përzgjedhur nga brezat e këtij umeti, umet i përzgjedhur mes popujve të tjerë dhe njëkohësisht umeti më i nderuar tek Allahu i Lartësuar.

(Shpjegimi i Akides Uasitije, fq. 201-202)

Pyetja 6: Cila është origjina e emërimit rafidij (shija)?

Përgjigje: Origjina e emërimit rafidij (shija) është pretendimi i paqenë se gjoja Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) ka cituar (përmendur) një tekst, i cili i jep Aliut (RadijAllahu anhu!) të drejtë në mënyrë të prerë dhe të padiskutueshme, se ai është prijës që nuk gabon dhe se kush e kundërshton atë bën kufr. Pretendohet se muhaxhirët dhe ensarët kanë rënë dakord për fshehjen e këtij teksti dhe e kanë mohuar prijësin e "pagabueshëm", kanë ndjekur epshet e tyre, kanë transformuar fenë, kanë ndryshuar Sheriatin, kanë bërë padrejtësi dhe i kanë kaluar kufijtë, madje shumica e tyre kanë bërë kufr, duke përjashtuar afërsisht dhjetë prej tyre. Gjithashtu thonë se Ebu Bekri dhe Umeri kanë qenë hipokritë, madje se kanë besuar, pastaj kanë mohuar. Shumica e rafidijve e bëjnë kafir atë që bie ndesh me fjalën e tyre, e quajnë veten besimtarë dhe kushdo që i kundërshton ata e quajnë kafir.

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 3, fq. 356)

Pyetja 7: Çfarë bëjnë Rafidat nëse u paraqiten dy fjalë të kundërta me njëra-tjetrën?

Përgjigje: Shejhul Islam ka thënë: "Kam parë një grup

dijetarësh të shijave, si për shembull, Ibn Aud el Halij, që thonë: “Nëse Imamijtë (shijat) bien në kundërshtim dhe ndahen me dy fjalë të kundërta, ku njëri nga këto fjalë dihet se kush e ka thënë, ndërsa fjalën tjetër nuk dihet se kush e ka thënë, atëherë është detyrë të ndiqet ajo fjalë, e cila nuk dihet se kush e ka thënë, me arsyetimin se imami i "pagabueshëm" i shumëpritur do të jetë prej këtij lloj grupi.

Siç shihet qartë, ky është kulmi i injorancës dhe i humbjes, pasi ata pretendojnë se ekziston imami i "pagabueshëm", i shumëpritur, pastaj nuk dihet a e ka thënë ose jo atë fjalë sepse askush nuk e ka transmetuar nga ai, pra si mund të pretendohet se kjo është fjala e tij?! E pse të mos jetë fjala tjetër ajo e imamit të shumëpritur, në një kohë që ky imam qëndroka i fshehur dhe i frikësuar nga zullumqarët, prandaj nuk paska mundësi ta shfaqë fjalën e tij, ashtu siç ata pretendojnë?!

Pra, origjina e fesë së rafidijve (shijave) është e ndërtuar mbi diçka që nuk ekziston dhe që është e panjohur për ta, por edhe sikur të ekzistonte imami i tyre i "pagabueshëm", ata nuk e dinë se ku është, e si rrjedhojë nuk mund t'i dinë urdhëresat dhe ndalesat e tij, ashtu siç i njohin urdhrat dhe ndalesat e prindërve të tyre. (*Minhaxhu Suneh*, vëllimi 1, fq. 89-90)

Pyetja 8: Cili është kuptimi dhe domethënia e teuhidit?

Përgjigje: Kuptimi i vërtetë dhe domethënia e saktë e teuhidit është: Ta adhurosh Allahun, Një të Vetëm, t'i drejtohesh vetëm Atij me lutje, t'ia kesh frikën vetëm Atij, t'i mbështetesh vetëm Atij, t'ia kushtosh fenë plotësisht Atij dhe askujt tjetër përveç Tij, të mos merren engjëjt dhe profetët për zota. Përderisa këto krijesa të nderuara, nuk lejohet të merren për zota, atëherë çfarë mund të themi për imamët, mbretërit, dijetarët, etj?!

(*Minhaxhu Suneh*, vëllimi 3, fq. 490)

Pyetja 9: Çfarë kanë shpikur bidatçinjtë në ditën e Ashurasë?

Përgjigje: Disa bidatçinj kanë shpikur në ditën e Ashurasë grumbullime, mërzi, pikëllim, vajtime, e gjëra të tjera të papara të cilat nuk i ka ligjëruar Allahu i Lartësuar, as Profeti SalAllahu alejhi ue selem, as ndonjëri prej selefëve e as ndonjë prej *ehlu bejtit*. Mirëpo kur Allahu i Lartësuar e nderoi nipin e Profetit SalAllahu alejhi ue selem, njërin prej zotërinjve të djelmoshave në xhenet së bashku me një pjesë të *ehlu bejtit*, të cilët u vranë nga duart e zullumqarëve gjynahqarë (Allahu i poshtëroftë), kjo vrasje ishte fatkeqësi për muslimanët. Mirëpo kjo fatkeqësi duhet të pritet ashtu siç priten fatkeqësitë dhe me thënien e përshtatshme në këto raste (Ina lilahi ue ina ilejhi raxhiun). Këtu morën shkak disa bidatçinj dhe shpikën në këtë ditë të kundërtën e asaj që Allahu i Lartësuar ka urdhëruar, duke shtuar shpifje, gënjeshtër, ofendime të sahabëve, e gjëra të tjera të cilat i urren Allahu i Lartësuar dhe Profeti SalAllahu alejhi ue selem.

Pra, shndërrimi i ditëve në të cilat kanë ndodhur fatkeqësi në ceremoni përkujtimore, kjo nuk është prej fesë Islame, është më afër injorancës, madje ata e kanë humbur mirësinë e agjërimit të kësaj dite. Gjithashtu kanë shpikur gjëra të mbështetura në hadithe të shpifura që nuk kanë bazë në fe, si psh: mirësia e larjes në këtë ditë, lyerja e syve, dhënia e dorës, etj si këto të cilat janë bidate dhe të urryera. Pra, e ligjëruar dhe e pëlqyeshme është vetëm agjërimi i kësaj dite.

(Iktidau siratal mustekim, vëllimi 2, fq. 624-627)

Pyetja 10: Mbi çfarë baze ngrihet shirku dhe bidati?

Përgjigje: Shirku dhe bidatet ngrihen në bazë të shpifjes dhe gënjeshtërës, prandaj sa më larg të jetë personi nga teuhidi dhe Suneti aq më shumë i afrohet shirkut, bidatit dhe shpifjes. Për shembull, rafidat (shijat) janë gënjeshtarët më të mëdhenj nga të gjithë bidatçinjtë që ekzistojnë, ata janë vepruesit më të mëdhenj të shirkut, shpifësit më të mëdhenj dhe nuk gjen ndokënd më larg

teuhidit se ata. Rafidat nuk falen në xhami (i lënë bosh ato), në të cilat përmendet emri i Allahut, i braktisin, nuk mbajnë hutbe dhe nuk falen me xhemat. Nga ana tjetër, ata përkujdesen për tyrbet që janë të ngritura mbi varre, të cilat Allahu i Lartësuar dhe Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) i ka ndaluar rreptësisht. Allahu i Lartësuar në Kuran urdhëron që të kujdesemi për xhamitë dhe jo për tyrbet e teqetë.

(Iktidau Siratil Mustekim, Vëllimi 2, fq. 759-760)

Pyetja 11: Cila është fjala juaj lidhur me dashurinë që pretendojnë rafidat për Aliun (RadijAllahu anhu!)?

Përgjigje: Ata duan diçka që nuk ekziston, duan imamin e "pagabueshëm", i cili është i vetmi imam (prijës) pas Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) dhe nuk ka tjetër përveç tij (sipas tyre). Ky imam beson se Ebu Bekri dhe Umeri janë zullumqarë që i kanë kaluar kufijtë ose janë kafira. Atyre do t'ju bëhet e qartë (shijave) Ditën e Gjykimit se Aliu (RadijAllahu anhu!) nuk ka qenë më i mirë se ata (Ebu Bekri dhe Umeri), madje gjëja që dëshiron më së shumti Aliu (RadijAllahu anhu!) është të jetë afër tyre. Aliu (RadijAllahu anhu!) e pranonte dhe ishte i bindur për mirësinë dhe udhëheqjen e tyre (Ebu Bekrit, Umerit, Uthmanit) dhe as ai e as ata nuk kanë qenë të pagabueshëm. Udhëheqja e tij (Aliut) nuk është caktuar me tekst nga Kurani dhe Suneti.

Pra, me këto arsyetime do t'ju bëhet e qartë shijave Ditën e Gjykimit se ata nuk e kanë dashur Aliun (RadijAllahu anhu!), madje përkundrazi, ata janë njerëzit që e kanë urryer atë sepse ata urrejnë çdo person që pajiset me këtë cilësi pranimi i mirësisë dhe halifatit të tre sahabëve (Ebu Bekrit, Umerit, Uthmanit) dhe dihet se Aliu (RadijAllahu anhu!) e pranonte dhe ishte i bindur për mirësinë dhe udhëheqjen e tyre. Pra, me këtë bëhet e qartë në mënyrë të prerë se rafidat (shijat) në të vërtetë janë urryes të Aliut (RadijAllahu anhu!).

(Minhaxhu Suneh, vëllimi 4, fq. 295-296)

Pyetja 12: Kush është i pari që formoi dhe shpiku rrugën e shijave dhe pse?

Përgjigje: Dijetarët kanë thënë se rafidat e kanë origjinën nga zendekaja (kufri dhe nifaku). I pari që e shpiku këtë rrugë ishte munafiku, zindiku Abdullah bin Sebe. Ky njeri ofendon besimtarët e parë dhe përpiket që të ulë vlerën e tyre, duke zhvlerësuar transmetimin e shpalljes nga ana e tyre, si dhe duke zhvlerësuar kuptimin dhe pasimin e kësaj shpalljeje nga ata. Pra, rafidat herë flasin për dijen e sahabëve, herë flasin për pasimin që ata i bënë shpalljes dhe të gjitha këto ia faturojnë *ehlu bejtit* dhe imamit të tyre të "pagabueshëm", i cili në të vërtetë, nuk ekziston fare.

(*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 4, fq. 102)

Pyetja 13: Cilës fe i përkiste Ibn Sebe?

Përgjigje: Ibn Sebe i përkiste fesë jehude (çifute).

(*Muhtesar Fetaua Ibn Tejmijeh*, fq. 156)

Pyetja 14: A konsiderohet sharja dhe ofendimi i sahabëve si sharje dhe ofendim i vetë Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!)?

Përgjigje: Sharja dhe ofendimi i brezit më të mirë, të cilët e shoqëruan Profetin (SalAllahu alejhi ue selem!) është sharje dhe ofendim i Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!), siç e thotë këtë imam Maliku dhe të tjerë dijetarë: "Ata që shajnë dhe ofendojnë Profetin (SalAllahu alejhi ue selem!), e bëjnë këtë që të thotë dikush: "Një person i keq që kishte shokë të këqinj sepse po të ishte vetë i mirë do t'i kishte edhe shokët të mirë." Gjithashtu, janë (sahabët) ata që e transmetuan Kuranin, Islamin, Sheriatin e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!), janë ata që transmetuan mirësitë që kishte Aliu (RadijAllahu anhu!) dhe të tjerët përveç tij, prandaj ofendimi dhe zhvlerësimi i tyre do të thotë të mos i besohet

asgjëje që ata kanë transmetuar nga kjo fe, duke zhvlerësuar kështu edhe mirësitë që janë transmetuar në lidhje me Aliun apo dikë tjetër veç tij.

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 4, fq. 429)

Pyetja 15: A konsiderohet ofendimi dhe zhvlerësimi i sahabëve si zhvlerësim i Kuranit dhe Sunetit?

Përgjigje: Kurani i Madhërueshëm i ka lavdëruar sahabët në shumë ajete, si p.sh: tek fjala e Allahut të Lartësuar: **"Allahu është i kënaqur ndaj atyre të cilët të parët e përqaftuan Islamin prej muhaxhirëve dhe ensarëve dhe prej atyre që i pasuan me të mirë, edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. . . "** (Teube 100) ose tek fjala e Tij si vijon: **"E ç'keni që nuk jepni për në rrugë të Allahut, kur dihet se Allahut i mbesin trashëgim qiejt dhe toka. Nuk janë të barabartë prej jush ata që dhanë nga pasuria e tyre dhe luftuan para çlirimit, sepse të tillët kanë vlerë më të madhe nga ata që dhanë dhe luftuan më pas. Por të gjithëve Allahu u premtoi të mirën "** (Hadid 10), ose përsëri tek fjala e Tij: **"Vërtet Allahu që i kënaqur me besimtarët kur ata nën hijen e pemës të zotoheshin ty dhe Ai e dinte se ç'kishin zemrat e tyre, andaj u dhuroi atyre qetësi dhe shumë shpejt i shpërbleu me fitore. "** (Fet'h 18). Po ashtu e gjejmë edhe si vijon: **"Muhamedi është i dërguar i Allahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve dhe të mëshirshëm ndërmjet vete, i sheh ata duke u përkulur në ruku e duke rënë në sexhde, kërkojnë me këtë prej Allahut mëshirën dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat, ndërsa shembulli i tyre në Inxhil përshkruhet si një farë (e mbjellë) e cila e lëshon filizin, pastaj e forcon atë dhe ai pastaj qëndron vetë në trungun e tij duke i**

mahnitur mbjellësit. Kjo që Ai t'i tërbojë mosbesimtarët me anë të tyre..." (Fet'h 29).

Në *Sahihu Muslim* është transmetuar nga Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!), i cili ka thënë: "Nuk hyn në zjarr askush prej atyre që ka dhënë besën poshtë pemës". Po ashtu, në dy *Sahihet* (nga Buhariu dhe Muslimi) nga Ebu Seidi (RadijAllahu anhu!) transmetohet se Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) ka thënë: "Mos i shani shokët e mi sepse pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, sikur ndonjëri prej jush të shpenzojë (të japë sadaka) sa mali i Uhudit me flori, nuk do ta arrijë vlerën e një grushti sadaka të dhënë prej tyre, madje as gjysmën e tij (grushtit)!" Gjithashtu, në *Sahih*, në më shumë se një transmetim se Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) ka thënë: "Brezi më i mirë (nga të gjithë brezat) është ai në të cilin unë u dërgova, pastaj ata që vijnë pas tyre." Këto hadithe janë të njohura dhe të përhapura, madje janë *muteuatir*, të cilat tregojnë për mirësinë e sahabëve, lavdërimin e tyre dhe përparësinë e brezit të tyre ndaj gjithë brezave të tjerë që vijnë pas tyre, për këtë arsye, ofendimi dhe zhvlerësimi i tyre është zhvlerësim i Kuranit dhe Sunetit.

(*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 4, fq. 430)

Pyetja 16: Çfarë këshille mund t'i jepni njeriut të mençur?

Përgjigje: Lërin ato që thuhën dhe transmetohen në lidhje me të kaluarën. Le të meditojë çdo njeri i mençur rreth trazirave që ndodhin në kohë e tij aktuale, rreth të këqijave dhe prishjes në Islam dhe do të gjejë se shumica e këtyre të këqijave vijnë nëpërmjet rafidijve (shijave. Janë ata (rafidijtë) njerëzit që më së shumti bëjnë fitne dhe sherr, në këtë drejtim ata kurrë nuk pushojnë dhe nuk lënë gjë pa bërë në përhapjen e fitneve, sherrit dhe prishjes mes umetit.

(*Minhaxhu Suneh*, vëllimi 6, fq. 372)

Pyetja 17: Nga e kanë origjinën rafidat (shijat)?

Përgjigje: Origjina e rafidijve janë munafikët dhe zindikët. I pari që e shpiku këtë grup ishte zindiku Ibn Sebe, duke bërë teprim dhe tejkalim në lidhje me Aliun (RadijAllahu anhu!), e duke pretenduar se Aliut i takonte udhëheqja dhe se ekziston një tekst bazë për këtë, po ashtu, duke pretenduar se Aliu (RadijAllahu anhu!) është i pagabueshëm. Pra, duke qenë se origjina dhe baza e rafidijve është nifaku, disa selefë kanë thënë: “Dashuria për Ebu Bekrin dhe Umerin është besim (iman), ndërsa urrejtja e tyre është hipokrizi, dashuria për fisin Beni Hashim është besim, ndërsa urrejtja ndaj tyre është hipokrizi.”

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 4, fq. 435)

Pyetja 18: A mund të na i përshkruani rafidat (shijat)?

Përgjigje: Ata janë prej grupeve më gënjeshtare dhe më injorante dhe që nëpërmjet tyre depërton tek muslimanët çdo zindik dhe murted (dezertor prej fesë së tij). Kështu, mes tyre gjen anëtarë të grupacioneve të ndryshme si Nusejrije, Ismailije, etj. Rafidat (shijat) i armiqësojnë dhe urrejnë njerëzit më të zgjedhur të këtij umeti (sahabët), ndërsa armiq të Allahut prej çifutëve, të krishterëve, mushrikëve i duan. Ata refuzojnë lajmet e sakta, të qarta, *muteuatire* (që do të thotë: të padiskutueshme në saktësinë e tyre) dhe pranojnë gënjeshttrat e trilluara që kotësia e tyre dihet. Ata janë ashtu siç ka thënë esh-Sha`bij (Allahu e mëshiroftë!): “Sikur të ishin kafshë që ecin në tokë do të ishin gomerë, ndërsa sikur të ishin prej shpendëve do të ishin korba, prandaj ata janë shpifësit më të mëdhenj dhe njerëzit më gënjeshtarë.”

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 4, fq. 471-472)

Pyetja 19: Rafidat (shijat) i madhërojnë varret dhe i braktisin xhamitë (i nxjerrin jashtë përdorimit, nuk falen në to), a mund të na sqaroni pak rreth kësaj teme?

Përgjigje: Kam parë një libër të madh të shkruar nga një prej imamëve (kokave) të rafidijve- Muhamed bin Nu`man, i ashtuquajtur i Mufijd, me titull *Haxhi tek vizita e tyrbeve*. Në këtë libër janë përmendur transmetime nga Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) dhe Ehlu Bejti (kuptohet, çdo gjë e shpikur) në lidhje me vizitën e këtyre tyrbeve dhe që Haxhi të kryhet tek këto varre. Në këtë libër janë përmendur gjëra që nuk janë thënë as për Haxhin në Shtëpinë e Shenjtë. Shumica e asaj që janë përmendur janë shpifje të qarta dhe gënjeshtra të hapta dhe kishte aq shumë shpifje dhe gënjeshtra sa që unë nuk kisha parë diçka të tillë as në librat e çifutëve e as në ato të të krishterëve. Në origjinë, kjo është diçka e shpikur nga munafikët dhe zindikët, në mënyrë që t'i largojnë njerëzit nga rruga e Allahut të Lartësuar, t'ua prishin njerëzve fenë Islame duke shpikur shirkun, i cili bie ndesh me ihlasin (sinqeritetin) e fesë vetëm për Allahun.

(*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 4, fq. 517)

Pyetja 20: Sa janë të vërteta fjalët që rafidat ia mveshin Xhafer bin Muhamedit?

Përgjigje: Kanë gënjyer dhe shpifur për të deri në atë masë sa nuk e kanë bërë me asnjë tjetër. Xhafer bin Muhamedi ka qenë i shquar për dijen e madhe që ka pasur, ai së bashku me babanë dhe gjyshin e tij (i biri i Husejnit, (RadijAllahu anhu!)) kanë qenë njerëzve të shquar në fe dhe dije. Në *Ehlu Bejt* nuk ka pasur ndonjë si ai, prandaj bidatçinjtë dhe zindikët ia mveshin atij shpifjet e tyre.

(*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 11, fq. 581)

Pyetja 21: Ç'mund të thuhet për përgënjeshttrimin e haditheve të *Ehlu Sunetit* nga ana e tyre?

Përgjigje: Origjina e bidateve të tyre është e ndërtuar mbi gënjeshtren ndaj Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) dhe përgënjeshttrimin e haditheve të sakta.
(*Mexhmual fetaua*, vëllimi 13, fq. 31)

Pyetja 22: Kur u shfaq për herë të parë emri "Rafida" (refuzues)?

Përgjigje: Ky emër, për herë të parë në Islam është shfaqur kur Zejd ibn Ali ibn Husejn doli dhe u pasua nga shijat, në kohën e halifatit të Hisham bin AbdulMelik në fillim të qindvjeçarit të dytë. U pyet Zejdi në lidhje me Ebu Bekrin dhe Umerin, ai shprehu dashuri ndaj tyre dhe bëri lutje që Allahu t'i mëshirojë, mirëpo këtë gjë nuk e pëlqyen dhe e refuzuan një pjesë e atyre që ishin me të. Atëherë Zejdi u tha atyre: "Më refuzuat, më refuzuat...", e që në atë kohë u quajtën Rafida (refuzues). Këta që u ndanë prej tij (rafidat) filluan të donin Ebu Xhafer Muhamed bin Aliun, ndërsa ata që ngelën me Zejdin (zejdiyet) e donin atë dhe prandaj e quajtën grupin e tyre me emrin e tij. Që në atë kohë shijat u ndanë në Zejdije dhe Rafida Imamije. (*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 13, fq. 35 - 36)

Pyetja 23: Çfarë mund të na thoni për teprimin, tejkalimin që bëjnë rafidat në lidhje me imamët e tyre të pretenduar?

Përgjigje: Shijat e kanë tepruar dhe tejkaluar në lidhje me imamët e tyre dhe i kanë bërë të "pagabueshëm", pretendojnë se ata dinë çdo gjë, e kanë detyrë të besojnë dhe bazohen tek këta imamë për çdo gjë me të cilën kanë ardhur profetët. Shijat nuk bazohen as në Kuran dhe as në Sunet, përkundrazi marrin për bazë vetëm fjalët e atij që e pretendojnë se është imam i "pagabueshëm". Si

përfundim, ka arritur puna që ata të marrin për imam dikë që nuk ekziston.

(*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 12, fq. 209)

Pyetja 24: Prej bazave të fesë së shijave është nifaku që ata e quajnë *et-tekije*..., çfarë është kjo?

Përgjigje: Rafidat janë më injorantët, më gënjeshtarët dhe njerëzit më të largët në njohjen e argumenteve të transmetuara, apo të logjikës së shëndoshë. Ata kanë bazë të fesë së tyre *tekijen* dhe gënjejnë për *Ehlu Bejtin*, aq sa vetëm Allahu mund t'i numërojë gënjeshttrat e tyre. Prej këtyre gënjeshtrave është thënia e tyre që e transmetojnë nga Xhafer Sadik sikur ai ka thënë: "*Tekija* është feja ime dhe e baballarëve të mi."

Et-Tekija është hipokrizi, shijat me *et-tekije* nënkuptojnë: Të thonë me gjuhët e tyre atë që nuk e ndjejnë në zemrat e tyre, e ky është realiteti i nifakut. Duke qenë se kjo është prej bazave të fesë së tyre, atëherë ata çdo gjë që e transmetojnë nga Aliu (RadijAllahu anhu!), apo *Ehlu Bejti* dhe që është në përputhje me fjalën e *Ehlu Sunetit* thonë: "E kemi thënë këtë *tekijen* (me hipokrizi).

(*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 13, fq. 263)

Pyetja 25: A pretendojnë shijat se kanë imam të "pagabueshëm"?

Përgjigje: Kush cakton një imam dhe e bën detyrë bindjen ndaj tij në mënyrë absolute, qoftë kjo me besim ose me vepra, ka humbur prej rrugës së drejtë, ashtu siç humbën prijësit e devijimit dhe të humbjes Rafidat Imamije, të cilët në çdo kohë e kanë nga një imam të "pagabueshëm" dhe e kanë detyrë bindjen ndaj tij. Duhet të qartësohet njëherë e mirë se nuk ka njeri të pagabueshëm, pas Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) dhe nuk është detyrë bindja ndaj dikujt në çdo gjë, pas Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!).

(*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 19, fq. 69)

Pyetja 26: Kush është i pari që ka shpikur hadithe, të cilat nxisin për adhurimin e varreve?

Përgjigje: Të parët që kanë shpikur hadithe për vlerën e udhëtimit për të vizituar tyrbet që janë të ndërtuara mbi varre janë bidatçinjtë e rafidijve dhe të tjerë si puna e tyre, të cilët i braktisin xhamitë (i nxjerrin ato jashtë funksionit) dhe i madhërojnë tyrbet e teqetë, në të cilat bëhet shirk, shpifje, bidate. Në këtë mënyrë shpikën kështu një fe, të cilën nuk e ka ligjëruar Allahu i Lartësuar. (*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 27, fq. 191)

Pyetja 27: Nga kush i transmetojnë rafidat hadithet e tyre?

Përgjigje: Rafidat transmetojnë hadithe, tregime, mendime dhe fjalë që nëse u kërkon origjinën e tyre, prej kujt janë thënë, do i gjesh se nuk kanë ku të besojnë dhe nuk përmendin asnjë transmetues të besueshëm, asnjë të dijshtëm. Veç kësaj, gjëja kryesore, tek e cila ata mbështeten është thënia e tyre: "për këtë kanë rënë dakord "grupi i vërtetë"" Me këtë fjalë, ata ju referohen vetes së tyre, duke pretenduar se vetëm ata janë besimtarë, ndërsa të tjerët veç tyre janë kafira dhe pretendojnë se janë në rrugën e vërtetë, duke qenë se mes tyre ndodhet imami i "pagabueshëm"! (*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 27, fq. 451)

Pyetja 28: Kush është ky i "pagabueshmi", të cilin rafidat e presin dhe e kanë detyrë bindjen ndaj tij?

Përgjigje: I "pagabueshmi" tek rafidat imamije ithneasherije është dikush që ashtu siç pretendojnë ata, ka hyrë në një shpellë pas vdekjes së babait të tij Hasen bin Ali el Askerij në vitin 260 Hixhri. Sipas tyre, ky imam i "pagabueshëm" qëndron i fshehur dhe askush nuk e di se ku është, prej tij nuk dihet asnjë gjurmë. Dijetarët që merren me zinxhirin e pasardhësve të *ehlu bejtit* thonë se Hasen bin Ali el Askerij, nuk ka lënë pas vetes as fëmijë e as pasardhës.

Pra, nuk ka dyshim tek të mençurit se ky besim i rafidijve, i bazuar në fjalë të tilla vjen prej mendjelehtësisë, mungesës së logjikës, prej koncepteve që mendja e shëndoshë nuk i pranon dhe kush beson diçka të tillë është prej mendjelehtëve, injorantëve dhe të humburve. Ata injorantë dhe të humbur pretendojnë se imami i tyre ka qenë në moshën dy-vjeçare ose tre-vjeçare ose pesë-vjeçare kur i ka vdekur babai. Është qartësuar me ajet Kuranor, me hadith të Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) dhe me unanimitetin e umetit se dikush që është në gjendje të tillë (pra, fëmijë i vogël) duhet të jetë patjetër nën kujdesin e dikujt tjetër që të kujdeset për atë (fëmijën) dhe pasurinë e tij. Pra, ka nevojë të ushqehet me qumësht, të merret nën kujdestari dhe t'ia ruajë dikush pasurinë. Para se të mbushë shtatë vjeç është fëmijë dhe nuk urdhërohet që të falet, ndërsa kur t'i mbushë dhjetë vjeç urdhërohet me namaz, e nëse nuk falet rrihet që të edukohet dhe të mësohet me faljen e namazit. Pra, a mund të jetë një njeri i tillë me këto cilësi imam i "pagabueshëm" që e di gjithë fenë dhe se nuk mund të hyjë në Xhenet askush veç atij që i beson këtij imami?! Në anën tjetër, le të përfytyrojmë për një çast se ai është imam i "pagabueshëm" dhe duhet që të gjithë njerëzit t'i binden, mirëpo që kjo të ndodhë, ky njeri duhet të jetë i pranishëm mes njerëzve që të këshillojë rreth urdhëresave të Allahut të Lartësuar dhe Profetit të Tij. Mirëpo, nëse njerëzit nuk e shohin këtë njeri dhe nuk e dëgjojnë fjalën e tij, si do ta mësojnë se çfarë ju ka urdhëruar, apo ndaluar Allahu! Pra, bindja e njerëzve ndaj diçkaje që nuk e kanë dëgjuar, apo njohur është diçka e pamundur.

Nëse ata thonë "ai nuk shfaqet dot sepse ka frikë nga armiqtë e tij", atëherë çfarë dobie ka besimi tek ky njeri që as nuk i mëson e as nuk i urdhëron?! Veç kësaj, si iu lejoka këtij imami, i cili e ka detyrë thirrjen, që të fshihet prej më shumë se 450 vjetësh?! Pse po fshihet ai për një kohë kaq të gjatë, kur asnjëri prej baballarëve të tij

nuk është fshehur asnjëherë, si p.sh: Aliu, Husejni, Haseni, Ali bin Husejni, Muhamed bin Ali, Xhafer bin Muhamedi, Musa bin Xhaferi, Ali bin Musa, Muhamed bin Ali, Ali bin Muhamedi dhe më së fundi Hasen bin Ali el Askerij?!

Pra, të gjithë këta që përmendëm kanë qenë të pranishëm, jetonin mes njerëzve, merrnin dije prej njëri - tjetrit, biografia e tyre dihet, lajmet rreth tyre janë të njohura, atëherë pse fshihet ky njeri për një kohë kaq të gjatë, duke qenë se është imami i umetit, udhëzuesi, thirrësi, i "pagabueshmi", të cilit duhet t'i besojnë të gjithë dhe kush nuk i beson atij është kafir, sipas tyre?! Nëse do të thonë se "ka frikë..." (!!!), ju përgjigjemi se po të ishte për frikë, të parët e tij kanë pasur më shumë të drejtë për frikë sepse disa prej tyre u burgosën, u vranë, etj., (për këtë janë dakord të gjithë dijetarët). Veç kësaj, frika ekziston nëse i lufton, apo i kundërshton, por nëse qëndron mes myslimanëve dhe i mëson ata, nuk ka arsye për të pasur frikë.

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 27, fq. 452-454)

Pyetja 29: Në qoftë se arrijnë të kenë pushtet dhe sundim çfarë bëjnë, si sillen?

Përgjigje: Nëse rafidat arrijnë të kenë pushtet dhe sundim, nuk duan t'ia dinë për asgjë. Për të ilustruar këtë shiko se çfarë bënë në kohën e sulltanit Hadabenda: Ata përhapën aq sherr të madh, saqë po të vazhdonte dhe të forcohej do të kishin shkatërruar dhe zhdukur të gjitha dispozitat e Islamit. Ata duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojët e tyre, ndërsa Allahu nuk do gjë tjetër veçse ta plotësojë dritën e Tij, megjithëse kafirat e urrejnë këtë gjë.

(Minhaxhu Suneh, vëllimi 6, fq. 375)

Pyetja 30: Rafidat në transmetimet e tyre kanë gënjeshtër të shumta, a mund të na e sqaroni pak?

Përgjigje: Ata transmetojnë histori, tregime dhe fjalë, e nëse ua kërkon atyre zinxhirin e transmetimit nuk do gjes asnjë të

besueshëm. Ata mjaftohen që ta ketë dëgjuar dikush nga kushdo qoftë ose që e ka lexuar në një libër të panjohur ose më e keqja nga këto, njerëzit që ata përmendin janë të njohur si gënjeshtarë dhe shpifës. Nëse ata transmetojnë diçka që nuk gjendet tek dijetarët e Sunetit, patjetër do ta transmetojnë nga një i huaj, i panjohur ose gënjeshtar.

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 27, fq. 455)

Pyetja 31: Çfarë besimi kanë rafidat në lidhje me muslimanët, si i konsiderojnë ata?

Përgjigje: Besimi dhe konsiderata e tyre është se Ebu Bekri, Umeri, Uthmani, pjesëmarrësit e Bedrit, pjesëmarrësit e besëlidhjes Riduan, shumica e muhaxhirëve, ensarëve dhe ata që i pasuan me të mirë, imamët muslimanë, dijetarët e katër medhhebeve, së bashku me dijetarët e tjerë, adhuresit e devotshëm, sundimtarët e muslimanëve, ushtarët e tyre, muslimanët në përgjithësi apo në veçanti (tek e tek), të gjithë këta që i përmendim janë kafira që kanë dezertuar (sipas rafidijve) dhe kufri i tyre është më i madh se kufri i çifutëve dhe të krishterëve sepse ata janë dezertorë (murteda) dhe dezertori është më i keq se ai, i cili është kafir që në origjinë. Ndaj, duke i nisur nga kjo arsyetim, rafidat i japin përparësi kafirave dhe tatarëve më shumë se besimtarëve dhe pasuesve të Kuranit.

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 28, fq. 400)

Pyetja 32: A mund ta shpjegoni pak më gjerësisht?

Përgjigje: Rafidat i konsiderojnë kafira Ebu Bekrin, Umerin, Uthmanin, shumicën e muhaxhirëve, ensarëve dhe ata që i pasuan me të mirë, ndaj të cilëve Allahu i Lartësuar është i kënaqur dhe ata janë të kënaqur me Të. Rafidat i bëjnë kafira shumicën e umetit, qofshin prej të parëve apo prej të mëpasmeve, po ashtu bëjnë kafir çdo njeri që beson se Ebu Bekri, Umeri, muhaxhirët dhe ensarët janë të drejtë dhe të ndershëm ose thotë për ta RadijAllahu anhum! (Allahu qoftë i kënaqur me ta, ashtu siç është në të vërtetë!) ose bën

istigfar për ta (që në të vërtetë, Allahu na ka urdhëruar të lutemi për ta me istigfar).

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 28, fq. 477)

Pyetja 33: Çfarë mendimi kanë rafidat për gratë e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!)?

Përgjigje: Shumica e dijetarëve të tyre thonë se Ebu Bekri, Umeri, shumica e muhaxhirëve dhe ensarëve, gratë e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!), si p.sh: Aisheja, Hafsa, po ashtu edhe dijetarët e myslimanëve (së bashku me muslimanët në përgjithësi) janë kafira që nuk i kanë besuar kurrë Allahut!

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 28, fq. 451)

Pyetja 34: Çfarë mendimi kanë disa prej rafidijve në lidhje me Profetin (SalAllahu alejhi ue selem!)?

Përgjigje: Ka prej rafidijve që thonë se Profeti (Salallahu alejhi ue selem!), ka kryer marrëdhënie me Aishen dhe Hafsën duhet të digjet patjetër që të pastrohet, sepse ka kryer marrëdhënie me jobesimtare (sipas pretendimit të tyre) dhe të bësh marrëdhënie me jobesimtarët është e ndaluar. *(Mexhmual Fetaua, vëllimi 28, 481)*

Pyetja 35: Ç'mund të na thoni për gënjeshtat e e rafidijve në lidhje me brezat më të mirë?

Përgjigje: Ajo që kemi parë në librat e tyre është shpifja dhe gënjeshtra në lidhje me Profetin (SalAllahu alejhi ue selem!), me shokët e tij, me të afërmit e tij. Gënjeshttrat e tyre janë më të shumta se gënjeshttrat që kemi parë tek librat e *Ehli Kitabit*.

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 28, fq. 482)

Pyetja 36: Dikush që ka marrë përgjigje prej jush thotë se rafidat besojnë në çdo gjë, me të cilën ka ardhur Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!)... Cili është mendimi juaj?

Përgjigje: Për sa i përket asaj që ka përmendur ai njeri se, shijat (rafidat) besojnë në çdo gjë, për të cilën është dërguar Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!), kjo është gënjeshtër, madje përkundrazi, ata kanë mohuar aq shumë gjëra për të cilat është dërguar Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!), sa vetëm Allahu i di dhe i ka numëruar. Nganjëherë, ata përgënjeshtrojnë tekstet e sakta të transmetuara nga Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!), nganjëherë përgënjeshtrojnë kuptimet e ajeteve Kuranore. Këto dhe shumë çështje të tjera që nuk i përmendëm janë turpe dhe poshtërsi, të cilat shihen qartë nga çdokush se janë në kundërshtim me atë që erdhi Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!).

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 28, fq. 484)

Pyetja 37: Çfarë qëndrimi mbajnë rafidat në lidhje me udhëheqësit (prijësat) muslimanë?

Përgjigje: Rafidat besojnë se nuk duhet t'i binden asnjë lloj udhëheqësi (prijësi) musliman, përveç atij që nuk ekziston (imamit të tyre të "pagabueshëm").

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 28, fq. 487 - 488)

Pyetja 38: A ka në zemrat e rafidijve dashuri për muslimanët?

Përgjigje: Rafidat kanë në zemrat e tyre inat dhe vrazhdësi për të mëdhenjtë e muslimanëve dhe për të vegjlit e tyre, për muslimanët e mirë dhe për të këqijtë e tyre, gjë e cila nuk gjendet në zemrën e askujt tjetër, siç gjendet tek ata. *(Mexhmual fetaua, vëllimi 28, fq. 488)*

Pyetja 39: Cili është adhurimi më i madh sipas besimit të rafidijve?

Përgjigje: Adhurimi më i madh tek ta është mallkimi i muslimanëve dhe i të dashurve të Allahut, qofshin këta prej të parëve apo prej atyre që pasuan.

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 28, fq. 488)

Pyetja 40: Cila është baza më e madhe dhe më themelorja, mbi të cilën ata e ndërtojnë fenë e tyre?

Përgjigje: Baza tek ata është t'i bëjnë kafira muslimanët, mallkimi dhe sharja e tyre, duke filluar që nga prijësit (udhëheqësit) më të mirë, të cilët janë halifet e drejtë, pas tyre dijetarët e muslimanëve dhe të gjithë me radhë. Rafidat e bëjnë këtë sepse sipas tyre, kush nuk i beson imamet të tyre të "pagabueshëm" nuk i ka besuar Allahut dhe as Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!). Në të vërtetë, ky imam i "pagabueshëm" nuk ekziston.

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 28, fq. 488)

Pyetja 41: Çfarë mund t'u thoni muslimanëve në lidhje me rafidat?

Përgjigje: Këto grupe janë kundërshtarë dhe luftues të Islamit, si p.sh., rafidat dhe të tjerë si puna e tyre. Rafidat janë më të këqij se havarixhët, për të cilët Profeti (SalAllahualejhi ue selem!) ka thënë që të vriten dhe i ka nxitur besimtarët për këtë. Ky është një fakt, për të cilin dijetarët e Islamit kanë rënë dakord dhe që e kanë kuptuar realitetin e kësaj çështjeje.

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 28, fq. 494)

Pyetja 42: A konsiderohen rafidat prej havarixhëve?

Përgjigje: Është transmetuar në dy Sahihet (e Buhariut dhe Muslimit) nga Ebu Seidi (RadijAllahu anhu!) se Profeti (SalAllahu

alejhi ue selem!), ka thënë: "Ata i vrasin muslimanët dhe i lënë të ikin idhujtarët. Nëse i arrij, do t'i luftoj (do t'i vras) ata, ashtu siç u vranë populli Ad". Kjo cilësi i takon të gjithë havarixhëve si p.sh., rafidat e të tjerë si puna e tyre. Ata e bëjnë të lejuar gjakun e muslimanëve sepse i konsiderojnë dezertorë (murteda), e bëjnë të lejuar gjakun e tyre më shumë sesa gjakun e kafirave, të cilët nuk janë dezertorë, sepse dezertori është më i keq se të tjerët.
(*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 28, fq 497)

Pyetja 43: Cilat janë llojet e rafidijve?

Përgjigje: Tek rafidat janë futur zindikët, ateistët, ku prej tyre përmendim Nusejrijet, Ismailijet, Keramijet, e të tjerë të ngjashëm si këta.

(*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 28, fq. 528)

Pyetja 44: Çfarë mund të na thoni për gënjeshttrat e rafidijve?

Përgjigje: Ata kanë gënjeshttra, bidate dhe shpifje ndaj Allahut dhe Profetit SalAllahu alejhi ue selem, më shumë sesa kanë havarixhët e dalë nga feja, të cilët i luftoi emiri i besimtarëve, Aliu (RadijAllahu anhu!) së bashku me sahanët, duke zbatuar kështu, urdhrin e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!).

(*Mexhmual Fetaua*, vëllimi 28, fq. 528)

Pyetja 45: Çfarë dënimi meriton dikush që mallkon ndonjë sahab?

Përgjigje: Kush mallkon një prej shokëve të Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!), si Muauijen, Amru bin Asin, apo ndonjë që është më i mirë se ata, të tillë si, Ebu Musa el Esharij, Ebu Hurejran, apo akoma më të mirë se ata si Talhan, Zubejrin, Uthmanin, Aliun, Ebu Bekrin, Umerin, Aishen, meriton dënim të

madh, ashtu siç kanë rënë dakord për këtë të gjithë muslimanët. Kanë rënë në ihtilaf (kundërshtim) me njëri-tjetrin për dënimin që duhet t'i japin, a duhet të dënohet me vdekje apo jo?

(Muhtesar Fetaua Ibn Tejmijeh, fq. 478 - 479)

Pyetja 46: Çfarë mund të na thoni për gënjeshttrat që ia ngarkojnë Aliut (RadijAllahu anhu!)?

Përgjigje: Kanë gënjyer për Ali ibn Ebi Talibin duke përdorur nga të gjitha llojet e gënjeshtrave, të cilat nuk lejohen t'i ngarkohen (t'i hidhen) as muslimanit më të dobët (e jo më emirit të besimtarëve, Aliut (RadijAllahu anhu!)). Puna ka shkuar deri aty, sa që ia kanë ngarkuar atij origjinën e disa sekteve, të tilla si: Keramijve, Batinijve, Heramijve, Mezdekijve, Ismailijve, Nusejrijve, me pak fjalë, sektet më të prishura që ekzistojnë në botë.

(Mexhmual Fetaua, vëllimi 35, fq. 186)

Si përfundim, kjo ishte vepra që Allahu na e lehtësoi ta kryenim. E lusim Atë që të jetë e dobishme për njohjen e të vërtetës dhe ndjekjen e saj! Allahu e shpërbleftë atë besimtar që jep mundin e tij për përhapjen e kësaj broshure me botim, fotokopjim, apo qoftë edhe me shpërndarje dorazi.

Lutja jonë e fundit është Elhamdulilahi Rabil alemin!

Përgatiti dhe mblodhi: Sherif bin Alij er-Raxhihi

Përktheu dhe përshtati: Shuajb Rexha Ebu Duxhanah

Literatura:

1) IKTIDAU SIRATIL MUSTEKIM LI MUHALEFETI AS'HABIL XHEHIM –

Autor: *shejhul islam Ahmed ibn AbdulHalim Ibn Tejmije Botimi i dytë, 1411 hixhri, Mektebetu Rushd.*

2) EL AKIDETUL UASITJE –

Autor: *shejhul Islam Ibn Tejmije, me shpjegimin e shejh Salih*

el Feuzan. Botimi i pestë, 1410 hixhri, Mektebetul Mearif.

3) MEXHMUAL FETAUA - Autor: *shejhul islam Ibn Tejmije*

4) MINHAXHU SUNEH - Autor: *shejhul Islam Ibn Tejmije.*

Botimi i parë, 1406 Hixhri.

5) MUHTESAR FETAUA IBN TEJMIJEH –

Autor: *Muhammed el Balij. Darul Kutub el Ilmijeh. Botimi i parë
me urdhër të mbretit AbdulAziz, 1386 Hixhri.*

SHTOJCË 2

**HYTBEJA E SHEJKH ALIJ BIN
ABDURRAHMAN EL HUDHEJFIJ PËR
SHIJAT, NË PRANI TË EKBER HASHIM
RAFSANXHANIT (PRESIDENT I IRANIT NË
ATË KOHË)**

PARATHËNIE

Qysh me arrdhjen në pushtet të Homejnit në vitin 1979, asnjë zyrtar i lartë nuk e ka vizituar Arabinë Saudite, përveç Rafsanxhanit, në një përpjekje për të përmirësuar marrëdhëniet dypalëshe, ndërmjet dy vendeve. Presidenti i atëhershëm iranien mbërriti në Rijad, në fillim të muajit DhulKadeh të vitit 1418 H, i shoqëruar nga një delegacion i madh dhe nga familja e tij. Ai kreu një turne në shumë nga qytetet e Arabisë Saudite dhe kreu ritet e Umres, bashkë me delegacionin shoqërues.

Kur mori pjesë në namazin e Xhumasë në xhaminë e Profetit, imami i saj foli rreptë kundër shijave. Nisur nga ky fakt, Rafsanxhani tentoi të braktiste xhumanë, por disa nga shoqëruesit e tij e këshilluan që të mos e bënte diçka të tillë. Ai nuk pranoi të falej pas imamit el Hudhejfi dhe u fal më vete me shoqëruesit e tij.

TEKSTI I HYTBES

Lavdërimet dhe falënderimet i përkasin vetëm Allahut! Kini frikë Allahun, o ju muslimanë, me një devotshmëri të vërtetë dhe

kapuni fort pas islamit! O robër të Allahut, mirësia më e madhe që Allahu i jep njeriut është feja e vërtetë, me të cilën Allahu e ngjall njeriun nga vdekja e kufrit, e bën të shohë dhe të ndriçohet pas verbërisë së humbjes. Allahu thotë: “A mund të jetë i njëjtë ai njeri, i cili ishte i vdekur dhe Ne e ngjallëm, duke i dhënë atij dritë me të cilën ecën ndërmjet njerëzve, si ai që është i zhytur në errësira, prej të cilave nuk del dot?” Feja e Allahut në qiell dhe në tokë, për të hershmit dhe për të mëvonshmit, ka qenë dhe është Islami, pavarësisht se Sheriati është i ndryshëm për çdo profet sepse Sheriati i çdo profeti është ai, me të cilin Allahu e disiplinonte dhe përmirësonte atë umet dhe është e drejtë e Allahut që të anullojë, apo të lërë në fuqi, sipas diturisë dhe urtësisë së Tij. Me dërgimin e udhëheqësit të njerëzisë, Muhamedit (SalAllahu alejhi ue selem!), Allahu anulloi çdo Sheriat, duke ia bërë obligim xhindëve dhe njerëzve besimin dhe zbatimin e tij. Allahu ka thënë: **“Thuaj: O ju njerëz! Unë jam i dërguar i Allahut tek të gjithë ju, Ai i cili ka pushtetin e qiejve të tokës dhe tokës, nuk ka të adhuruar me të drejtë përvec Tij, i Cili jep jetë dhe vdekje. Ndaj besojini Allahut dhe të Dërguarit të Tij, profetit analfabet i cili i beson Allahut dhe fjalëve të Tij. Pasojeni atë që të jeni të udhëzuar drejtë”**

Në hadithin e saktë, Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) ka thënë: “Pasha Atë që ka në dorë shpirtin tim, çdokush që dëgjon për mua (qoftë ai çifut apo i krishterë) e më pas nuk më beson, do hyjë në zjarr!” Ndaj kush nuk i beson Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) është i dënuar me zjarr dhe Allahu nuk do të pranojë nga askush ndonjë fe tjetër, siç thotë në ajetin Kuranor: **“Feja e pranuar tek Allahu është Islami”** dhe: **“Kush kërkon fe tjetër përvec islamit, atij nuk do t'i pranohet dhe në botën tjetër do të jetë nga të dështuarit!”** Allahu e ka dërguar profetin Muhamed me Sheriatin më të mirë dhe fenë më të përsosur, në të cilin përmbloodhi çdo parim më të rëndësishëm që ishte zbritur nga profetët e

mëparshëm: “Allahu për zgjedh kë të dojë dhe udhëzon drejt Tij atë që është i përlulur!”

Rabinët e çifutëve dhe priftërinjtë e të krishterëve e dinë se feja që Muhamedi (SalAllahu alejhi ue selem!) është e vërtetë, por ajo që i pengoi ta pasonin ishte zilia, mendjemadhësia, lakmia për interesat e dynjasë, e cila i bëri ata që edhe më herët të deformonin fenë e tyre, duke qenë në kufr dhe në humbje. E gjithë kjo nuk do t’ju vlejë aspak atyre. Pas këtij parashtrimi të përmbledhur të së vërtetës dhe të së kotës, shprehim pakënaqësinë tonë si muslimanë, në lidhje me thirrjet që bëhen nga njëra anë për të përafruar ndërmjet feve, si dhe për përafrim ndërmjet *ehlu Sunetit* dhe shijave, nga ana tjetër. Kjo thirrje që përfaqësohet nga disa intelektualë, të cilëve u mungojnë parimet më bazë dhe elementare të besimit. Thirrje që bëhet akoma edhe më e rrezikshme në këtë kohë, në të cilën po zhvillohen konflikte fetare dhe përfitime interesash në llogari të fesë.

Islami i thërret çifutët dhe të krishterët që të shpëtojnë vete e tyre nga zjarri dhe të meritojnë Xhenetin, duke hyrë në fenë islame, duke braktisur të kotën, siç thotë Allahu: “O ju pasues të librave të mëparshëm, mbështetuni tek një fjalë e përbashkët ndërmjet nesh dhe jush “Të mos adhurojmë dikë tjetër përveç Allahut dhe të mos i bëjmë shok Atij asgjë, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin në vend të Allahut. Nëse ata refuzojnë, atëherë thuaju atyre: “Dëshmoni për ne, se jemi muslimanë.” Islami pranon ekzistencën e çifutëve dhe të krishterëve, duke ruajtur fenë e tyre, por nën sundimin Islam, duke iu përmbajtur dispozitave të shtetit Islam në aspektin ekonomik dhe të rendit e sigurisë, në këtë mënyrë, atyre nuk u imponohet islamizimi sepse Allahu thotë: **“Nuk ka imponim në fe është sqaruar e vërteta nga e kota”**. Në të njëjtën kohë, Islami u bën me dije atyre se feja që ata pretendojnë është e gabuar dhe kjo është pjesë e këshillës, kundrejt njerëzve, në

mënyrë që të besojë ai që dëshiron të besojë dhe të mohojë ai që mohon. Nëse çifutët, të krishterët dhe idhujtarët do të pranonin Islam, ata do të gjenin në të hapësirën e nevojshme, duke qenë vëllezër në fe të barabartë sepse në islam nuk ekziston racizëm dhe fanatizëm me ndonjë ngjyrim të caktuar. Allahu thotë: **“O ju njerëz! Ne u kemi krijuar nga një mashkull dhe një femër dhe ju kemi bërë të ndaheni në popuj dhe fise që të njiheni mes jush. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai, i cili është më i devotshëm.”** Historia e Islamit dëshmon për këtë që thamë.

Nga ana tjetër, që të mund të pretendojmë që të përafrojmë Islam, me hebraizmin ose krishterimin, kjo është diçka e pamundur për të ndodhur. Allahu thotë: **“Nuk mund të jetë i barabartë i verbëri me atë që shikon, e as nuk është e barabartë errësira me dritën, as hija me vapën. Nuk janë të barabartë të gjallët dhe të vdekurit. Allahu e bën të dëgjojë atë që do, ndërsa ti nuk mund t'i bësh të vdekurit që të dëgjojnë.”** Ndërsa, sikur të përafrohet muslimani me çifutin apo të krishterin, me kuptimin që ai të heqë dorë nga disa nga dispozitat të fesë së tij dhe ta lakojë fenë ose disa nga dispozitat fetare sipas tekave të tyre, t'u shprehë atyre dashuri, kjo nuk mund të ndodhë kurrësesi nga muslimani i vërtetë! Pavarësisht se muslimani e ka të ndaluar që t'u bëjë atyre padrejtësi, përkundrazi e ka detyrë që të jetë i drejtë, ashtu siç është i urdhëruar që ta mbrojë të vërtetën, ta përkrahë, ta armiqësojë, ta thyjë të kotën. Thirrjet për përafrim mes feve janë vepra që bien ndesh me islam, dhe shkaktojnë çrregullim dhe sprovë të madhe, duke sjellë si pasojë përzierjen e besimit islam, dobësimin e imanit, miqësimin me kafirat (armiqtë e Allahut), ndërkohë që Allahu i ka urdhëruar besimtarët të jenë miq të njëri - tjetrit: **“Besimtarët dhe besimtare janë miq të njëri - tjetrit.”** Allahu na ka treguar se kafirat janë miq të njëri - tjetrit: **“O ju, të**

cilët keni besuar mos i zini miq çifutët dhe të krishterët, ata janë miq të njëri - tjetrit.”

Si mund të ketë përafrim ndërmjet Islamit dhe hebraizmit: nga njëra anë, Islami me cilësitë e tij, me dritën dhe shkëlqimin e tij, me drejtësinë, tolerancën, gjithëpërfshirjen për njerëzit dhe xhindët, moralin e lartë, ndërsa nga ana tjetër, hebraizmi racist, i ngurtë, urryes i njerëzimit, me moral të ulët, me errësira që e rrethojnë nga të gjitha anët, me shije të hidhur. Si mund të pranojë muslimani që të akuzohet për imoralitet e ndershmja adhuresse Merjeme, ashtu siç e akuzojnë çifutët?! Si mund të pranojë muslimani që çifutët ta akuzojnë Mesihun, Isain, birin e Merjemes, si kopil?!

Si mund të kemi përafrim ndërmjet Kuranit dhe Talmudit të shejtanit?! Si mund të kemi përafrim ndërmjet Islamit dhe krishterimit?! Islami, feja e njëshmërisë së pastër, legjislacionit të përsosur, mëshirës dhe drejtësisë, ndërsa krishterimi, i cili thotë se Isai është biri i Allahut, apo vetë Allahu ose i treti i të treve: Ati, biri dhe shpirti i shenjtë?! Si mund ta pranojë logjika se Zoti përmbledhet në një mitër?! A mund ta pranojë logjika se Zoti ha, pi, udhëton me gomar, fle, urinon?! Si mund të kemi përafrim ndërmjet krishterimit të humbur, i cili ka këtë lloj besimi në lidhje me Isain (Alejhi selam!) dhe ndërmjet Islamit, i cili i jep Isait meritën dhe konsideratën që i takon, duke e cilësuar rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij, madje nga më të përzgjedhurit e të dërguarve.

Në të njëjtën kohë, si mund të kemi përafrim ndërmjet Sunive dhe shijave?! *Ehlu Suneti*, të cilët e bartin me fisnikëri Kuranin dhe Sunetin e Profetit që Allahu i ka bërë sebeb për ruajtjen e fesë, që kanë luftuar për lartësimin e Islamit dhe kanë shkruar historinë e lavdishme të tij, me shijat rafidij që mallkojnë sahabët dhe shembin Islamin sepse sahabët janë ata që na e kanë përcjellë fenë me besnikëri, ndaj ofendimi i tyre është shkatërrim

për fenë. Si mund të kemi përafrim ndërmjet Sunive dhe shijave, përderisa këta të fundit ofendojnë tre halifët e drejtë?! Sikur ata të logjiknin, do ta kuptonin se kjo që bëjnë është ofendim për Profetin (SalAllahu alejhi ue selem!) sepse Ebu Bekri dhe Umeri kanë lidhje martesore me Profetin (SalAllahu alejhi ue selem!) dhe ishin dy përkrahësit e tij gjatë gjithë jetës, si dhe bashkëshoqëruesit e tij në varr (E kush mund të arrijë në këtë pozitë!). Ata luftuan përkrah (Profetit SalAllahu alejhi ue selem!) në të gjitha luftërat, e gjithë kjo mjafton për të hedhur poshtë medhhebin e rafidive.

Uthmani (RadijAllahu anhu!) u martua me dy nga vajzat e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) dhe Allahu nuk mund të zgjedhë për Profetin e Tij veçse shokët më të mirë?! Nëse akuzat e tyre do të qëndronin, si mund ta fshehte Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) armiqësinë e këtyre treve ndaj Islamit dhe të mos ua tërhiqte vërejtjen njerëzve?!

Ofendimi i atyre treve, në të vërtetë është ofendim edhe për Aliun (RadijAllahu anhu!) sepse ai i dha besën në xhami për halife, me vendim unanim; ai i dha vajzën e tij Umu Kulthumin, Umerit (RadijAllahu anhu!) për grua, i dha besën Uthmanit si halife, vendim unanim dhe vullnet të lirë, madje ishte përkrahës i singertë i tyre, dashamirës dhe këshillues besnik i tyre.

Pra, a mund të pranohet që Aliu (RadijAllahu anhu!) të lidhë krushqi me një kafir, apo t'i japë besën një kafiri?! I lartësuar je o Allah! Këto janë shpifje të qarta.

Mallkimi që ata i bëjnë Muauijes (RadijAllahu anhu!) është ofendim për Hasenin (RadijAllahu anhu!), i cili u dorëhoq nga halifati, për hir të Allahut dhe për t'ia lënë atë Muauijes (RadijAllahu anhu!), veprim që konkludoi i suksesshëm sepse ndoqi porosinë e Profetit (Salallahu alejhi ue selem!). Pra, a mund të pranohet që nipi i Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) të dorëhiqet për t'i lënë vendin një kafiri që të sundojë muslimanët?! Si mund të mallkojnë

Aishen (RadijAllahu anha!), nënën e besimtarëve, të cilën Allahu e ka emërtuar si të tillë në Kuran në ajetin: “Profeti është shumë i mëshirshëm me besimtarët, më shumë se ata me veten e tyre, ndërsa bashkëshortet e tij konsiderohen nëna për besimtarët.”

Si mund të kemi përafrim ndërmjet Sunive dhe shijave, përderisa ata e konsiderojnë të pagabueshëm Homeinin, prijësin e humbjes, të cilin ata e konsiderojnë si zëvendës Mehdiun e trillimeve të tyre. Ai është fshehur në një shpellë në Samurra dhe zëvendësi i tij ka të gjithë autoritetin, ashtu sikurse vetë ai, përderisa Mehdiu i tyre është i pagabueshëm dhe zëvendësi i i tij, Homeini është i pagabueshëm. Rafidijtë me idenë e tyre të protektariatit të fakihut, e kanë shembur medhhebin e tyre, duke qenë traditë e së kotës që të rrënojnë veten dhe të ketë kontradikta. *Ehlu bejti* i vërtetë është i pastër nga këto pretendime. Argumentet që hedhin poshtë medhhebin e tyre janë të shumta, si nga ana fetare, ashtu edhe nga ajo logjike. U bëjmë thirrje që të hyjnë në Islam, ndërsa ne *ehlu suneti* nuk do të afrohem aspak me ta, as sa një qime, përderisa ata janë më të dëmshëm për Islamin se vetë çifutët dhe të krishterët dhe nuk u zihet kurrë besë. Muslimanët duhet të qëndrojnë në gatishmëri prej tyre. Allahu thotë: “Ata janë armiq të vërtetë. Allahu i vraftë, se si i largohen të vërtetës!” Prejardhja e rafidive buron nga Abdullah bin Sebe, çifuti dhe nga Ebu Lulue, zjarrputisti persian.

Pra, o ju muslimanë, patjetër muslimani duhet të dallohet me akiden e e tij, duke dashur atë që do Allahu dhe duke urreyer atë që Allahu urren! Muslimanët duhet të përkrahin njëri - tjetrin duke qëndruar si një dorë të vetme kundër armiqve të betuar, për shkak të fesë dhe besimit të tyre, si në kohët e hershme ashtu edhe në ato të tanishme. Allahu ka thënë: “Kurrsesi nuk do të jenë të kënaqur prej teje çifutët dhe të krishterët, derisa të pasosh fenë e tyre.”

Ata, shtetin sionist e mbollën në Palestinë, me qëllimin e vetëm për të luftuar Islamin dhe për të trazuar rajonin. Ndër pasojat e dëmshme të kolonializimit të tyre në botën islame janë sëmundjet shoqërore që çenojnë besimin dhe moralin shoqëror, të cilat edhe sot e kësaj dite i vuajnë muslimanët. Nga pasojat më të dëmshme ishte edhe eliminimi i gjykatave islame në botën islame, duke i zëvendësuar ato me ligjet e shpikura dhe të mangëta njerëzore. Kjo mbretëri (Arabia Saudite), (Falënderimi i takon Allahut!) vazhdon të ruajë gjykatat islame, të cilat gjykojnë me Sheriatin e Allahut dhe bartin flamurin e teuhidit.

Në kohët e fundit, çifutët dhe të krishterët sajojnë dhe krijojnë probleme në rajon, duke kërkuar justifikime për prezencën e tyre ushtarake. Si pasojë e kësaj ndodhën një seri përmbysjesh ushtarake, me të cilat u sprovua rajoni, nën emërtimin e partive të ndryshme apo rrymave kafire, si p.sh: rizgjimi (ateizmi komunist), nacionalizmi, socializmi, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me islamin, të tillë si Saddam Husejni, të cilët e luftuan Islamin dhe diturinë, përdorën larjet e hesapeve me anë të eliminimeve fizike, i mbytën zërat e së vërtetës dhe i detyruan intelektualët që të emigrojnë në perëndim.

Në këtë mënyrë, u dobësuan shtetet që u goditën nga këto lëvizje dhe përmbysje, sa herë që vinte një grup pas atij të mëparshmit, e mallkonte paraardhësin. Ende edhe sot e kësaj dite, në njërin nga vendet arabe, namazi me xhemat konsiderohet krim për të cilin dënohesh (La haule ue la ku-ue te il-la bil-lah!), duke mos lënë vend për vullnet të lirë dhe fisnikëri. Pas parapërgatitjes nëpërmjet këtyre shkaqeve, iu mundësua shteteve të mëdha që të krijojnë ngjarje fasadë për të justifikuar ndërhyrjet ushtarake, pasi që kishin hyrë ekonomikisht. Aktualisht, qëllimet e shteteve të ndryshme kundër interesit të qëndrueshmërisë së rajonit janë mëse të qarta dhe tendenca për t'i ndarë në shtete të vogla që të luftohen

mes tyre. Kjo armiqësi është me motiv fetar, prandaj armiqësia e shteteve të mëdha është akoma më e madhe dhe më e ashpër kundër shtetit të dy xhamive të shenjta sepse është kalaja e fortifikuar e Islamit. Në këtë mënyrë, qëllimet dashakeqe të disa shteteve, apo kush qarkullon në orbitën e tyre për ta dëmtuar këtë vend janë qartësisht të dukshme. Të gjitha shtetet kafire, madje edhe ato shtete që e konsiderojnë veten armike të shteteve të mëdha, janë kundër Islamit dhe muslimanëve, ndaj nuk i zihet besë asnjërës prej tyre sepse ato kërkojnë që ta kërcënojnë atë në institucionet më jetike, apo në integritetin territorial. Le ta dijnë mirë se muslimanët, kudo qofshin, në Lindje apo Perëndim, janë të solidarizuar me shtetin e dy xhamive të shenjta (Allahu i forcoftë!) sepse kjo mbretëri është kalaja e fundit e Islamit. Këto qëllime dashakeqe nga këto shtete të mëdha kanë gjashtë objektiva:

- 1) Garancia e qëndrueshmërisë së shtetit sionist.
- 2) Ndërtimi i tempullit të Sulejmanit.
- 3) Ruajtja e epërsisë ushtarake të shtetit çifut ndaj shteteve të rajonit.
- 4) Zotërimi i pasurive të rajonit, duke mos u lënë banorëve vendas asgjë përveçse kafshatën e bukës.
- 5) Eleminimi i thirrjes Islame.
- 6) Thirrja në çdo parim të kundërt me Islamin, shembja e çdo morali fisnik dhe lënia e shteteve të rajonit në konflikte të vazhdueshme.

O ju muslimanë! Keni shembullin më të mirë me Turqinë, e cila gjykoi me laicizëm që kur u shfaq i mallkuari Kemal Ataturk, i cili ua imponoi kufrin dhe sundimtarët e atij vendi e braktisën islamin, e luftuan në çdo detaj dhe vazhdojnë ta bëjnë këtë, ¹²⁹ madje kanë

¹²⁹ Sh. p. : Kuptohet ka për qëllim deri në periudhën kur është mbajtur kjo hytbe, para 14 vjetësh dhe kurrsezi nuk ka për qëllim qeverisjen aktuale të Turqisë

lidhur marrëveshje ushtarake me çifutët, por megjithatë ata nuk janë të kënaqur nga kjo dhe mbetet vetëm të shndërrohen në shërbëtor të bindur, asgjë më shumë. Për këtë arsye, ata nuk e pranojnë në asnjë aleancë apo union, për “mëkatin” e saj të vetëm që ajo ka qenë flamurtarja e Islamit dhe mbrojtësja e tij në shekujt e kaluar. Sado që ju të hiqni dorë nga feja juaj, ata kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ju, prandaj, mbroni të drejtat tuaja dhe mbroni fenë tuaj, sepse armiqësia është fetare, o ju muslimanë! Kemi shembull Irakun, pse mbahet i rrethuar ai popull për gjashtë vite me radhë, çfarë mëkati kanë bërë ata?! Asgjë tjetër, përveç faktit që ata janë muslimanë. Sadami dhe partia e tij nuk do të dëmtohen aspak nga ky vendim aspak, por dëmtohet vetëm populli. Ata pretendojnë se Iraku nuk ka përmbushur një nga vendimet e OKB-së, ndërkohë që armiku sionist nuk i është përmbajtur 60 vendimeve, madje qeveria e tyre nuk e ka nënshkruar traktatin e ndalimit të armëve bërthamore në rajonin e Lindjes së Mesme, në rajonin që vlon nga vullkanet dhe fitnet dhe që nuk i shkon aspak për shtat që në të ekzistojnë armë të shkatërrimit në masë. Këshilla ime për këto shtete është që të mos ndërhyjnë në çështjet e rajonit sepse vetë shtetet e këtij rajoni (me në krye Mbretërinë e Arabisë Saudite) janë përgjegjësit e vetëm për këtë rajon.

Ata nuk duhet të mashtrohen me forcën e tyre sepse Allahu ka vendosur ligje dhe tradita, ku një nga këto tradita është se forca e përdorur në mënyrë të padrejtë dhe të shfrenuar është e barabartë me shkatërrimin e një shteti, shkatërrim që i vjen nga Zoti i botërave. Teknologjia nuk është gjithçka, përkundrazi, përfundimi ka të bëjë me besimin. Siguria dhe rendi i rajonit është e drejtë e shteteve të këtij rajoni dhe çdo çrregullim dhe problem i këtij rajoni, në të vërtetë i vjen nga shtetet e mëdha, të cilat sajojnë ngjarje dhe bëhen të pranishme, sa herë që aty ndodh diçka, me pretendimin se vijnë për të stabilizuar situatën, apo për të shmangur rrezikun e

pretenduar, e si mund të jetë ujku mbikqyrës besnik për bagëtitë?! Armiqësia është fetare, o robër të Allahut dhe këto shtete nuk marrin vetë dot asnjë vendim, por udhëhiqen të nënshtroar dhe përlulur nga çifutët. Muslimanët nuk e pranojnë pjesëmarrjen e tyre ushtarake, apo të çfarëdo shteti tjetër kafir sepse Profeti (SalAllahu alejhi ue selem!) ka thënë: “Të mos mbeten në Gadishullin Arabik dy fe”, po ashtu, porosia e fundit e Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!) ishte: “Dëbojini çifutët dhe të krishterët nga Gadishulli Arabik!” O ju muslimanë! Ka rënë për ju sirena e alarmit, ndaj pendohuni tek Allahu, sepse çdo bela që zbret është për shkak të mëkatit dhe largimi i asaj belaje bëhet me pendim!

O ti që mëkaton nëpërmjet konsumimit të alkoolit, pendohu tek Allahu sepse në këtë mënyrë kontribuon në përmirësimin e shoqërisë tënde!

O ti që mëkaton me kryerjen e imoralitetit!

O ti që mëkaton me anë të kryerjes së homoseksualitetit, pendohu tek Allahu!

O ti që mëkaton nëpërmjet konsumimit të drogërave, pendohu tek Zoti yt sepse së shpejti tek Ai do kthehesh!

O ti që mëkaton nëpërmjet lënies së namazit, pendohu tek Allahu!

O ti që mëkaton nëpërmjet padrejtësisë që i bën muslimanit në pasuri, apo nder, pendohu tek Zoti yt!

Pastrojini pasuritë tuaja nga kamata sepse ajo është një nga shkaqet e luftërave dhe të shkatërrimit!

Pastrojini pasuritë tuaja nga marrëdhëniet tregtare që nuk përputhen me Sheriatin! Kryejini transaksionet tuaja në ato banka që iu përmbahen dispozitave të Islamit!

Bëni thirrje për afrim tek Allahu dhe përkraheni këtë thirrje! Mësojini muslimanët, përkushtohuni ndaj metodave të arsimimit në mjedisin e shteteve të botës Islame! Thirrja tek Allahu është

obligimi i çdo muslimani, por orientimi i kësaj thirrjeje duhet të bëhet nga dijetarë të besueshëm në akiden e tyre, në diturinë e tyre, në qëndrueshmërinë e tyre. Ata, të cilët konsiderohen pikë referimi për fetva dhe çështje, për të cilat muslimanët kanë nevojë që të njohin gjykimin e Islamit, në përputhje me Librin e Allahut dhe Sunetit të Profetit (SalAllahu alejhi ue selem!). Largohuni nga përçarjet partiake dhe sektare, largohuni nga tekat konfliktuese!

Ruhuni nga dënimi i Allahut!

Përmbajtja

Pse e shkrova këtë broshurë?	4
Ndërmjet tyrbeve dhe burimeve të referencës (librave bazë)	7
Cila është zgjidhja?	7
A mund të pranohet logjikisht që kjo të jetë rruga e ehlul bejtit?!	9
Megjithëse shumëkujt (nga shijat) nuk do t'i pëlqejë kjo gjë	9
Kapitulli i parë	
Rruga e ehlul bejtit mes teorisë dhe praktikës	11
Tema e parë: Profeti dhe imamët, historia e mrekullueshme	11
Muhamedi (SalAllahu alejhi ue selem!), i pari i asketëve	11
Në hapat e gjyshit dhe prijësit të tyre	13
Imam Aliu (radijAllahu anhu)	14
Fatkeqësia jonë më e madhe	14
Fjalë të mbështetura nga veprat	15
Teuhidi i pastër	17
Gjyko se ku ndodhemi ne në raport me këto thënie	18
Ata jepnin dhe nuk pranonin të merrnin	19
Ata ushqeheshin nga puna e duarve të tyre	20

Tema e dytë: Sistemi i jetës sipas Islamit.....	21
Sistemi mbi të cilin bazohet “pseudo-fetarizmi” shi’it.....	25
Kapitulli i dytë	
Sistemi i shpikur dhe realiteti i shthurur.....	28
Tema e parë: Teuhidi (i tyre), nga besimi tek intoksikimi (varësia).....	28
Reflektime të shpejta, të marra nga margaritarët e ajeteve kuranore.....	28
Në shërbim të pasurisë dhe seksit.....	31
Shpeshherë do gjesh që Allahu barazohet me Profetin (SalAllahu alejhi ue selem!) dhe imamët.....	32
Kush na ruan dhe na mbron ne?.....	33
Emrat e shumë prej shijave tregojnë robërim për dikë tjetër veç Allahut.....	34
Oferta dhe zotime.....	35
Festat e vërteta sipas sheriatit dhe festimet e shpikura, ndërmjet dhënies rëndësi dhe shpërfilljes.....	36
Ja çfarë ndodh tek “tyrbet”	38
Çfarë thonë burimet e referencës dhe librat bazë?.....	42
Një kundërthënie e habitshme dhe një absurditet i pashoq....	44
Për çfarë kemi nevojë?.....	45
Thirrje drejtuar brezave të rinj.....	46

Metoda e shpërftyryrimit dhe rrëzimit të personalitetit.....	46
E vërteta nuk vlerësohet në varësi të njerëzve, por njëhe të vërtetën paraprakisht që t'i vlerësosh njerëzit.....	47
Ja pra kështu.....	53
Kapitulli i tretë	
Namazi shtylla e fesë.....	54
Kohët e namazit.....	54
Abdesi.....	55
Namazi i xhumasë.....	55
Namazi me xhemat.....	56
Namazi i bajrameve.....	56
Namazi i teravive.....	57
Namazet nafle.....	57
Leximi i Kuranit në namaz.....	57
Namazi i xhenazes.....	58
Kompensimi i namazit me pasuri.....	58
El husejnjat.....	58
Xhamitë.....	59
Dhikri dhe leximi i Kur'anit.....	60
Mësimet këshilluese.....	63

Kapitulli i katërt	
Agjërimi dhe haxhi.....	65
Agjërimi i Ramazanit.....	65
Justifikime të kota, të demaskuara.....	66
Marrëdhëniet intime dhe ngacmimet kanë kapitullin e tyre në Ramazan.....	67
El mulajatu dhe “el mulajin”.....	68
Vallë, këtë trashëgimi na ka lënë ehlu bejti?!.....	69
Haxhi për në shtëpinë e allahut.....	69
Burimet e belasë (referencës).....	72
Kapitulli i pestë	
Zekati, një e pesta dhe rregullat e tjera në lidhje me pasurinë.....	74
Zekati.....	74
Çfarë është el khumusi (një e pesta)?.....	76
A e di?.....	79
Habi dhe çudira.....	79
Një e treta e pasurisë së të vdekurit.....	81
Sadakatë, “pagesa kundrejt mundit” dhe lloje të tjera të ardhurash, pambarim!.....	81
Kamata.....	85

Kuponat e faljes !!.....	86
Festa të ndryshme me emra ushqimesh.....	87
Kapitulli i gjashtë	
Martesa dhe çdo gjë tjetër e lejuar apo e “vetë-lejuar”	88
“Tolerancë” e frikshme.....	88
“Martesa” e përkohshme (nikahul mutah).....	89
Shthurja e shfrenuar evropiane.....	95
Një katastrofë tjetër.....	98
“Fëmijë hallalli”.....	100
U riktheva për kërkime dhe studime.....	100
“Thuaj: Po ju këshilloj me diçka të vetme”.....	103
Vallë, ku ka shkuar logjika?.....	104
Marrëdhënia bashkëshortore.....	105
Veçimi me grate.....	107
Zotimet e grave për tek “zotëriu”.....	108
Çudira, habi dhe paradokse.....	108
Pretendim skandaloz dhe shpifje e turpshme.....	111
Abuzimi me detajet mbi intimitetin dhe marrëdhëniet seksuale nëpër libra dhe broshura.....	111
Të gjitha mëkatet janë të falura!.....	120

Shthurja ndodh si pasojë e përshtatjes së mjedisit.....123

Përmbyllje dhe një parim shi'it!.....124

SHTOJCË 1

Shpëtimi i të mbyturit dhe ndriçimi i rrugës.....126

SHTOJCË 2

Hytbeja e shejkh Alij el Hudhejfij për shijat.....151